



ECONOMICUS
NR.1 / PRANVERË 2008
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS
REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT
TË SHKENCAVE EKONOMIKE.

KRYEREDAKTOR:
PROF. ASSOC. DR. ADRIAN CIVICI

REDAKTOR:
ENKELEJDA MYFTARI

KONSULENTË
DR. SELAMI XHEPA
PROF. ASSOC. DR. LULJETA MINXHOLLI
MSC. MIMI KODHELI
DR. GJERGJI FILIPI
PROF. ASSOC. ENTELA SHEHU
MSC. NERITAN SEJAMINI
PROF. ASSOC. DR. ARBEN MALAJ
DR. FATMIR GURI
PROF. ASSOC. DR. FLUTURA KALEMI
MSC. SHKËLZEN MARKU

Dërgoni shkrime reçensa librash, përmbledhje
 punimesh shkencore, monografi, studime në
 redaksinë e revistës ECONOMICUS.

Ato do të shqyrtohen nga redaksia me rigorozitet
 shkencor.

Dërgoni në format Word në adresën e mëposhtme:
economicus@universitetieuropean.com

PËRMBAJTJA

ROLI DHE KONTRIBUTI I EKONOMISTËVE NË SHOQËRITË MODERNE <i>Prof. Asoc. Dr. ADRIAN CIVICI</i>	9
---	---

EVROPA NË KËRKIM TË EKONOMISË SË DIJES <i>Dr. GJERGJI FILIPI</i>	17
---	----

DOSJE - SEKTORI PUBLIK

KAPITULLIMI PA KUSHTE I SEKTORIT PUBLIK <i>HENRI CILI</i>	29
--	----

SEKTORI PUBLIK - REFORMAT KOMPLEKSE QË NUK DUHEN VONUAR <i>Prof. Asoc. Dr. ARBEN MALAJ</i>	31
---	----

TAKSA E SHESHTË DHE SJELLJA EKONOMIKE <i>Dr. SELAMI XHEPA</i>	35
--	----

SEKTORIT PUBLIK – QEVERISJA DHE PERFORMANCA <i>Prof. Asoc. Dr. ADRIAN CIVICI</i>	39
---	----

POTENCIALI I ARSIMIT PRIVAT DHE INTERESAT INDIVIDUALË E PUBLIKË <i>Dr. ERMAL HASIMJA</i>	43
---	----

SHËNDETËSIA - RRUGA E GJATË DREJT SË MIRËS <i>Prof. Asoc. Dr. EDUART HASHORVA</i>	47
--	----

SEKTORI BANKAR SI MODEL SUKSESI I MANAXHIMIT PRIVAT <i>ARTAN SANTO</i>	53
---	----

SFIDAT DHE PROBLEMET E FORMIMIT TË MENAXHERËVE TË RINJ, TË AFTË PËR T'JU PËRGJIGJUR NEVOJAVE TË SEKTORIT PUBLIK <i>Prof. Dr. FATMIR MEMAJ</i>	57
---	----

EVOLUCIONI DHE SFIDAT E SHTETIT RREGULLATOR NË EUROPE <i>BURKARD EBERLEIN</i>	63
--	----

ADMINISTRIMI I EKSTERNALITETEVE MIDIS SHTETIT DHE TREGUT. <i>Dr. FATMIR GURI</i>	81
---	----

INTEGRIMI EUROPIAN DHE ROLI I BANKËS SË SHQIPËRISË <i>INA KRAJA, NIUTON MULLETI</i>	89
--	----

ZHVILLIMI I EKONOMISË NË FOKUSIN E NJË PRESIDENTI**Zhvillimi i Zambias nëpërmjet rritjes së menaxhimit dhe dijes*****Levy Patrick Mwanawasa* 95****ÇMIMET NOBËL NE EKONOMI – ORIGJINA DHE LAUREATËT 99****PROFIL: AMARTYA SEN****EKONOMISTI I MIRËQËNIES 105****RECENCË “TRANZICIONI DHE LIRIA EKONOMIKE NË SHQIPËRI”*****Prof. Dr. ANASTAS ANGJELI* 109**

PËRSE ECONOMICUS!

Adrian Civici

Revista ECONOMICUS është një botim me karakter shkencor dhe informativ i Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit European të Tiranës. Qëllimi kryesor i saj është pasqyrimi i realiteteve, arritjeve dhe sfidave të reja në fushën e zhvillimeve ekonomike, financiare e sociale në Shqipëri dhe në botë, nxitja e kërkimit, debatit shkencor dhe propozimeve konkrete efektive në këto fusha.

Në mënyrë të vecantë revista Economicus synon krijimin e një forumi aktiv të mendimit ekonomik në Shqipëri, synon angazhimin më të gjerë e më konkret të gjithë komunitetit të ekonomistëve e financierëve shqiptarë në Shqipëri apo jashtë saj në trajtimin e problematikës së zhvillimit ekonomiko-social, financave publike dhe tregjeve financiare në përgjithësi, stabilitetit makroekonomik, politikave ekonomike e financiare, zhvillimit social e territorial, kredisë dhe bankave, sistemeve të sigurimeve dhe pensione, cmimeve dhe inflacionit, efektet dhe kërkesat në kuadrin e integritetit europian, ndikimet dhe përballja me zhvillimet e ekonomisë botërore dhe globalizimit, etj.

Një vend të rëndësishëm në pëmbajtjen e saj do të kenë analizat për eksperiencat bashkëkohore ndërkombëtare në fushën e politikave ekonomike e sociale, trajtimi teorik e aplikativ i ideve, debateve e politikave më të mira në fushat e sipërpërmendura, etj. Ekonomistët më të shquar të botës dhe analiza e teorive dhe kontributit të tyre në shkencat ekonomike do të jetë një tjetër rubrikë e përhershme në faqet e revistës Economicus.

Pedagogë, kërkues të shkencave ekonomike, të Universitetit European të Tiranës apo të universiteteve të tjera publike dhe private, studiues dhe ekspertë të institucioneve të ndryshme që në fokusin e tyre kanë ekonominë, financat dhe zhvillimin në përgjithësi janë të ftuar ta përdorin këtë revistë për të publikuar idetë dhe studimet e tyre, për të debatuar apo për të hedhur pikëpamje të reja në debatin ekonomik bashkëkohor.

ROLI DHE KONTRIBUTI I EKONOMISTËVE NË SHOQËRITE MODERNE

PROF.ASS.DR. ADRIAN CIVICI

ABSTRAKT. *Debatet mbi rolin dhe kontributin e ekonomistëve në shoqëritë moderne po bëhen cdo ditë e më evidente. Pikëpyetjet mbi utilitetin social e politik të tyre janë në fokus të analizave të specializuara. C'farë ekonomistësh na duhen? C'farë njohurish janë të nevojshme për të formuar një ekonomist? C'farë problemesh duhet të zgjidhin ata?, Si ta vlerësojmë cilësinë e tyre? Të gjitha këto pyetje e pikëpyetje nuk janë thjesht shqetësime intelektuale apo akademike mbi thelbin dhe rolin e profesionit të ekonomistit, por më shumë se kaq, ato reflektojnë një kohë të re sfidash përballë ekonomistëve në mënyrë që ata ta "justifikojnë" veten përballë asaj cka pritet prej tyre sot. Thellimi i fenomenit të globalizimit dhe gjithë kërkesat e pasojat e tij mbi zhvillimin ekonomiko-social të vendeve të ndryshme ka nxjerrë dukshëm në evidencë dhe dilemën e madhe : a i përgjigjen dot ekonomistët me formim "tradicional" sfidave të reja? Deri në çfarë pike duhen marrë në konsideratë analizat dhe rekomandimet e tyre? A përgatisin universitetet llojin e duhur të ekonomistit, apo duhet pritur një kohë e gjatë mbas shkollës që ata të "axhustohen" me realitetet e reja?.*

Këto pyetje janë shumë aktuale dhe për Shqipërinë, ku pothuajse të gjithë janë dakort se roli dhe kontributi i ekonomistëve në analizën e shkaqeve të nivelit tonë të zhvillimit apo në "paketat e masave dhe politikave" të propozuara prej tyre për të dalë nga kjo gjendje, janë shumë minimale. Ekonomistët janë ndoshta mungesa më e madhe në stafet qendrore politike, në strukturat drejtuese të institucioneve më të rëndësishme të shtetit, në "përmbajtjen e komenteve dhe informacioneve të mass mediave, në debatin intelektual e akademik, në kërkimin shkencor e financimin e tij, në këshillimin e institucionalizuar të Parlamentit apo politikës në përgjithësi, etj. Qoftë duke e shtruar pyetjen nga këndvështrimi se "përse nuk flasin sa duhet ekonomistët shqiptarë për problemet madhore të vendit", qoftë duke e shtruar nga këndvështrimi i kundërt, se "përse nuk dëgjohen ekonomistët shqiptarë?", përgjigjia është pak a shumë e njëjta : mendimi ekonomik shqiptar, përveçse të vlerësohet, ka nevojë të modernizohet dhe institucionalizohet në përputhje me tendencat moderne të këtij profesioni e specialiteti

EKONOMISTËT MODERNË – C'FARË PO KËRKOHEJ PREJ TYRE?

Në front të parë të preokupimit mbi rolin dhe kontributin e ekonomistëve në shoqëritë moderne, përveç politikës dhe biznesit në sensin e gjërë e gjithëpërfshirës së tij, janë dhe universitetet dhe fakultetet e ekonomisë dhe biznesit që me curriculumet e tyre synojnë ti përgjigjen saktësisht kësaj tendence e shqetësimi për llojin dhe cilësinë e ekonomistëve që formojnë e diplomojnë. Dhe

duhet të jemi të sigurtë se ky shqetësim nuk është vetëm shqiptar. Në SHBA, Angli, Francë, Itali, Gjermani, Kanada, Australi, Kinë, Indi, Suedi, etj., vënde që shquhen për shkollat e universiteteve nga më cilësorët në fushën e ekonomisë, është hapur tashmë një debat i përgjithshëm mbi këtë shqetësim : *“cili është roli i ekonomisë dhe ekonomistëve në shoqëritë moderne?”*

Ja një anekdotë që e shpreh qartë këtë pritje të re të shoqërisë nga ekonomistët. *“Një mjek, një prift, një ministër dhe një ekonomist u mbledhën në një klub golfi. Sipas rregullave të lojës dhe mundësive të fushës, grupi duhet të priste që të mbaronte një grup tjetër përpara tyre dhe pastaj të vazhdojë të përdorte fushat sipas një kalendari dhe orari të paracaktuar. Por gjithshka ecte ngadalë. Grupi para tyre i lëshonte topat pa asnjë drejtim të caktuar, kryente veprime të çuditshme dhe e mbante të bllokuar fushën. Në këto kushte grupi ndjekës e braktis fushën dhe kthehet i indinjuar në zyrat e klubit për tu ankuar. Por klubi ju dha një përgjigje që nuk pritej: “na falni që nuk ju njoftoam që sot në klubin tonë po ndodhte dicka speciale, grupi përpara jush përbehej nga persona të verbër”. Reaksionet nuk vonuan. Ministri tha menjëherë: “më vjen keq..nuk e dija..po i dorëzoj materialet e lojës..duhet të bëjmë diçka për këta njerëz”. Prifti tha se në lutjet e tij do ta përsëriste shumë herë “duaje komshiun si veten tënde pavarësisht nga cilësitë e tij”. Mjeku reagoi: “jam i dëshpëruar që i trajtova kështu pacientet e mi, nuk do të luaj golf për disa javë, por do të shkoj çdo të shtunë të shërbej si vullnetar në pavionin e të verbërve”. Kurse ekonomisti reagoi në mënyrë më lakonike: **“proponoj një mundësi që ata të luajnë një lojë tjetër me anë të së cilës do kënaqen vetë dhe njëkohësisht nuk do pengojnë të tjerët që të luajnë?..kështu harmonizohemi dhe kënaqemi që të gjithë”**. Sipas B.Salanie, profesor në Columbia University *“shoqëria e sotme pret nga ekonomistët që ata jo vetëm të shpjegojnë se çfarë ka ndodhur, por mbi të gjitha, të bëjnë propozime konkrete për zgjidhjen e problemeve konkrete të shoqërisë sonë të tilla si papunësia, pagat dhe pensionet e ulta, cmimet e larta, shërbimet cilësore, rritjen e fuqisë blerëse, kreditë me interes të favorshëm, klimë miqësore shtet-biznes, etj.”**

TRE PROFILET E EKONOMISTËVE

Profili dhe përmbajtja e re që po kërkohet për ekonomistët po analizohet mbështetur në ato që quhen *“tre portretet apo figurat e ekonomistëve”*. Figura e parë është ajo e një ekonomisti teoricien që nëpërmjet matematikës, statistikës apo ekonometrisë tenton që çdo gjë ta *“formalizojë në një ekuacion apo formulë të përgjithshme me spektër të gjërë dhe të pakufizuar në kohë e hapësirë”*. Por, megjithë sukseset e ekonomistëve të cilësuar si neo-klasikë, të cilët e ngritën në art një profil të tillë ekonomisti, aktualisht të gjithë po binden se kjo mënyrë veprimi për të ndërtuar hipoteza të përgjithshme përmban në vetvete shumë subjektivitet, aq më tepër që vetë ekonomia si shkencë nuk është e ngjashme me shkencat egzakta si kimia, fizika, etj. Mjafton që për të njëjtin fenomen ekonomik të shtosh disa elementë në model apo të ndryshosh serinë kohore dhe menjëherë gjëndesh përballë një tendence tjetër të formalizuar matematikisht.

Profili i dytë i ekonomistëve u konsolidua në vitet 60-të të shek.XX-të të cilët prodhuan atë që quhet *“makroekonomia e aplikuar e tipit keynes-ian”*, e cila bashkonte në një të vetme modelet ekonometrike me politikat ekonomike. Por, mbas rreth 20-30 vjet egzistence në podiumet e mendimit dhe politikave ekonomike, zhvillimet ekonomiko-financiare e sociale në vitet 80-90-të filluan të evidentojnë një sërë anomalish. Kritika dhe rezervat kryesore u fokusuan në *“vlerën dhe besueshmërinë e parashikimeve afat-mesme dhe afat-gjatë”* të ecurisë së fenomeneve të tilla si papunësia, rritja apo rënia ekonomike, inflacioni, përqindjet e këmbimit të monedhave, ekuilibrat dhe dizekuilibrat strukturorë, lidhjet shkak-pasojë ndërmjet konsumit dhe investimeve, etj. Politikat ekonomike nuk ndjeheshin të sigurta në objektivat dhe instrumentet kryesore të tyre duke u mbështetur vetëm në seritë tendenciale makroekonomike.

Profilin i tretë i ekonomistëve i takon 15-20 viteve të fundit dhe është ai që e cilëson ekonomistin si *“një inxhinier social të politikave ekonomike”*. Detyra bazë e tij është orientimi sa më i saktë i të gjithë mjeteve dhe instrumenteve që disponojnë autoritetet publike drejt realizimit të

disa objektivave themelore në dobi të gjithë komunitetit, të tilla si : stimulimi i rritjes ekonomike, mbajtja e nivelit të lartë të punësimit, lufta kundër inflacionit, ekuilibri i tregëtisë së jashtme, rritja e fuqisë blerëse të popullsisë, stabiliteti i skemave të pensioneve dhe mbrojtjes sociale, cilësia e shërbimeve publike, etj. Në themel të tij, ky evolucion u cilësua si trilogjia e famshme “*të parashikosh...të veprosh...të garantosh*”, dhe u duk se më në fund ekonomistët “*e gjetën veten dhe u bënë aq të rëndësishëm sa pretendonin se ishin në shoqëri dhe politikë*”. Por vitet 90-të të shek XX-të dhe fillimi i mijëvjeçarit të ri dëshmuar për disa kufizime të kësaj trilogjie. Kur vinte fjala për politikën ekonomike, ekonomistët ekonomistët rezultonin të ndarë dhe të fragmentuar : keynesianë, monetaristë, klasikë, neoklasikë, institucionalistë, regulacionistë, shumpeter-ianë, liberalë të shkollës austriake, etj. Zgjedhja e politikave ekonomike, larg të qenit rezultat i njohurive shkencore dhe kërkimit bazë, varej gjithnjë e më tepër nga kualicionet dhe ekuilibret politike të pushtetit dhe vetë politikës. Kjo i dha fund dhe vetë konceptit të neutralitetit të ekonomistit si “*zëdhënës i njohurive dhe koncepteve shkencore*”. Kjo e bëri ekonomistin palë me politikën dhe për pasojë e relativizoi shumë atë dhe politikën ekonomike të propozuara e mbrojtura prej tij. Ekonomistët u vendosën nën cadrën e politikës dhe në shërbim të saj, ndërkohë që sot, opinioni publik dhe ekspertët e fushës mendojnë se duhet të jetë e kundërta, “*duhet të jetë politika ajo që duhet të marrë referencat bazë nga ekonomia dhe ekonomistët*”. Por, për këtë, vec të tjerave, sot kërkohet një profil dhe figurë e re ekonomistësh, të cilët në përmbajtjen dhe veprimin e tyre ti përgjigjen stadi dhe problemeve të reja me të cilat po përballen shtete, kontinente apo vetë bota në tërësi.

SHEKULLI I XXI-TË : KËRKESA DHE SFIDA TË REJA

Shekulli i XXI-të ka filluar “*punën*” edhe për profilizimin e një figure të re ekonomistësh. Ja roli si dhe disa nga tiparet dhe cilësitë e tij kryesore që po kristalizohen në figurën e ekonomistit modern që po modelohet dhe gatuhet në auditorët e universiteteve dhe fakulteteve më bashkëkohore në këtë drejtim.

Së pari, ekonomistët duhet të jenë të aftë “*jo vetëm ta evidentojnë fenomenin, por në rradhë të parë ta kuptojnë në thelbin e tij dhe të propozojnë konkretisht mjetet dhe mënyrat për transformimin e tij*”. Në vend që të merren pafund me modele e vërtetime teorike, ata “*duhet të preokupohen me problemet më shqetësuese aktuale si papunësia, destabiliteti financiar, varfëria dhe mos-zhvillimi i shumë rajoneve dhe shteteve të botës, zgjidhja e problemeve të ushqimit dhe energjisë*”, problemet e cilësisë së jetës, etj.

Së dyti, ekonomistët modernë duhet të “*bëhen dishepujt e shpërndarjes së koncepteve dhe praktikave të asaj që cilësohet si shoqëri e qëndrueshme*”, që garanton lirinë individuale, drejtësinë sociale dhe respektin për natyrën dhe mjedisin në përgjithësi. Ekonomistët duhet të profilizohen në një rol të ri, në atë të “*reformatorit social*” duke kërkuar një inpakt gjithnjë e më të madh në organizimin e shoqërisë. Kërkimet e fundit në fushën e “*Ekonomisë historike*” të shoqëruar me një interes gjithnjë në rritje të shoqërisë për rolin dhe rekomandimet e tyre, po hap perspektivën e riintegritit të ekonomisë në shkencat sociale. Edhe vetë ajo që quhet “*ekonomia eksperimentale*” po kërkon gjithnjë e më tepër hapësira të reja për të shpjeguar sjelljen e individëve apo grupeve, hapësira që duhet të jenë shumë më të gjera se ato të konturuara dhe propozuara deri tani nga “*homo oeconomicus*”.

Së treti, ekonomistët duhet të fillojnë “*të shkrihen*” më shumë me shkencat dhe disiplinat e tjera. Ekspertët mendojnë se ekonomisti modern duhet të formohet pa tjetër me njohuri më komplekse. Gjithnjë e më shumë duhet synuar në përgatitjen dhe diplomimin e “ekonomistëve mjedisorë”, “ekonomistëve të informacionit”, “ekonomistëve të shëndetësisë”, “ekonomistëve të arsimit”, “ekonomistëve financiarë”, “ekonomistëve të teknologjive të reja”, “ekonomistëve informaticienë”, “ekonomistëve të zhvillimit”, “ekonomistëve të transportit”, “ekonomistëve urbanë”, “ekonomistëve të shërbimeve”, “ekonomistëve të turizmit”, “ekonomistëve të territorit”, “ekonomistëve juristë”, etj. Në këtë mënyrë ekonomistët mund të kontribuojnë realisht dhe

konkretisht në zhvillimin dhe eficienten e shoqërisë në përgjithësi dhe atë të sektorëve të vecantë në vecanti.

Së katërti, ekonomistët duhet *“të kenë këndvështrim e formim sa më global e ndërkombëtar”*. Ata duhet të jenë në gjendje të njohin dhe të përballen me debatet dhe sfidat që vijnë si pasojë e fenomenit të ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike, emigracionit ndërkombëtar, gjeopolitikës së naftës në vecanti dhe energjisë në përgjithësi, aksesit në burimet dhe lëndët e para jetësore si uji, tokat bujqësore, pyjet, ajri, mineralet e ndryshme, etj., problemet e ushqimit dhe varfërisë në botë, rolit dhe ndikimit të institucioneve më të rëndësishme ndërkombëtare si FMN, OBT, Banka Botërore, FAO, etj., në ekonomitë lokale e rajonale, rolit të ideologjive, fesë dhe ndryshimeve të civilizimeve në zhvillimin dhe kontradiktat e botës, krizat financiare dhe roli i tyre mbi vende e popuj të ndryshëm, efektet e teknikave dhe teknologjive të reja si nanoteknologjitë, organizmat gjenetiksht të modifikueshme, ndikimin por dhe oportunitetet që po prodhon zhvillimi shumë i shpejtë i Kinës, Indisë, Brazilit, etj. Zgjerimi i fenomenit të globalizimit po e bën përditë e më të qartë për të gjithë se *“gjithnjë e më pak problemet janë lokale apo nacionale... ato po bëhen përditë e më tepër ndërkombëtare”*.

PSE DUHET TË JETË MË PREZENT MENDIMI EKONOMIK NË SHQIPËRI ?

Pavarësisht vendit sundues që zenë debatet dhe grindjet politike pa fund apo kronika e zezë, nevoja dhe sfida më prioritare për Shqipërinë sot është pa dyshim zhvillimi i ulët ekonomik dhe social i saj. Është “luks” i tepërt që ne vazhdojmë të harxhojmë energji politike, intelektuale e sociale të shumta për antagonizma politike e çështje anësore duke mos gjetur mirëkuptimin kombëtar se çështja më urgjente dhe më me pasoja është niveli jonë shumë i ulët i zhvillimit ekonomik e social, është vështirësia për të garantuar një rritje të qëndrueshme dhe identifikuar qartë prioritetet dhe burimet tona të rritjes, është kapitali jonë social e intelektual tepër i brishtë, është diferenca e madhe dhe vonesa dhjetëra-vjeçare në zhvillim në raport me shumë vende të rajonit apo të Evropës. Mendimi ekonomik shqiptar është akoma i marxhinalizuar kur është fjala për të përcaktuar objektivat prioritare të zhvillimit, orientimin e buxhetit dhe investimeve publike, politikat fiskale dhe në përgjithësi gjithë grupin e masave që konsiderohen si përcaktues të klimës së biznesit, etj. Ekonomistët shqiptarë flasin dhe dëgjohen shumë pak.

Është thjesht rastësi që në vitin 2007 ka patur zgjedhje presidenciale si në Shqipëri ashtu dhe në Francë. Dhe në këtë kuadër, është e natyrshme dhe brenda gjithë rregullave të lojës së funksionimit demokratik, që partitë politike, opinioni publik, intelektualët dhe në përgjithësi mas-media të jenë aktivë për tu *“futur në fushatë”*, për të *“zhvilluar intensivisht fushatën”* apo për të *“analizuar rezultatet e saj”* dhe perspektivat e afërta dhe largëta të vendit. Pak a shumë, cdo fushatë qoftë ajo presidenciale, parlamentare apo lokale është koha më e përshtatshme që të profilizohen *“subjektet”* apo *“temat kryesore të fushatës”*, që të ravigjëzohen alternativat dhe politikat e zhvillimit, të evidentohen prioritetet dhe të garantohet një përfshirje sa më e madhe e ekspertëve dhe shoqërisë civile apo asaj akademike në debate e propozime në mënyrë që zgjedhja e Presidentit, e deputetëve apo krerëve të pushtetit lokal përveç emrit të kandidatëve fitues, të konkludojë dhe me kristalizimin dhe profilizimin e një sërë *“objektivash e politikash kryesore”* që duhen ndjekur gjatë mandatit presidencial, parlamentar, qeveritar, etj.

Por le të rikthehemi rastit të zgjedhjes së Presidentit në Francë të cilit ju referuam në fillim. Megjithatë roli i Presidentit në Francë është shumë më i fortë dhe më përcaktues në zhvillimin ekonomik e social të vendit, sepse atje kemi të bëjmë me një republikë gjysmë presidenciale, përsëri ekzistojnë mjaft elemente e koncepte që po ti krahasojmë me realitetin shqiptar evidentojnë një problem mjaft të rëndësishëm : lidhjen e ekonomisë me politikën, kristalizimin e ideve dhe propozimeve të ekonomistëve në paketat politike dhe politikat publike.

Në kuadër të kësaj fushate në Francë, në një nga numrat e saj që i kushtonte vëmendje të vecantë këtij problemi, gazeta *“Le monde”* kishte si titull kryesor *“Ekonomistët kërkojnë të*

orientojnë debatin politik". Një nga grupimet më të mëdha të ekonomistëve në vend i quajtur "Rrethi i ekonomistëve" botoi për diskutim publik një material të veçantë ku trajtohen të gjitha "çështjet kyçe" të ekonomisë dhe zhvillimit në Francë. E veçanta e këtij botimi është se atje janë paraqitur dhe dy programe specifike, njëri "i majtë" dhe tjetri "i djathtë" me pikëpyetjet dhe politikat e mundshme të të dy krahëve të politikës, por që pavarësisht nuancave kanë një objektiv të përbashkët : *"zhvillimi ekonomik e social i Francës në kuadrin e një Evrope gjithnjë e më të zhvilluar në kuadrin e përballimit të sfidave të globalizimit."* Sipas Presidentit të këtij grupimi, J.H.Lorenzi, qëllimi i tyre është *"qartësimi i linjave kryesore të debatit politik e ekonomik në Francë....dhe mos lënia e politikës që të thotë gjëra anësore e pa vlerë apo të bëjë thjesht retorika politike në kurriz të perspektives së zhvillimit"*. Ekonomistët kërkojnë *"të bëjnë një punë pedagogjike dhe ti servirin qartë politikës sfidat e vërteta"* që meritojnë një debat e angazhim publik maksimal : *"Si ta ulim nivelin e papunësisë?"*, *"Cilat janë masat me efektive për tu lehtësuar punësimin të rinjve"*, *"A duhet privatizuar sektori energjetik?"*, *"Cili duhet taksuar më shumë : kapitali, puna apo konsumi?"*, *"Sa duhet të jetë për 10 vitet e ardhshme pjesa e PBB për arsimin dhe shëndetësinë?"*, *"Cili do të jetë motori i ekonomisë për vitet e ardhshme : eksportet, konsumi apo investimet?"*, *"A duhet ta shtojmë buxhetin dhe përmirësojmë politikat për kërkim zhvillimin dhe ekonominë e dijes?"*, *"Cilat janë drejtimet bazë për reformën e pensioneve?"*, *"Çfarë kërkon rritja e performancës së sistemit tonë financiar?"*, etj.

Përballë kësaj logjike e mënyrë veprimi kemi realitetin shqiptar që është paradoksalisht i kundërt si në përmbajtje ashtu dhe në formën e tij. Duke analizuar se çfarë ndodhi në Shqipëri në të njëjtën periudhë zgjedhjeje të Presidentit konstatojmë lehtësisht se temat më të nxehta të saj ishin : *"a i ka PD dhe aleatët e saj votat e mjaftueshme për të zgjedhur presidentin?"*, *"a do ketë deputetë apo parti të vogla që pritet ta dredhin dhe të votojnë jashtë disiplinës së partive të opozitës apo të pozitës?"*, *"a mundet grupi parlamentar i PDK të shkaktojë ndonjë devijim nga parashikimet"*, *"cilët deputetë të zgjedhur në mbrojtje të një programi të caktuar mund të gdhien një ditë të rreshtuar në një formacion tjetër krejt të kundërt me të parin?"*, *"Po ti lihet propozimi i Presidentit PS, a mundet ajo të tërhiqet nga qëndrimet refraktare dhe ti garantojë PD qeverisjen për gjithë mandatin"*, *"Si t'ja bëjmë që ta bllokojmë zgjedhjen e Presidentit në mënyrë që të provokohen zgjedhje të përgjithshme parlamentare"*, etj.

Analiza krahasuese ndërmjet dy situatave e logjikave të veprimit nuk le shumë vend për komente. Parë nën këtë kënd-vështrim, është më se imperative që klasa politike shqiptare, natyrisht duke pranuar dhe faktin se jemi një demokraci e re, duhet të krijojë sa me shpejt simbiozën e saj me klasën e ekonomistëve në mënyrë që debatet dhe produktet politike të saj të shprehura kryesisht në politikat publike, të reflektojnë sfidat e vërteta të zhvillimit ekonomik e social të vendit. Ne nuk duhet ti nënshtrohemi më amatorizmit ekonomik në politikë dhe të kemi "shpikje" e "akrobacia" konjunkturorë politike me konceptet e praktikat shkencore ekonomike sa herë që ka fushata elektorale apo momente të vështira për liderë apo krahë të ndryshëm të politikës. Por ndërkohë që kërkohet një ndryshim i tillë fundamental në sjelljen dhe debatin politik, realiteti shqiptar evidenton dhe një mangësi serioze, këtë radhë nga kampi i ekonomistëve. Sa i organizuar është mendimi ekonomik në Shqipëri për të arritur që të bëhet faktor në orientimin e politikës apo oponent i saj? Le tu referohemi disa fakteve konkrete që dëshmojnë më së miri se sa larg jemi në këtë pikë në raport me përvojat dhe standardet ndërkombëtare.

DOBËSITË E MENDIMIT EKONOMIK NË SHQIPËRI

Po e filloj me një fakt që duhet të trondiste e të bëjë të reflektojë thellë këdo që ka konceptet dhe njohuritë minimale për rolin e mendimit dhe analizës ekonomike e financiare në zhvillimin e një vendi : **Shqipëria është ndoshta nga të paktat shtete në botë që nuk ka asnjë institut kërkimor-shkencor të mirëfilltë ekonomik.** Në asnjë vend të zhvilluar apo në zhvillim, sektorë apo persona të Ministrive të ndryshme apo të institucioneve publike, këshilltarët e ministrave e

kryeministrave, OJF të ndryshme, etj., nuk mund të zëvendësojnë kurrësi produktet e instituteve të mirëfillta e të specializuara ekonomike. Si rezultat i kësaj mungese themelore, gjatë 16 viteve të periudhës së tranzicionit asnjë Kryeministër, Ministër, institucion publik, Kuvend apo parti politike, opinion shoqëror apo mass-media nuk ka mundur të ketë në dispozicion një studim serioz e të plotë për çështje madhore të tilla si : *sa është kosto e integritit evropian të Shqipërisë?, cilat janë avantazhet krahasuese e konkurruese të Shqipërisë? Cili sektor është "motori kryesor ekonomik i vendit dhe për pasojë cilat duhet të jenë prioritetet e qëndrueshme të saj? Do të duhej të aplikojmë "terapinë e chok-ut" apo duhej ti jepnim më tepër vend politikave të transformimit gradual siç kanë bërë pjesa dërrmuese e ish-vendeve të bllokut lindor tashmë anëtarë apo pothuajse anëtarë të BE?, sa na kushton dhe sa përfitojmë nga hapja tregtare? Cili është efekti real shumë planesh i llogaritur në kosto konkrete për çdo sektor e kategori sociale apo profesionale i MTL dhe cilat janë politikat konkrete mbështetëse? Cili është modeli më i përshtatshëm i kapitalizmit për Shqipërinë po të kemi parasysh që në vende të ndryshme aplikohen të paktën 5-6 lloje modelesh specifike të kapitalizmit?, etj., etj.*

Konkurrenca politike, logjika dhe këndvështrimi konjunktural politik apo në mjaft raste edhe injoranca ekonomike e veshur me vello politike ka dominuar në marrjen e vendimeve, zbërthimin në politika konkrete apo administrimin e këtyre "dosjeve" themelore të zhvillimit ekonomiko-financiar e social të vendit. Dhe nuk ka si të ndodhte ndryshe. **Megjithëse jemi ne fund te vitit 2007, në Shqipëri nuk ka akoma një shoqatë apo organizatë serioze e aktive ekonomistësh.**

Shumica e njerëzve të japin menjëherë përgjigje po ti pyesësh se kush janë politikanët më të spikatur, futbollistët më të njohur, aktorët apo artistët më në zë, gazetarët më të shquar, biznesmenët më të suksesshëm, vrasësit apo hajdutët që janë përditë në faqet e shtypit dhe medias, gjyqtarët apo avokatët më eficientë, kryetarët e bashkive apo komunave më problematikë, etj., por pothuajse asnjë nuk është në gjendje të thotë se cilët janë ekonomistët apo financierët më të shquar të Shqipërisë! Vallë nuk ka? Absolutisht jo! Por problemi qëndron se, së pari, problematika ekonomike është "gllabëruar" dhe vazhdon të funksionojë si element i retorikës politike, dhe në radhë të dytë, ekonomistët (ashtu si edhe shumë profesione të tjera po kaq të vlefshme për situatën e vendit si inxhinieret, urbanistët, etj.) janë të paorganizuar institucionalisht për të qenë aktorë e faktorë në sfidat e zhvillimit ekonomik e social të vendit.

Ku evidentohet, debatohet e sintetizohet mendimi apo studimet ekonomike në Shqipëri? Zor se mund të gjejmë elemente konkrete e institucionale që luajnë këtë rol. Dhe kjo mund të fillohet nga elementi më i thjeshtë dhe më komunikativ, mass-media apo dhe shtypi shkencor. Megjithëse kemi me dhjetëra e ndoshta qindra gazeta e revista të llojeve të ndryshme, kemi vetëm një gazetë dhe një revistë që janë të specializuara në fushën e ekonomisë, por gjithsesi të natyrës divulgative e informuese dhe jo asaj të mirëfilltë ekonomiko-financiare. Për buletine shkencore ekonomike apo periodikë të tjerë të mendimit dhe analizës së ekonomisë dhe politikave ekonomike apo platformave të zhvillimit as që bëhet fjalë. Në morinë e konferencave shkencore të ndryshme që zhvillohen çdo vit në Shqipëri, numërohen me gishta për gjithë periudhën 16 vjeçare të tranzicionit, konferencat e mirëfillta ku trajtohen në mënyrë konkrete problemet ekonomike, financiare dhe ato të zhvillimit në përgjithësi.

Po kështu dhe në shtypin shqiptar, ku gjen faqe pa fund kushtuar modës, vendet se ku i kalojnë pushimet personat VIP, vrasjeve dhe krimit ordiner, çdo rrokjeje apo psherëtime të politikanëve, historitë e Palomës dhe Amerikës latine, etj., nuk gjen pothuajse fare asnjë debat serioz e të qëndrueshëm profesional për raportin inflacion-papunësi, për orientimin e investimeve të huaja, për politikat specifike të rritjes së prodhimit të brendshëm, për përdorimin e buxhetit dhe fondeve publike, për ristrukturimin e ekonomisë shqiptare dhe rritjen e konkurrueshmërisë së saj, për rrugët më eficientë të rritjes së nivelit të punësimit, për reformat e pensioneve dhe sigurimin social, për zhvillimin e ekuilibruar rajonal dhe eksodin rural, për uljen e deficitit tregtar, etj.

Është me shumë interes për të gjithë që stilit, gjerësisë, cilësisë dhe frekuencës të debateve të Kadaresë, Qoses, Meidanit, Agollit, Frashërit, Klosit, Lubonjës, Fugës, Ballës, Fevziut, Pezës, Nazarkos, etj., ti bashkëngjiten në të njëjtin nivel personalitetesh të fushës ekonomiko-financiare

dhe debate specifike për çështjet më të mprehta ekonomiko-financiare e zhvillimit të vendit. Mungesa sistematike ose sasia shumë e paktë e librit të mirëfilltë ekonomik e financiar, e botimeve mbi teoritë dhe modelet ekonomike bashkëkohore, mbi analizat e specializuara të periudhës së tranzicionit, mbi përvojat dhe praktikat e vëndeve të ngjshme me Shqipërinë, mbi politikat dhe platformat e institucioneve kryesore ndërkombëtare si FMN, Banka Botërore, Organizata Botërore e Tregëtisë, FAO, BERZH-i, UNDP, OCDE, etj., dëshmojnë për boshllëkun e madh të shoqërisë, institucioneve e vendimmarrësve me informacionin dhe dijen ekonomike e financiare.

INSTITUCIONALIZIMI I MUNGUAR I SIMBIOZËS EKONOMI-POLITIKË

Një rol mjaft të madh e të mirëpritur në tërheqjen dhe përpunimin e mendimit ekonomik duhet të luajnë edhe organet vendim-marrëse e legjislativë, partitë politike, Akademia e Shkencave e Universitete, etj. Deri më sot, nuk ka asnjë paketë politikash ekonomike, platformë zhvillimi ekonomik e social apo studim fundamental të përgatitur në mënyrë të pavarur e të *“hedhur në treg”* për sfidat dhe rrugëzgjdhjet e ekonomisë shqiptare as nga Fakulteti Ekonomik i Tiranës, as nga Akademia e Shkencave, as nga ndonjë departament i specializuar apo institut kërkimor-shkencor shqiptar, etj. Po kështu, edhe vetë partitë politike apo Parlamenti duhet ta institucionalizojnë bashkëpunimin me fakultetet, departamentet, studiot apo organizmat e specializuara për përpunimin, analizën dhe gjithë mekanizmin e përgatitjes dhe miratimit të platformave e paketave të tyre të politikave ekonomike e zhvillimore.

Shembujt nga vendet më të zhvilluara të botës në këtë drejtim nuk mungojnë. Në SHBA, Kongresi punëson direkt apo indirekt në funksion të nevojave të tij për konsulencë dhe oponencë të specializuar më shumë se 6000 ekonomistë, në Francë janë të organizuara 634 organizma të specializuar në sferën ekonomiko-financiare dhe të zhvillimit të ngarkuara institucionalisht për të këshilluar e bashkëpunuar me Qeverinë dhe institucionet e tjera si Parlamenti, Senati, Partitë politike, Ministrinë, Prefekturat, etj. Në Gjermani, Spanjë, Kanada, Angli, etj., në funksion të deputeteve apo senatorëve, komisioneve apo byrove parlamentare ka fonde të veçanta që vihen në dispozicion të tyre për të siguruar analiza ekonomike e financiare, platforma e paketa politikash zhvillimore, qëndrime profesionale për fenomenet më të mprehta ekonomike bashkëkohore, deri dhe te kryerja e analizave konkrete për ligje të veçanta që lidhen e ndikojnë direkt apo indirekt në çështjet e zhvillimit ekonomik. Në të gjitha institucionet e tipit të Ministrive të ndryshme, në vendet e zhvilluara por dhe në ato në zhvillim gjenden njësi e drejtori të specializuara për analizat ekonomike e financiare, për studimin e tregjeve dhe cmimeve ndërkombëtare, për studimin e përvojës dhe zgjidhjeve të vëndeve të tjera të përafërta, për divulgimin e literaturës dhe informacionit ekonomik e financiar.

Ndërkohë që një deputet shqiptar, gjatë një mandati 4 vjeçar, mund të miratojë me qindra ligje të rëndësishme për zhvillimin ekonomik e social të vendit pa patur asnjë kontakt apo asistencë të specializuar e profesionale në fushën e ekonomisë dhe financave, dhe kjo jo gjithmonë për *“faj”* të tij, por mbi të gjitha për *“faj”* të koncepteve arkaike për domosdoshmërinë e simbiozës *“politikë-ekonomi”* si dhe mungesës së strukturave e financimeve të nevojshme. Shumë rrallë këto vende gjenden përballë të *“papraturave”* apo kapricëve të tregjësve ndërkombëtare sic u gjendëm dhe vazhdojmë të gjenden sot Ministra apo vendimmarrës të niveleve të tjera në Shqipëri kur është fjala për cmimin e grurit apo miellit, perimeve apo naftës, energjisë elektrike apo gazit.

EVROPA NË KËRKIM TË EKONOMISË SË DIJES

DR.GJERGJI FILIPI¹

ABSTRAKT. *Iniciativa e Komisionit Evropian, për ngritjen e Institutit Evropian të Teknologjisë është bërë shkas për diskutimet e kohëve të fundit mbi rëndësinë e ekonomisë së dijes në epokën e globalizmit. Emërtimi i zgjedhur nga Komisioni për këtë institucion është sugjektiv nga pikëpamja e analogjisë me të mirënjohurin Instituti Teknologjik i Masaçusetsit. Lind pyetja nëse ngjashmëria është thjesht një koïncidencë terminologjie apo mund të interpretohet përtej saj, mbi logjikën politikbërëse që qëndron pas këtij propozimi. Analiza në brendi të kësaj eseje përshkruan fillimisht disa tipare të veçanta të globalizimit modern, që është shndërruar në procesin më imponues me të cilin përballet zhvillimi i sotëm shoqëror. Ekonomia e dijes dhe politikat që e mbështesin atë qëndrojnë tashmë në thelb të konkurrencës globale, si pasojë e ndërvarrësisë së theksuar si rezultat i liberalizimit të shkëmbimeve dhe intensifikimit të novacionit. Këto tendenca përlligjin prezantimin e politikave të arsimit dhe kërkimit shkencor si instrumente të domosdoshme për ekonominë të avancuar në ruajtjen e pozicionit të tyre konkurrues në tregun global. Gjatë kësaj analize do t'i kushtohet një rëndësi e veçantë eksperiencës amerikane si një model suksesi në kombinimin e këtyre politikave. Argumentimi do të vazhdojë me prezantimin e kësaj veçantie si një frymëzim potencial për politikbërësit evropianë në përpjekjet e tyre për t'u përballur me sfidat moderne të konkurrencës globale.*

GLOBALIZIMI DHE NOVACIONI

Globalizimi është një prej tendencave më të spikatura të zhvillimeve moderne në ekonominë mbarëbotërore. Tashmë, ndërvëprimi në shkallë globale i marrëdhënieve ekonomike mes shteteve nuk kufizohet vetëm në interpretimin klasik të shfrytëzimit efikas të burimeve. Epoka e globalizimit evidentoi ekzistencën e një tjetër faktori thelbësor në shpjegimin e faktorëve total të produktivitetit, duke plotësuar kështu interpretimin fillestar, si një funksion të kufizuar kryesisht tek puna dhe kapitali.

Në ditët e sotme po përdoren forma që gjenerojnë më shumë produktivitet sesa thjesht kombinimi i mundit dhe investimeve, dhe faktori risi në këtë ekuacion modern është pikërisht dija. Dija është shndërruar në një faktor thelbësor në përcaktimin e nivelit tonë të mirëqenies dhe përbën një element kyç për zhvillimin dhe avancimin ekonomik. Përmes dijes ne sot jemi më të mençur në përdorimin e faktorëve të tjerë të produktivitetit. Tiparet aktuale të globalizimit kanë ndryshuar pikërisht falë ndikimit të novacionit dhe teknologjisë në përcaktimin e prirjeve dhe praktikave globale. Zhvillimet moderne të teknologjisë kanë ndikuar jo vetëm mbi modelet ekonomike kombëtare, por kanë kontribuar në mënyrë thelbësore edhe mbi ritmet e integritit global të shoqërisë përmes reduktimit të kostove të komunikimit dhe transportit.

¹Autori është pedagog i Univeristetit Evropian të Tiranës

Kompanitë shumëkombëshe po luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në zhvillimet ekonomike moderne, sidomos duke ndikuar ndjeshëm tendencat e tregtisë ndërkombëtare, si nga pikëpamja sasiore ashtu edhe nga ajo cilësore. Avancimet teknologjike në fushën e komunikimit (ICT) dhe transportit i kanë bërë distancat gjeografike të papërfillshme për kompanitë shumëkombëshe në përpjekjet e tyre drejt shpërndarjes efikase të burimeve. Për rrjedhojë këto kompani, gjithnjë e më tepër po i transferojnë proceset e prodhimit drejt vendeve që ofrojnë kosto më të ulëta të krahut të punës, siç janë Kina apo India, në orvatjet për të ruajtur pozicionet konkurruese në kontekstin global. Diversifikimi gjeografik i zinxhirit të prodhimit, nuk do të ishte bërë i mundur pa intensifikimin e zhvillimeve teknologjike që kanë sjellë tkurrjen efikase të hapësirave gjeografike globale.

Pas ndryshimeve gjeopolitike të fillimit të viteve '90, Amerika u pa si superfuqia e vetme e botës. Disa prej politikanëve perëndimorë e etiketuan globalizimin bashkëkohor si një fenomen që nuk i linte asgjë mangut amerikanizimit të kulturave të tyre, zakoneve dhe mënyrës së të bërit biznes. Thomas Friedman pohon se

Globalizimi ka një fytyrë amerikanë të dukshme: Ai vesh veshët e Mickey Mouse, ha Big Macs, pi Koka Kola apo Pepsi dhe përdor një laptop të IBM apo Apple, që funksionon me Windows, me një procesor Intel Pentium dhe një lidhje rrjeti nga Cisco Systems.²

Globalizimi i shkon për shtat Amerikës edhe për shkak të disa tipareve të natyrshme. “Amerika është një shoqëri ku ka një ujdi të ngushtë mes normave kulturore, fleksibilitetit dhe transparencës, dhe normave të biznesit jashtëzakonisht të vlerësuar nga sistemi i globalizimit” dhe “sa më e madhe të jetë papajtueshmëria mes normave kulturore të një vendi dhe normave të sistemit të Globalizimit, aq më i mundimshëm do të jetë procesi i përshtatjes me të”.³

Disa kritikë thonë se globalizimi nuk është asgjë më tepër sesa imponimi i kulturës amerikane mbi të gjithë botën. Ata argumentojnë se ky ‘imperializëm kulturor’ imponon vlerat sikurse edhe produktet amerikane, promovon komercialen në kurriz të autentikes, si dhe zëvendëson esencialen me sipërfaqësoren.

Fakti që Amerika ka qenë për një kohë të gjatë në krye të forcave globalizuese nënkupton në dukje se Globalizimi standartizon sjelljet sociale dhe kulturore që mund t'i atribuohen amerikanizimit. Sidoqoftë, roli i luajtur nga Amerika në këtë proces, më tepër sesa ai i ushtrimit të një hegjemonie kulturore, është të zhvilluarit e biznesit të suksesshëm dhe praktikave që promovojnë më tej këto tendenca dinamike globale. Siç e formulon edhe Friedman, “Ne [Amerika] nuk jemi tigri. Globalizimi është tigr”⁴, ndërsa Amerika është më e përshtatshme për ta ngarë këtë ‘tigr’ dhe për të nxitur pjesën tjetër të botës ta ndjekë nga pas.

Ndërveprimi i novacionit të jashtëzakonshëm teknologjik i kombinuar me shtrirjen botërore i jep globalizimit modern një fuqi të vrullshme ndryshimi.⁵ Zhvillimet në shkencë dhe teknologji hapin mundësi të reja të pafundme si për prodhimin ashtu edhe për shkëmbimin e produkteve. Një sërë produkte të reja të teknologjisë së lartë arrijnë të ofrohen në treg me çmime të arsyeshme falë shfrytëzimit të mundësive që ofron integrimi global i tregjeve, përmes eliminimit virtual të kufijve kombëtarë. Ekonomia amerikane i ka dhënë një theks të veçantë novacionit gjatë dy dekadave të fundit. Kryesisht për shkak të këtij pozicioni pararendës në ekonominë e novacionit, Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) kanë marrë rol udhëheqës sa i përket “tigr” të globalizimit duke përcaktuar standardet dhe ritmin për pjesën tjetër të konkurrentëve globalë. Ndonëse me një boshllëk

²Thomas L. Friedman, *The Lexus and the Olive Tree* (New York: Farrar Straus & Giroux, 1999), 309.

³*Ibid.*, 335.

⁴*Ibid.*, 309.

⁵Will Hutton and Anthony Giddens (eds.) *On The Edge. Living with global capitalism* (London: Vintage, 2001), vii.

teknologjik të konsiderueshëm mes të dyve, Bashkimi Evropian (BE) po ndjek të njëjtën sfidë të mbështetjes dhe inkurajimit të novacionit si një mënyrë e sigurtë dhe tashmë e domosdoshme drejt shtimit të vendeve të punës, ritmeve të zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies.

ARSIMI DHE KËRKIMI SHKENCOR SI KATALIZATORË TË PRODUKTIVITETIT

Për ekonomitë e zhvilluara, dija përbën faktorin më të rëndësishëm në përcaktimin e nivelit të mirëqenies, gjë që i orienton ato drejt avancimeve të theksuara teknologjike, pra tek një lloj ekonomie thellësisht e bazuar tek dija (knowledge-based economy).⁶

Me aplikimin e konceptit të ekonomisë së dijes, ekonomistët gjenden përpara sfidës për të konsideruar përtej faktorëve klasikë të produktivitetit, që janë krahui i punës dhe kapitali. Paul Romer dhe të tjerë kanë argumentuar se teknologjia, dhe dija mbi të cilën bazohen zhvillimet e saj, vlen të konsiderohet si një faktor i tretë produktiviteti në ekonomitë e avancuara të ditëve tona.⁷ Meqenëse shumë prej rezultateve të kërkimeve dhe studimeve gjejnë rrugën e transformimit në mallra dhe shërbime apo në rritje të kapaciteteve institucionale, dija dhe kualifikimi janë shndërruar tashmë në tipare vendimtare për përcaktimin e ritmeve ekonomike dhe të mirëqenies. Gjithashtu, energjia për të gjeneruar ide të reja dhe për t'i transformuar ato në produkte tregtare dhe shërbime që blihen nga konsumatorët, po bëhet gjithnjë e më tepër një faktor thelbësor në përcaktimin e pozicionit konkurrues në arenën globale. Arsimi dhe kërkimi shkencor qëndrojnë në thelb të këtij transformimi, duke qenë se kapaciteti për të adaptuar, shpërndarë dhe maksimizuar avancimet teknologjike është i lidhur ngushtë me nivelin e profesionalizmit dhe efektivitetin e sistemeve arsimore.

Kjo tendencë që ka ushqyer kërkesën për dije dhe informacion ka imponuar ndryshime edhe mbi pritshmëritë prej sistemeve arsimore, meqenëse këto të fundit luajnë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në kualifikimin e forcave të punës dhe në përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut të punës. Robert Barro në studimin e tij me titull "Arsimi si Përcaktues i Rritjes Ekonomike" konkludon se: "Pritet një rritje e rolit të teknologjisë në procesin e zhvillimit, përderisa punonjësve që do të shkollohen në sistemet aktuale arsimore iu duhet të përshtaten me dijet e reja dhe teknologjitë e avancuara".⁸ Synimi final i këtij studimi është të argumentojë një lidhje të tipit shkak-pasojë ndërmjet nivelit arsimor dhe ecurisë së zhvillimit. Pra të argumentojë se sa më i lartë të jetë niveli i përgjithshëm arsimor, aq më i madh do të jetë potenciali për rritje ekonomike dhe zhvillim. Nga ana tjetër, ritmet e përsheptuara në krijimin e dijes paraqesin sfida të reja lidhur me përmbajtjen dhe metodologjinë e arsimit. Mësimi mekanik i fakteve po bëhet gjithnjë e më i papërshtatshëm në krahasim me të mësuarit e mekanizmit për përfitimin e saktë dhe të shpejtë të informacionit të duhur. Rritja e konkurrencës globale ka ndikuar gjithashtu në nevojën për trajnimin e të rinjve për të qenë më elastikë dhe për të siguruar aftësitë e duhura që do t'i mundësojnë përshtatjen e shpejtë me tregun e punës në një realitet global që karakterizohet nga ritme të larta ndryshimesh. Një paketë studimore e Levy dhe Murnane analizon tipet e aftësive për të cilat ka gjithnjë e më pak kërkesë ose që janë zëvendësuar nga kompjuterat, si dhe tipet e aftësive ende të kërkuara në tregun e punës. Analiza hedh dritë mbi aftësitë që nevojiten për përballjen në tregun amerikan të punës duke marrë në konsideratë përgjegjësitë specifike sipas posteve.⁹ Gjatë kësaj analize, autorët i ndajnë përgjegjësitë respektive (në bazë të aftësive që nevojiten) në pesë kategori: ekspertizë, komunikim

⁶Carl J. Dahlman et al, *World Development Report 1998/99, Knowledge for Development* (Washington DC: World Bank and Oxford, 1999).

⁷Paul M. Romer, "Endogenous Technological Change," *Journal of Political Economy* 98, no. 5 (1990): 71-102.

⁸Robert J. Barro, "Education as a Determinant of Economic Growth"; marrë nga: www.hoover.org/publications/books/fulltext/ed21st.

⁹Frank Levy and Richard Murnane, *The New Division of Labor: How Computers Are Creating the New Job Market* (Princeton, NJ: Princeton University Press and Russell Sage Foundation, 2004).

kompleks, njohuri normale, aftësi praktike normale dhe aftësi thjesht praktike. Në përfundim u vërejt se sasia e vendeve të punës që kërkonin aftësi prej eksperti apo komunikim kompleks u rrit në mënyrë të qëndrueshme gjatë viteve '70, '80 dhe '90. Ndërsa individët e punësuar në poste me përgjegjësi që mjaftoheshin vetëm tek njohuritë normale apo tek aftësitë praktike normale mbetën të qëndrueshme gjatë viteve '70 dhe shënuan rënie gjatë dy dekadave që pasuan. Së fundmi, kategoria e mbetur e forcave të punës që bazoheshin tek aftësitë thjesht praktike shënuan rënie përgjatë kësaj periudhe dhe ritmet e kësaj rënieje u intensifikuan me kohën.

Një tjetër implikim për sistemin arsimor dhe praktikën trajnuese lidhet me rëndësinë në rritje që po merr shkollimi i vazhdueshëm (lifelong education). Ky aspekt ka të bëjë me nevojën e vazhdueshme për të përditësuar dijet dhe aftësitë për shkak të njërit prej tipareve më specifike të dijes, "jetëgjatësisë" së saj të shkurtër.¹⁰ Qasja tradicionale ndaj të studiuarit për një numër të caktuar vitesh për të siguruar një diplomë të nivelit universitar apo së shumti të nivelit master përpara avancimit drejt jetës profesionale po zëvendësohet gradualisht nga praktikën e shkollimit të vazhdueshëm. Trajnimi, si një instrument specifik aftësimi, është bërë tashmë pjesë integrale e profilizimit profesional dhe mund të ofrohet në kontekste të ndryshme: në punë, në institucione të specializuara të arsimit të lartë apo edhe në shtëpi përmes mekanizmave të studimit në distancë.

Si rrjedhojë e ritmeve të larta të progresit shkencor dhe teknologjik, sistemet arsimore i janë larguar modelit klasik të të mësuarit të fakteve dhe të dhënave bazike 'per se'. Njëkohësisht i është kushtuar rëndësi në rritje asaj që mund të quhet dije apo aftësi metodologjike, ose e thënë me fjalë të thjeshta aftësisë për të mësuar në mënyrë të pavarur. Në mjedisin aktual të teknologjisë intensive, më tepër sesa vetëm përvetësimi i mirë i dijeve del në pah domosdoshmëria për aftësimin e krahut të ri të punës për t'i aplikuar këto dije në praktikë, duke mundur kështu një lidhje të drejtpërdrejtë midis sistemeve arsimore dhe produktivitetit ekonomik. Për sistemet arsimore të vendeve që përpiqen të jenë në pararojë të konkurrencës globale, tashmë mbetet një domosdoshmëri dhënia e përparësisë aspekteve të tilla si kërkimi i informacionit, analizimi, zotësia për të arsyetuar si dhe zgjidhja e sfidave që lindin si rrjedhojë e evolucionit teknologjik.

Sistemi amerikan i arsimit vlerësohet në këtë kontekst si më i suksesshmi në përballimin e sfidave aktuale të epokës së globalizimit nëpërmjet kombinimit efikas të dijeve të fituara nëpërmjet arsimit me aplikimin e tyre në praktikë. Rreth gjysmës së dytë të viteve '70, ekonomia industriale amerikane u eklipsua disi nga ekonomia e shërbimeve që po rritej me shpejtësi dhe që mbështetej në një strukturë më të larmishme aftësish, që rrjedhimisht thithte punonjësit me arsim më të lartë. Gjatë kësaj periudhe, vetëm 28% e punonjësve (prej moshës 30 deri në 59 vjeç) kishin ndjekur studime pas shkollës së mesme. Nëse e krahasojmë këtë periudhë me aktualen, në të njëjtën situatë arsimore ndodhen më shumë se 60% e punonjësve ndërsa afro një e treta e totalit të punonjësve disponojnë grada të avancuara pasuniversitare.¹¹

Meqenëse avancimi i teknologjisë dhe thellimi i globalizimit pritet të intensifikohen, kërkesa për forca të kualifikuara pune do të vazhdojë të njohë rritje. Projektionet e nivelit të punësimit sipas llogarive të Zyrës së Statistikave të Punës në SHBA tregojnë se postet që kërkojnë të paktën arsim të lartë priten të rriten me 22% mes 2002 dhe 2012, afërsisht sa dyfishi i ritmit të rritjes së posteve për të cilat nuk kërkohet diplomë universitare.¹² Këto të dhëna flasin për përparësinë e institucioneve universitare amerikane që kanë investuar vazhdimisht për zhvillimin dhe shfrytëzimin e teknologjive të reja në funksion të rritjes së produktivitetit ekonomik. Në gjuhën e shifrave, mendohet se rritja me një vit

¹⁰Jean Meister, "Extending the Short Shelf Life of Knowledge," *Training & Development*, (1998): 52-59.

¹¹Të dhënat u siguruan nga *Higher Education's Contribution to the Knowledge Economy*; marrë nga: <http://www.solutionsforourfuture.org/site/DocServer/08.Knowledge-Economy.pdf?docID=103>.

¹²Ibid.

e nivelit mesatar të shkollimit, mund të rrisë nga 6 deri në 15 përqind ritmet e rritjes ekonomike.¹³

Pjesa më e madhe e kolegjeve dhe universiteteve amerikane ofrojnë programe të arsimit superior me një numër të madh opsionesh akademike për studentët, një staf profesorësh shumë të kualifikuar sikurse edhe mundësi të avancuara për kërkime shkencore, rezultatet e të cilave shpesh publikohen në revista të specializuara të qarkullimit ndërkombëtar. Mundësia për ndryshimin e drejtimit të studimit edhe pas regjistrimit fillestar është një praktikë e zakonshme për studentët amerikanë. Megjithatë kjo mund të shkaktojë një zgjatje të kohës së diplomimit në një fushë të re, e drejta për të ndryshuar drejtimin e studimit i jep studentëve mundësinë për të lëvizur në programe që i përshtaten më mirë aftësive të tyre por, mbi të gjitha, për të përmbushur më mirë kërkesat apo dinamikën e tregut të punës.

Një avantazh i qartë e domethënës i sistemit arsimor amerikan lidhet me praktikën e bashkëpunimit midis kompanive dhe universiteteve në fusha të ndryshme studimore, duke krijuar në këtë mënyrë përfitime të ndërsjellta. Mjaft universitete inkorporojnë teknologjitë më të fundit në kurrikulat e tyre, duke i inkurajuar studentët të pajisen me aftësi praktike përpara diplomimit. Teknologjitë e specializuara i ndihmojnë studentët të maksimizojnë potencialet e tyre dhe të fitojnë eksperiencën që po bëhet gjithnjë e më e nevojshme për t'ju përshtatur kërkesave të një tregu pune konkurrues në nivel global.

Nga ana tjetër kërkuesve shkencorë i ofrohet mundësia e testimit apo aplikimit të interesave të tyre teorike. Mbi të gjitha rezultatet finale janë një mbështetje e paçmueshme për biznesin që përfiton drejtpërsëdrejti faktorin e tretë produktiv. Pikërisht ky lloj kombinimi praktik i sistemit arsimor me sektorin produktiv mendohet të jetë çelësi i suksesit konkurrues në epokën globaliste të bazuar mbi ekonominë e dijes.

Ndërvarësia globale në rritje dhe ekonomia e dijes i kanë dhënë formë shoqërisë sonë moderne në një mënyrë që dobia e arsimit më tepër se vetë individëve, i sjell përfitime gjithë ekonomisë kombëtare dhe për më tepër e përçon dobinë gjithnjë e më tepër drejt avancimit të përgjithshëm në rang botëror.

SFIDA E BE-SË DREJT NOVACIONIT

Me intensifikimin e konkurrencës në tregjet ndërkombëtare, Bashkimi Evropian po përballët gjithnjë e më tepër me sfidat globale të produktivitetit që vijnë nga SHBA-ja dhe Azia Juglindore në zhvillim. Rritja ekonomike e shpejtë e Kinës dhe Indisë nuk nënkupton vetëm lindjen e konkurrentëve të rinj nga ana e ofertës, por gjithashtu shtrirjen e tregjeve globale drejt territoreve të reja me interes për nga potenciali konsumator. Për të përfituar nga këto mundësi, BE-ja duhet të përshtasë sistemin e saj të politikave për të adresuar në mënyrë sa më efektive sfidat aktuale të konkurrencës globale.

Kjo konkurrencë po shtyhet drejt fabrikimit të produkteve dhe shërbimeve që janë të orientuara në mënyrë intensive nga aplikime novative apo zbulime që përfshijnë edhe teknologjitë më të fundit. Kina po shënon progres të ndjeshëm në rrjedhën e saj të industrializimit me një numër të konsiderueshëm e në rritje të stokut të investimeve të huaja direkte, që së bashku me bazën e saj të gjerë shkencore dhe me bollëkun e forcave të punës do të mjaftonin për t'i dhënë ekonomisë së këtij vendi shumë shpejt një pozicion udhëheqës nga pikëpamja konkurrenciale. Ndërkohë India si

¹³Të dhënat u siguruan nga: *Solutions For Our Future*; marrë nga: http://www.solutionsforourfuture.org/site/PageServer?pagename=economy_national_growth.


përfituesja më e madhe e globalizimit sa i përket nënkontraktimit përtej kufijve (outsourcing and offshoring), po sfidon dukshëm në sektorin e shërbimeve falë përmasës së forcave të kualifikuara të punës me kosto të ulët me avantazhin e zotërimit të gjuhës angleze. Presioni konkurrues në sistemin tregtar botëror i këtyre ekonomive aziatike në zhvillim pritet të vazhdojë me ritme të përshpejtuara. Përsa i përket sektorit privat, ndër 300 kompanitë më të mëdha në renditjen globale të Teknologjisë së Informacionit (IT) afro 74% operojnë në ShBA, ndërsa në renditjen e 300 kompanive më të mëdha nga pikëpamja e shpenzimeve për Kërkim dhe Zhvillim (R&D) amerikanët zotërojnë afro gjysmën.¹⁴

Në këto rrethana, për BE-në bëhet e domosdoshme rritja e potencialit të saj produktiv, sidomos në ato sektorë ku tashmë është e pashmangshme përballja me konkurrencën në rang global. Për t'ju përgjigjur këtyre sfidave, Evropa nuk ka alternativë tjetër veçse të përmirësojë në mënyrë rrënjësore kapacitetet e saj novative. Pikërisht këtu qëndron edhe suksesi i praktikave dhe politikbërjes amerikane, që ka gjetur një ekuilibër optimal dhe praktik të kombinimit të sistemit arsimor dhe kërkimit shkencor me avancimin teknologjik bashkëkohor, duke maksimizuar në këtë mënyrë produktivitetin ekonomik që ka për bazë novacionin dhe zhvillimin teknologjik. Kjo lloj ndërthurje efektive e potencialit të dijes që brumoset në laboratorët universitarë e vënë në zbatim përmes kapaciteteve produktive të sektorit të biznesit përbën një model suksesi. Gjithashtu ky model ofron përparësi të dukshme dhe lehtësisht të zbatueshme edhe në kushtet e politikbërjes në nivel komunitar brenda Bashkimit Evropian.

Sipas një renditje të vitit 2005 të publikuar nga Financial Times, 17 ndër 20 universitetet më të mira të botës ndodhen në ShBA, dy në Evropë dhe vetëm një në Japoni.¹⁵ Kërkuesve Evropianë ju akorduan 73% e Çmimeve Nobel gjatë viteve 1901 - 1950, ndërsa gjatë dekadës së fundit kjo shifër ra në nivelin e 20%-shit. Tërheqja e natyrshme e kapaciteteve intelektuale Evropiane ndaj tregut amerikan mbetet gjithashtu evidente. Gjatë një serie intervistash me inxhinierë dhe fizikantë Evropianë që po kryenin doktoraturat në SHBA, rreth 60% e tyre u shprehën se kishin ndër mend të ofronin kontributin e tyre në tregun amerikan të punës pas përfundimit të studimeve.

Në të njëjtën kohë, ekonomia e Bashkimit Evropian po rritej më ritme më të ulëta se sa ajo e ShBA-së dhe së fundmi shënoi mangësi sa i përket ritmeve të saj të produktivitetit.

ECURIA E PBB PËR FRYMË E SHPREHUR NË STANDARTET E FUQISË
BLERËSE (PPS) ME ÇMIMET KONSTANTE TË 1995. SHBA=100



Burimi: Facing the Challenge: The Lisbon strategy for growth and employment, Report from the High Level Group chaired by Wim Kok, November 2004. p 14.


¹⁴Burimi OECD ; marrë nga : http://www.oecd.org/document/23/0,2340,en_2649_37409_33987543_1_1_1_37409,00.html

¹⁵"Making Europe a home fit for the next Einstein," Financial Times, 22 Shkurt 2006, sec. Comment, p. 19.

Në periudhën e pasluftës së dytë botërore, procesi i ngushtimit të diferencës nga pikëpamja e prodhimit për frymë midis Bashkimit Evropian dhe ShBA erdhi drejt fundit në mesvitet '70. Kjo tendencë devijoi përsëri pas 1996, kohë kur Evropa humbi terren ndaj ShBA-së. Konkretisht gjatë kësaj periudhe rritja mesatare vjetore e PBB-së për frymë në Evropë ka qenë afro 0,4 % më e ulët se ajo e ShBA-së.

Këto luhatje në nivelin e rritjes ekonomike u shoqëruan edhe me ndryshime në nivelin e produktivitetit të punës. Evropa humbi terren kur për herë të parë pas disa dekadash, produktiviteti i punës ishte më i ulët se në ShBA. Rënia e produktivitetit të punës në mesin e viteve 1990 në BE i atribuohet zvogëlimit të investimeve për punonjës si dhe ngadalësimit të progresit teknologjik. Ky ngadalësim erdhi si rezultat i mungesës së progresit në harmonizimin e politikave arsimore, por sidomos si pasojë e rënies së investimeve në fushën e Kërkimit dhe Zhvillimit (R&D). Kjo situatë ndikoi tek reduktimi i kapaciteteve për të transformuar kërkimin shkencor në produkte dhe procese të marketueshme, që solli uljen e produktivitetit të industrive dhe shërbimeve që lidhen me teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (ICT).

ECURIA E PBB PËR FRYMË E SHPREHUR NË STANDARTET E FUQISË
BLERËSE (PPS) ME ÇMIMET KONSTANTE TË 1995. SHBA=100



Burimi: Facing the Challenge: The Lisbon strategy for growth and employment, Report from the High Level Group chaired by Wim Kok, November 2004. p 14.

Pozicioni i BE-së në arenën kompetitive globale po kërcënohet gjithnjë e më tepër nga hyrja e aktorëve të rinj dhe tipareve të reja që imponon globalizimi. Në dritën e këtyre zhvillimeve Evropa e Bashkuar duhet të gjejë instrumentat e duhur për të adresuar në mënyrë të kujdesshme këto sfida, por në të njëjtën kohë duke evituar komprometimin e modelit të saj karakteristik social dhe institucional. Për shembull debati ideologjik në lidhje me dimensionin publik të arsimit apo shëndetësisë mbetet i hapur dhe shumë sensitiv në rastin e Evropës së Bashkuar. Nga ana tjetër Evropa ka një reputacion të mirënjohur në botë për sa i përket barazisë së të ardhurave, reduktimit të varfërisë, jetëgjatësisë, nivelit të vdekshmërisë foshnjore, etj.

Për të ruajtur pozicionin e liderit në ekonominë globale dhe për të rritur standardin e jetesës, BE-ja po synon të përshpejtojë rritjen e punësimit dhe produktivitetit përmes një game të gjerë reformash. Përgjigja e Evropës ndaj këtyre sfidave komplekse është pasqyruar në "Strategjinë e Lisbonës". Kjo strategji përfshin një bashkësi synimesh dhe objektivash, si dhe përcakton në një farë mase ndryshimet e nevojshme për mbështetjen e zhvillimit ekonomik. Ambicja strategjike e Lisbonës saktëson se ekonomia e Evropës së Bashkuar duhet të jetë natyrshëm novative, në pararojë të zhvillimeve teknologjike dhe të nxisë ritmet e rritjes dhe të punësimit për të cilat BE-ja ka nevojë.

Në mars të vitit 2000, liderët e pesëmbëdhjetëshes Evropiane të asaj kohe u angazhuan ta shndërronin BE-në deri në vitin 2010 “në ekonominë më dinamike dhe konkurruese në botë, të bazuar tek dija dhe të aftë për rritje të qëndrueshme ekonomike me më shumë vende pune dhe me kohezion më të madh social, në respektim të plotë të normave mjedisore”.¹⁶ Kjo u parashikua të arrihej nga një paketë iniciativash dhe ndryshimesh strukturore, bashkërendimi i të cilave do të çlironte potencialin evropian të zhvillimit. Mes politikave të evidentuara si prioritare për ndërhyrje u radhitën:

- joshja e shkencëtarëve dhe kërkuesve drejt Evropës;
- dhënia e përparësisë absolute fushës së Kërkimit dhe Zhvillimit (R&D);
- nxitja e përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit;
- hartimi i strategjive mbështetëse për shkollimin e vazhdueshëm.

Lisbona mund të kuptohet si një mekanizëm tranzitiv drejt fuqizimit ekonomiko-industrial të Bashkimit Evropian për të kapur pozicionin e udhëheqësit ekonomik global. Synimi qendror i strategjisë është rritja e investimeve publike dhe private për Kërkimin dhe Zhvillimin, duke e konsideruar këtë hallkë si epiqendrën e përpjekjeve politikbërëse në funksion të krijimit dhe përhapjes së kapitalit të dijes.

Universitetet janë në një pozicion të privilegjuar për të ofruar një kontribut unik në kushtet e transformimit të përgjithshëm industrial, ekonomik dhe shoqëror në epokën e konkurrencës së ethshme globale. Në të njëjtën kohë, drejtime studimore teorike si ekonomiksi, juridiku, shkencat politike po përshkohen gjithnjë e më tepër nga aspekte të lidhura me zhvillimet teknologjike.

Në fillim të vitit 2006, Komisioni Evropian bëri publike planet e tij për krijimin e Institutit Evropian të Teknologjisë. Ideja për ngritjen e këtij Instituti u propozua fillimisht nga ana e Presidentit të Komisionit Evropian, José M. Barroso, në kuadër të Strategjisë për Nxitjen e Punësimit dhe Rritjes Ekonomike.¹⁷ Dr. Barroso ka pasur një eksperience frymëzuese personale në fushën kërkimore në ShBA pranë Universiteve të mirënjohura si Columbia dhe Georgetown University.¹⁸ Imazhi i suksesshëm i Institutit Teknologjik të Masaçusetsit si një institucion lider botëror në fushën e kërkimeve shkencore me një ndikim të spikatur në industri, ka nxitur iniciativën e ngjashme të Komisionit në përpjekje për të krijuar një ekuivalent evropian.

Një prej qëllimeve të Institutit Evropian të Teknologjisë është fuqizimi i ‘trekëndëshit’ kërkim, arsim dhe transferim teknologjik. Përmes këtij propozimi, Komisioni përpiqet të adresojë sfidat teknologjike të BE-së duke forcuar themelet e kërkimit shkencor, si një nxitës kyç drejt novacionit. Gjithashtu synohet shndërrimi i universiteteve në qendra eficiente për kërkime shkencore ose në katalizatorë potencial novativ, duke angazhuar njëkohësisht edhe kapacitetet kërkimore nga ana e sektorit privat. Këto mekanizma pritet të ngushtojnë gjithashtu deficitin ekzistues kërkimor ndërmjet BE-së dhe ShBA-së.

Iniciativat evropiane në kërkim të shndërrimit të ekonomisë së dijes në motorin e zhvillimit të ardhshëm evropian, në përshtatje edhe të sfidave të konkurrencës globale mbeten një ide brilante dhe e kohës. Por suksesi i dukshëm dhe i vërtetë i saj do të vërtëtohet kur BE-ja të fillojë të vjelë frytet e para.

¹⁶Konkluzionet e Presidencës së BE-së, Lisbon European Council, 23 and 24 March 2000; marrë nga: http://www.consilium.europa.eu/ueDocs/cms_Data/docs/pressData/en/ec/00100-r1.en0.htm

¹⁷European Commission Press Release, 22 shkurt 2006; marrë nga: <http://www.europa.eu.int/rapid/pressReleasesAction.do?reference=IP/06/201&format=HTML&aged=0&language=EN&guiLanguage=en>

¹⁸Profili i José Manuel Barroso, marrë nga: http://ec.europa.eu/comm/commission_barroso/president/cv/index_en.htm

Kjo do të jetë sfida e vërtetë, pasi vetëm ndërhyrjet institucionale nuk janë të mjaftueshme për nxitjen automatike të novacionit në Evropën e Bashkuar. Suksesi i propozimit të Komisionit Evropian apo politikave novative me epiqendër ekonominë e dijes kërkojnë domosdoshmërisht një industri të gatshme për të përthithur rezultatet kërkimore të këtij Instituti apo të institucioneve të tjera të kërkimit dhe zhvillimit.

Së dyti, ekonomia e dijes dhe zhvillimet novative duhet të marrin trajtën e një kulture të përgjithshme dominuese në Europë. Instituti Evropian Teknologjik duhet të jetë shembulli i parë, që duhet të ndiqet jo vetëm nga iniciativa të ardhshme publike, por edhe nga ato private me mbështetjen e zhvillimeve novative brenda industrive lider.

Së fundmi, binomi institucion kërkimor-industri, duhet të mundësojë një komunikim optimal në të dyja kahet në mënyrë që rezultatet finale të kërkimit shkencor të arrijnë të gjejnë aplikimin e tyre praktik në produkte të marketueshme. Suksesi i plotë i këtij binomi do të jetë arritur, në kohën kur strategjitë largpamëse të arrijë t'i përgjigjen deri edhe perceptimeve të industrisë dhe nevojave të tregut për të ardhmen, me qëllim që Europës t'i sigurohen jo vetëm 'muskuj' për të përballuar konkurrencën globale por edhe risi në formën e një avantazhi konkurrues.

BIBLIOGRAFIA

Barber, B. R. "More democracy! More revolution!," *The Nation*, 26 October 1998, kryeartikull.

Barro, R. J. "Education as a Determinant of Economic Growth"; marrë nga: www.hoover.org/publications/books/fulltext/ed21st.

Dahlman, C. J. et al, *World Development Report 1998/99, Knowledge for Development* (Washington DC: World Bank and Oxford, 1999).

EU Presidency Conclusions, Lisbon European Council, 23 and 24 March 2000; marrë nga: http://www.consilium.europa.eu/ueDocs/cms_Data/docs/pressData/en/ec/00100-r1.en0.htm.

European Commission Press Release, 22 February 2006; marrë nga: <http://www.europa.eu.int/rapid/pressReleasesAction.do?reference=IP/06/201&format=HTML&aged=0&language=EN&guiLanguage=en>.

Friedman, T. L. *The Lexus and the Olive Tree* (New York: Farrar Straus & Giroux, 1999).

Higher Education's Contribution to the Knowledge Economy; marrë nga: <http://www.solutionsforourfuture.org/site/DocServer/08.Knowledge-Economy.pdf?docID=103>.

Hutton, W. and Giddens, A. (eds.) *On The Edge. Living with global capitalism* (London: Vintage, 2001).

Ján Figel', *Informal Education Council in Vienna, 16 March 2006*; marrë nga: http://europa.eu.int/comm/commission_barroso/figel/speeches/docs/06_03_16_inf_council_vienna_EIT_en.pdf.

Levy, F. and Murnane, R. *The New Division of Labor: How Computers Are Creating the New Job Market* (Princeton, NJ: Princeton University Press and Russell Sage Foundation, 2004).

Meister, J. "Extending the Short Shelf Life of Knowledge," *Training & Development*, (1998).

Organization for Economic Cooperation and Development; marrë nga: http://www.oecd.org/document/23/0,2340,en_2649_37409_33987543_1_1_1_37409,00.html.

Profile of José Manuel Barroso, marrë nga: http://ec.europa.eu/comm/commission_barroso/president/cv/index_en.htm.

Romer, P. M. "Endogenous Technological Change," *Journal of Political Economy* 98, no. 5 (1990).

Schildt, A. *Americanization*, in Junker, D. (ed.), *The United States and Germany in the Era of the Cold War, 1945-1990*, (Cambridge: Cambridge University Press, 2004).

Slater, J. "Call of the West. For India's Youth, New Money Fuels A Revolution," *The Wall Street Journal*, 27 January 2004.

Solutions For Our Future; marrë nga:

http://www.solutionsforourfuture.org/site/PageServer?pagename=economy_national_growth.

The International Student Guide to Education and Study in the USA; marrë nga: <http://www.usastudyguide.com/benefits.htm>.

DOSJE

SEKTORI PUBLIK NË UDHËKRYQ

KAPITULLIMI PA KUSHTE I SEKTORIT PUBLIK

HENRI CILI

SEKTORI PUBLIK - REFORMAT KOMPLEKSE QË NUK DUHEN VONUAR

Prof. Asoc. Dr. ARBEN MALAJ

TAKSA E SHESHTË DHE SJELLJA EKONOMIKE

Dr. SELAMI XHEPA

SEKTORIT PUBLIK – QEVERISJA DHE PERFORMANCA

Prof. Asoc. Dr. ADRIAN CIVICI

POTENCIALI I ARSIMIT PRIVAT DHE INTERESAT INDIVIDUALË E PUBLIKË

Dr. ERMAL HASIMJA

SHËNDETËSIA - RRUGA E GJATË DREJT SË MIRËS

Prof. Asoc. Dr. EDUART HASHORVA

SEKTORI BANKAR SI MODEL SUKSESI I MANAXHIMIT PRIVAT

ARTAN SANTO

SFIDAT DHE PROBLEMET E FORMIMIT TË MENAXHERËVE TË RINJ, TË AFTË
PËR T'JU PËRGJIGJUR NEVOJAVE TË SEKTORIT PUBLIK

Prof. Dr. FATMIR MEMAJ

EVOLUCIONI DHE SFIDAT E SHTETIT RREGULLATOR NË EUROPE

BURKARD EBERLEIN

KAPITULLIMI PA KUSHTE I SEKTORIT PUBLIK

HENRI CILI

Diskutimi për “sektorin publik” dhe atë “privat”, për kufijtë mes publike dhe private, janë debate të pashtershme në të gjithë botën, mes liberalëve ekonomikë dhe socialëve, mes filozofësh, ekonomistësh, mes shkollash ekonomike apo të mendimit. Ndaj rrezikon të biesh në një përsëritje të pashmangshme, sa herë që rimerret një temë e tillë. Sidomos nesër ndërmerret në mënyrë frontale. Por megjithatë ka një moment kur përkon një sistem idesh dhe konceptesh për organizimin dhe të shoqërisë e ekonomisë... me gjendjen në të cilën ndodhet një shoqëri apo një sistem ekonomiko-social. Gjate vitit 2007, më shumë se kurrë, Shqipëria u katandis në një ankimore të pamat publike: nuk ka drita, nuk ka ujë të pijshëm, nuk ka siguri në rrugët kombëtare, nuk ka sportele të mjaftueshme nëpër gjendjet civile, nuk ka serume nëpër spitale... nuk ka, nuk ka asgjë që të funksionojë mirë në sektorin publik në këtë vend. Në këtë ankimore të madhe, siç është shndërruar Shqipëria, ka megjithatë disa specifika për të cilat ia vlen të reflektosh. Nuk kemi një krizë, më saktë ka disa kriza njëherësh, të cilat janë pjekur të gjitha bashkë në një pikë të vetme pikërisht këtë verë. Edhe pse këto kriza ekzistojnë të gjitha prej vitesh, u desh thatësira që sapo na la për të zbuluar gjendjen reale në të cilën ndodhemi si “shoqëri shërbimesh”. Po pse tani u duk se “falimentimi pa kushte” i sektorit publik është një fakt i mirëpranuar nga të gjithë, kur Shqipëria ka të paktën 20 e ca vjet që luhetet në të tilla probleme, herë më të rënduara e herë më të lehtësuara si situata dhe si problematika. Pse tani, pse këtu, pse kështu? Këto tre pyetje, pjesë të së tërës janë shtruar sot për diskutim më shumë se kurrë.

Së pari, sot, më shumë se 17 vjet nga fillimi i transformimit të shoqërisë në një shoqëri tregu, disa sektorë të ekonomisë dhe shërbimeve kanë një përvojë të çmuar operimi në tregun e lirë, ndërkohë ato pjesë të ekonomisë që kanë mbetur ende shtetërore, përkundrazi kanë një degradim edhe më të madh. Pikërisht në këtë kontrast jetojnë sot shqiptarët.

Ekonomia shqiptare kaloi në kolaps të plotë në fillim të viteve ‘90-të, gjë që shërbeu si arsyeja kryesore e rënies së sistemit politik komunist. Megjithatë, ndërsa sektorë që dukeshin hapur se nuk funksiononin në atë kohë, si tregtia dhe shërbimet, “përfituan” me shpejtësi nga hapja, duke u privatizuar, disa shërbime të tjera publike si energjia, spitalet, telefonia apo arsimit, dukeshin një “kafshatë e madhe” për sektorin privat. Shteti ruajti ende në këto sektorë monopolin. Nga një qeveri në tjetrën, nga një emergjencë në tjetrën, ky vend nuk u ul më kurrë seriozisht për të parë se çfarë duhet të bënte me këto shërbime, të cilat funksionin gjithnjë e më keq.

Me përjashtim të telefonisë mobile, që ishte një sektor i ri shërbimi, jo thjesht për ne, por për të gjithë perëndimin, një industri e viteve ‘90-të, sektorët e tjerë të shërbimeve publike masive thuajse nuk u prekën fare nga pikëpamja e pronësisë, duke qëndruar në dorën e shtetit. Ja pra, ku jemi sot, 17 vjet më pas, kur këto shërbime nuk janë më as në nivelin e performancës së regjimit komunist. Janë shumë më poshtë.

Së dyti, këto shërbime nuk do të kishin kontrastuar kaq shumë nëse krahas tyre do të ishte zhvilluar një sektor privat, i cili funksionon gjithnjë e më mirë për klientët. Shërbimet e tjera private që funksionojnë mjaft mirë, ndeshen në rrugë e sipër me ato shërbime që ende i ruan shteti si monopoli, si p.sh., energjinë, ujin, spitalet, shkollat apo administratën publike, duke krijuar një pengesë të madhe edhe me funksionimin e tyre. Kjo rëndon edhe më tepër te qytetarët. Edhe te shërbimet private që siguron qytetari, pasoja katastrofike e keqfunksionimit të shërbimeve publike ndjehet dhe kushton për ta edhe më shumë.

Pikërisht, në këtë kryqëzim mes një zhvillimi 17-vjeçar të sektorit privat dhe një degradimi 17-

vjeçar të sektorit publik, duhet parë kriza e shoqërisë shqiptare, një krizë që për nga pasojat e gjithanshme ka krijuar një qytetar dhe një shoqëri në prag të “krizës së nervave”. Duke llogaritur brenda kësaj një prag falimentimi për çdo sipërmarrje.

Por e gjitha kjo mund të kthehet në një impuls pozitiv për të gjithë shoqërinë shqiptare, për politikën dhe aktorët e tjerë shoqërorë. Kjo krizë shumëfishe dhe e integruar mund të avancojë fort opinionin publik për një privatizim të plotë dhe total të shërbimeve publike, duke e spostuar rolin e shtetit drejt një tjetër drejtimi: drejt rolit të tij rregullator dhe arbitruës të tregjeve të lira. Po ashtu, politika ka një rast real të de-kompleksohet nga të gjitha mbetjet etatiste në logjikën programore dhe ekzekutive të formacioneve të mëdha politike në vend, që këmbëjnë vendet në drejtimin e Shqipërisë sipas rrotacionit politik.

SEKTORI PUBLIK - REFORMAT KOMPLEKSE QË NUK DUHEN VONUAR

PROF. ASOC. ARBEN MALAJ¹

ABSTRAKT. *Analiza e tranzicionit shqiptar të ndihmon të identifikosh faktin që edhe Shqipëria në hapat e para të hapjes së ekonomisë u bë pjesë e experiencave për të importuar modele të gatshëm, apo edhe experimente shkencore. Vendi eci shpejt me valën e parë të reformave, por liberalizimi, derregullimi, privatizimi dhe postprivatizimi, si pjesë thelbësore të një reforme ekonomike do të duhej të ishin më mirë të integruara për të rritur mundësitë e suksesit të tyre. Eseja shtjellon reformat e deritanishme, por dhe sfidat me të cilat po përballet sektori publik shqiptar.*

Debati për sfidat e sektorit publik organizuar nga *Universitetit European i Tiranës* ishte një eksperiencë pozitive, një cilësi e re dhe e mirëpritur. Duhet vlerësuar fakti që kemi një ambjent më të qetë dhe të interesuar për të ballafaquar këndvështrimet e ndryshme, duke tentuar drejt përafrimeve sidomos për sfidat. Tani nuk ka fusha të veçanta të *sektorit publik* të cilat në mënyrë ekskluzive e përjashtojnë mundësinë e angazhimit të *sektorit privat*. Ka rritje të *partneritetit* midis sektorit publik dhe privat edhe në funksione dhe shërbime publike, të cilat tradicionalisht konsideroheshin detyrime bazë të shtetit. Megjithatë, disa prej tyre dhe në sektorë strategjikë vazhdojnë të ofrohen nëpërmjet organizimeve dhe kompanive të kontrolluara nga *shteti*.

Pas tendencave për të komercializuar gjithçka, nuk janë të pakta edhe debatet për kufizimet, mangësitë dhe dështimet. Ekstremet gjithmonë kanë limitet e tyre. Ka debate jo të pakta që edhe dora e fshehtë e *Adam Smith-it*, sado e zgjatur, nuk mund të garantojë automatikisht suksesin. Është e vërtetë që bota po bëhet gjithnjë e më pak ideologjike dhe më shumë pragmatike, por njëkohësisht konstatohet se absolutizimi i zgjidhjeve smithiane, në disa raste ka qenë i vështirë, i deformuar dhe jo plotësisht i suksesshëm. Suksesi kushtezohet jo pak nga realiteti konkret, që njeh dhe mban parasysh traditën, kulturën, fazat e tranzicionit, ambjentin ekonomik, social dhe politik të çdo vendi.

Pak kohë më parë revista "The Economist" shtronte pyetjen: *A po kthehet Amerika majtas?* Shqetësimi bazë ishte gjendja e vështirë që po vonon ristrukturimin e sistemit të kujdesit shëndetësor, ku harxhohen rreth 16 % e GDP-së apo 2 trilion dollarë. Rezultojnë të pa siguruar 46 milion amerikanë dhe ku rreth 70 % e të siguruarve kanë siguracion pjesorë. Opsionet për një privatizim të plotë nuk janë mbështetur as nga vetë senatorët dhe kongresmenët republikanë.

Pak ditë më parë Summer-i, ish-sekretari i Thesarit Amerikan dhe ish-Presidenti i Universitetit të Harvard-it, hapi një diskutim interesant ku trajtoi riskun që do të ketë në ekonominë e vendeve perëndimore nga rritja e prezencës së *kompanive publike* nga Kina, Rusia dhe vende të tjera, të cilat janë duke tentuar të blejnë kompani apo pjesë të kompanive private në këto vende. Një pjesë e pjesëmarrësve në diskutimin blog, mbronin idenë që këto kompani kanë elementë të manaxhimit sipas parimeve themelore të kompanive private. Një pjesë e shikon suksesin e kompanive publike nga Rusia, Kina dhe vende të tjera nga statusi i privilegjuar që u krijojnë qeveritë e tyre më shumë se sa rezultati i konkurrencës së suksesshme në një treg global. Rastet e kompanive të suksesshme publike gjenden edhe në disa vende të tjera europiane.

¹Ish Ministër i Financave

SEKTORI PUBLIK SHQIPTAR DHE SFIDAT E TIJ

Analiza e *tranzicionit* shqiptar të ndihmon të identifikosh faktin që edhe Shqipëria në hapat e para të hapjes së ekonomisë u bë pjesë e experiencave për të importuar modele të gatshëm, apo edhe experimente shkencore. Vendi eci shpejt me valën e parë të reformave, por liberalizimi, derregullimi, privatizimi dhe postprivatizimi, si pjesë thelbësore të një reforme ekonomike do të duhej të ishin më mirë të integruara për të rritur mundësitë e suksesit të tyre.

Sukseset e *reformave* të para për të nxitur dhe mbështetur sektorin privat u kufizuan edhe nga dy elemente shumë të rëndësishëm. Së pari, nga mungesa e një *sektori bankar* dhe ndërmjetësish financiarë të zhvilluar, që nuk lehtësuan dhe garantuan mundësitë për kapitale financiare për bizneset e reja shqiptare në sfidën e tyre të modernizmit. Së dyti, nga mungesat e trashëguara të njohurive dhe *kapaciteteve manaxheriale*.

Vala e dytë e reformave eci shumë ngadalë, u zvarritën reformat që përfshijnë *sektorët strategjikë* të ekonomisë si energjia, telekomunikacioni, infrastruktura, furnizimi me ujë, shëndetësia dhe arsimi. Pati mospërputhje në fokus dhe në kohë për krijimin dhe eficiencën e kuadrin institucional dhe kapacitetet profesionale të enteve dhe autoriteteve rregullatore dhe mbikqyrëse. Në këtë realitet të tranzicionit tonë gjejmë rastet e suksesve, dështimeve, si edhe ndihmohemi për të konturuar dhe përballuar sfidat e së ardhmes.

Nëse do të shikonim rastet e dështimit mund të përfshijmë projektin pilot të përbashkët me Bankën Botërore për shpërndarjen dhe shitjen e energjisë elektrike. Ky projekt u experimentua në Vlorë, Elbasan dhe Shkodër. Me shumë vështirësi ecen projekti i Ujësjellsit të Elbasanit, një projekt i përbashkët me një kompani të sukseshme gjermane. Kontrata e manaxhimit të Hotel Tiranës, jo pak e kushtueshme dhe jo e sukseshme, pjesë e ristrukturimit të hotelit, projekt i përbashkët me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Ka edhe një sërë projektesh të tjera edhe në nivele vendore, ku partneriteti midis pushtetit vendor dhe privat kanë dështuar.

Edhe rastet e suksesshme janë të pakta. Ristrukturimi dhe privatizimi i *sektorit bankar*, i cili sot është rreth 99 % privat, por i ndihmuar edhe nga kapacitete të mira mbikqyrëse të Bankës Qëndrore. Një përjashtim ky në raport me kuadrin institucional dhe kapacitetet profesionale që janë të limituara në autoritetet rregullatore dhe mbikqyrëse të energjisë, telekomunikacionit, ujit, konkurrencës etj. Aplikimi i konçensionit në aeroportin kombëtar "Nënë Teresa" shpresohet të jetë i suksesshëm, duke nxitur më shumë konçensione në elementë të rëndësishëm të infrastrukturës shqiptare.

Telekomunikacioni është eksperiencë e një tregu me vonesa në një liberalizim sa më të plotë, me efekte pozitive jo të plota, sidomos në çmimet e shërbimit për konsumatorin. Ky rast që tregon sa thjeshtë *liberalizmi dhe privatizimi* nuk mundet automatikisht të sjellin impaktin real që do të ishte materializuar; në një numër sa më të madh shërbimesh nga tregu i telekomunikacionit, shtrirje sa më e plotë gjeografike e të gjithë shërbimeve duke përfshirë edhe internetin, një cilësi sa më e mirë dhe padyshim edhe çmime në rënie për përdoruesit.

OBJEKTIVAT, PËRPARËSITË

Do të duhet të mbajmë parasysh sektorët prioritarë, bazuar në impaktin që kanë për daljen nga situata të rënda aktuale si energjia, furnizimin me ujë i popullatës, infrastruktura, por edhe sektorë që përcaktojnë cilësinë e rritjes ekonomike në këndvështrim aftagjatë që janë arsimi dhe shëndetësia.

Në debatet akademike që bëhen sot ndoshta janë të konturuara elementët thelbësorë të cilat mund ta lehtësojnë dhe nxisin ristrukturimin e *sektorit publik* duke patur produkte përfundimtar dhe të matshme. Cilësia në rritje e çdo produkti dhe shërbimi, rritje të mundësive përzgjedhëse, kosto në rënie për buxhetin familjar. *Reformim i sektorit publik* mund të përfshij 4 momente:

- a. më shumë mundësi për zgjedhje për të gjithë;
- b. nxitje *konkurencë* midis mundësive të ofruara;
- c. *derregullim* që nxit konkurrencën;
- d. *autoritet rregullator dhe mbikqyrës* që minimizon deformimet e tregut.

Diagnostifikimi më i detajuar i realitetit ekonomik shqiptar dhe i sfidave shërben për të nxitur më mirë ristrukturimin e tij, identifikohen disa sëmundje të rënda dhe të zgjatura.

Problemet e pronësisë, shkalla e lartë e informalitetit, performanca e ulët e autoriteteve rregullatore, hapat e ngadalta dhe jo efektive të mirëqeverisjes, forcimi i shtetit ligjor dhe lufta kundër korrupsionit do të kushtëzojnë suksesin e reformave dhe ristrukturimeve edhe të sektorit publik.

Reformat e sektorit publik do të jenë komplekse, do të jenë të integruara, do të mbajnë gjithnjë e më shumë parasysh realitetin konkret të Shqipërisë. Janë rritur debatet sidomos në qarqet universitare për riskun e mospërfitimit të reformave standarde dhe aq më tepër të modeleve thjesht të kopjuara apo të importuara.

TAKSA E SHESHTË DHE SJELLJA EKONOMIKE

DR. SELAMI XHEPA¹

ABSTRAKT. *Sektori fiskal në Shqipëri ka pësuar ndryshime thelbësore ndër vite madje me një frekuencë aq të lartë ndryshimi sa që ka krijuar përshtypjen e një paqëndrueshmërie të lartë dhe paparashikueshmërie të tij, megjithëse duhet theksuar se trendi ka qenë përgjithësisht në drejtim të thjeshtimit dhe lehtësimit të barrës fiskale. Por, ndryshimi më i thellë në sistemin fiskal është padiskutim reforma e kryer gjatë këtij viti me prezantimin e taksës së sheshtë, ashtu si dhe modernizimi i shërbimit tatimor ndaj tatimpaguesve me përdorimin gjerësisht të teknologjisë – kryesisht internetit – në kryerjen e shërbimeve ndaj tatimpaguesve.*

Të drejtat e pronësisë janë një incentivë e fuqishme për të nxitur një sipërmarrje produktive, por jo më pak të rëndësishme janë dhe minimizimi i *disincentivave* që dekurajojnë një aktivitet të tillë. Një disincentivë e dukshme ndaj aktivitetit sipërmarrës, madje ndaj çdo lloji aktiviteti, është taksimi.

Nuk ka dyshim se askush nuk ka dëshirë të paguajë taksa, ndoshta më pak se të gjithë janë biznesmenët që kanë prirje t'i atribuojnë vetes të gjithë suksesin dhe bëjnë çdo përpjekje të bindin qeveritë se ata janë mjaftueshëmrisht kontribues në ekonomi nëpërmjet punësimit dhe taksave që paguajnë për fuqinë punëtore. Por, edhe sipërmarrësit, ashtu si gjithë pjesa tjetër e shoqërisë është një përdoruese, madje më intensive, e infrastrukturës publike, modernizimi i të cilës është një parakusht për të garantuar rritjen ekonomike, dhe financimi i së cilës realizohet pikërisht nga realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tatimet. Për rrjedhojë, një nivel optimal taksimi për çdo shoqëri – është apo jo inkurajues i sipërmarrjes – nuk mund të jetë zero në asnjë rast.

Në këtë logjikë, nëse objektivi themelor i një sistemi taksimi është promovimi i sipërmarrjes dhe i rritjes ekonomike, do të ishte e preferueshme që sistemi i taksimit të bazohej më shumë tek të ardhurat nga shitja dhe taksa e pasurisë, në raport me tatimin mbi të ardhurat që është dhe matësi më i drejtpërdrejtë i suksesit të sipërmarrjes. Një tjetër arsye për këtë zgjedhje është dhe se një sistem i tillë taksimi dekurajon konsumin dhe inkurajon kursimin dhe për rrjedhojë investimin, që nga ana e tyre janë faktorë kryesor të rritjes (megjithëse, sipas studimeve empirike, jo më të rëndësishëm se inovacioni).

Sektori fiskal në Shqipëri ka pësuar ndryshime thelbësore ndër vite madje me një frekuencë aq të lartë ndryshimi sa që ka krijuar përshtypjen e një paqëndrueshmërie të lartë dhe paparashikueshmërie të tij, megjithëse duhet theksuar se trendi ka qenë përgjithësisht në drejtim të thjeshtimit dhe lehtësimit të barrës fiskale. Por, ndryshimi më i thellë në sistemin fiskal është padiskutim reforma e kryer gjatë këtij viti me prezantimin e taksës së sheshtë, ashtu si dhe modernizimi i shërbimit tatimor ndaj tatimpaguesve me përdorimin gjerësisht të teknologjisë – kryesisht internetit – në kryerjen e shërbimeve ndaj tatimpaguesve.

Reforma fiskale e përvijuar në linjat e një takse të sheshtë, pritet të influencojë në mënyrë të ndjeshme ekonominë e vendit: të ofrojë më shume incentiva për punë, për aktivitetin sipërmarrës dhe formimin e kapitalit, duke rritur kështu në mënyrë të ndjeshme prodhimin kombëtar dhe standartin

¹Autori është Këshilltar për Ekonominë i Kryeministrit

e jetesës së shoqërisë. Në dallim nga reformat e deritanishme të privatizimit, derregullimit dhe liberalizimit, kjo nuk është një reformë që vjen si reagim ndaj sistemit të mëparshëm ekonomik të trashëguar, por si një përqafim dhe zbatim i teorive liberale e neoliberales, që as vetë në Perëndim nuk kishin arritur të viheshin në zbatim në një mënyrë kaq të përhapur.

Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet kësaj reforme mund të përmbliken në:

1. përmirësim i incentivave ekonomike dhe përshpejtimi i ritmeve të rritjes ekonomike,
2. thjeshtim i legjislacionit për taksat,
3. reduktim i kostove të përmbushjes së detyrimeve fiskale

Në këtë këndvështrim, e parë si një reformë që njëherazi përshpejton rritjen ekonomike dhe rrit eficiencën e zbatimit të legjislacionit, gjithkush do ta përshëndeste një iniciativë të tillë. Asnjë ekonomist apo politikan, nuk besoj se do të atakonte avantazhet e një sistemi të tillë taksimi në lidhje me kriteret e thjeshtësisë dhe eficiencës/kostot e zbatimit të legjislacionit fiskal.

Po çfarë duhet thënë rreth efekteve të tjera të kësaj politike? A është ajo në të vërtetë një largim prej taksimit të të pasurve? Kjo në fakt ka qenë dhe pika ku debatet kanë qenë më të shumta dhe e cilësuar nga shumë studiues dhe analist dhe si pika e dobët e kësaj reforme.

A ËSHTË E DREJTË/NDERSHME (FAIR) NJË POLITIKË E TILLË TAKSIMI?

Në fakt, pyetja mund të shtrohet së çfarë lloj takse është e drejtë? Termi i drejtësisë/ndershmërisë (*fairness*) në kuptimin historik, që mishërohet në kushtetutën e çdo vendi demokratik, i referohet barazisë së trajtimit të çdo qytetari në mënyrë të barabartë përpara ligjit. Çdo trajtim i diferencuar midis grupeve të ndryshme shoqërore, në fakt përbën një diskriminim. Në këtë kuptim, aplikimi i një norme më të lartë taksimi mbi një grup shoqëror, me nivel më të lartë të të ardhurave, mund të quhet plotësisht si i padrejtë (*unfair*) në kuptimin ligjor e kushtetues. Madje, ekonomistët dhe filozofët liberal e cilësojnë atë me të drejtë si një penalizim të suksesit, frenues të riskmarrjes dhe përfundimisht një ndëshkim mbi ekonominë. Në kuptimin e tij të drejtpërdrejtë, termi (*e drejtë*) më shumë i referohet barazisë përpara ligjit. Në kuptimin filozofik kjo është përkufizuar si *drejtësi horizontale*. Vetëm më vonë, përgjatë shekullit të njëzetë, u zhvillua një tjetër koncept, ai i *drejtësisë vertikale* ose *aftësisë për të paguar* (*ability to pay*). Mbulimi i nevojave për shpenzimet në rritje për shkak të luftimeve të fillim-shekullit, i detyroi qeveritë të aplikojnë norma shumë më të larta tatimesh për klasat më të pasura, përjestimisht me aftësinë e tyre më të madhe për të paguar. Por, a është i drejtë ky sistem taksimi?

Në një testim të opinionit publik amerikan (që ka një sistem taksimi progresiv), rezultonte se rreth 65% e të anketuarve e konsiderojnë këtë sistem si të padrejtë. Dhe kësaj pyetje i janë përgjigjur njëllë nga të gjitha shtresat shoqërore, përkatësitë politike, racore, gjinore, etj. Të drejtë e kanë cilësuar vetëm ata që janë mbi 65 vjeç (ose që nuk paguajnë taksat).

Nga ana tjetër, një ndër parimet themelore të taksimit është ai i proporcionalitetit, që do të thotë se çdo individ ose subjekt duhet të kontribuojë në të ardhurat publike proporcionalisht me të ardhurat që fiton. Në këtë kuptim, taksa e sheshtë respekton parimet themelore të taksimit. Në praktikën e zbatuar dhe në realitetin tonë rezulton pra që, i padrejtë është sistemi aktual i taksimit, që duke predikuar një sistem progresiv dhe nivel më të lartë tatimi mbi biznesin dhe klasat e pasura, në fakt maskon mosveprimin e vet, duke favorizuar një nivel gjithnjë e më të lartë evazioni dhe shmangie nga detyrimi i pagimit të taksave. Një sistem që pretendon të jetë progresiv dhe që në

fakt vepron për më pak se 0.1 përqind të fuqisë punëtore aktive të vendit, është sa jorealit po aq dhe i padrejtë

TATIMI I SHESHTË DHE STIMULIMI I RITJES EKONOMIKE

Një ndër argumentet themelore të prezantimit të një norme të ulët dhe njënivelor tatimi, është thjeshtësia e aplikimit dhe krijimi i incentivave për rritjen ekonomike, duke zgjeruar më tej bazën e tatimit dhe duke krijuar një ambient të një konkurrence të ndershme në treg.

Ekonomistët që besojnë se sëmundjet aktuale të ekonomisë shqiptare janë të tipit të anës së ofertës (*supply side*), natyrshëm do të përkrahnin dhe idenë se ulja e taksës dhe kalimi në një taksë të sheshtë të një niveli të ulët do të ishte dhe një prej kurave të rekomanduara.

Konsensusi i të gjithë studiuesve është se fuqia punëtore do t'i përgjigjet kësaj politike duke shtuar përpjekjet e punës, duke nxitur më shumë sipërmarrjen private dhe për rrjedhojë do të rrisë dhe zgjerojë më tej këtë input kritik për ekonominë. Veçanërisht sistemi do të jetë nxitës për atë pjesë të popullsisë që qëndron në kufijtë e nivelit marxhinal të tatimit, që për të ruajtur nivelin e të ardhurave, do të nxiten të punojnë më shumë dhe për rrjedhojë të prodhojnë më shumë prodhime e shërbime.

Së dyti, megjithëse të ardhurat buxhetore nga tatimi mbi biznesin (tatimi mbi fitimin) janë modeste, normat e tatim fitimit janë të larta, parë në këndvështrimin e kësaj konkurrence rajonale që po zhvillohet aktualisht. Po kështu, sistemi aktual krijon tatim të dyfishtë mbi biznesmenët, të ardhurat e të cilëve taten edhe në tatimin nga fitimi (20%), nga tatimi mbi të ardhurat personale (kryesisht në kufirin më të lartë, 20%) edhe si dividendë të shpërndarë për aksionerët (10%). Për rrjedhojë, sistemi i taksimit dekurajon sipërmarrjen dhe përpjekjet për më shumë aktivitet ekonomik të individëve.

Në këtë këndvështrim, thjeshtimi dhe ulja e barrës së taksimit do të shërbente për të nxitur rritjen ekonomike. Studiues të ndryshëm (shih për shembull, Auserbach and Kotlikof, 2000) llogarisin se nëse ekonomia amerikane do të prezantonte një taksë të sheshtë prej 19%, do të stimulohej një rritje e ekonomisë me 2-4% për një periudhë shtatë vjeçare. Megjithatë, ky simulim i përket rastit të ekonomise amerikane dhe që nuk mund të hipotezojmë të njëjtin intensitet të veprimit të kësaj reforme edhe në rastin e ekonomisë sonë. Besoj se, për shkak të nëninvestimit të ekonomisë dhe nivelit të ulët të formimit të kapitalit, stimujt do të ishin shumë më të fuqishëm e për rrjedhojë edhe impakti i kësaj reforme do të ishte shumë më i ndjeshëm.

MODERNIZIMI I SISTEMIT TË ADMINISTRIMIT TË POLITIKAVE FISKALE

Në analizë të fundit, barra fiskale nuk përcaktohet thjesht dhe vetëm nga norma statutore e një takse, por nga shuma totale e asaj që një qytetar apo një biznesmen paguan realisht, përfshi penalitetet, abuzimet e administratës që merret me vjeljen e taksave, koha që ne harxhojmë për plotësimin e detyrimeve fiskale, etj. Në këtë kuptim, menaxhimi i politikës fiskale është një dimension kritik i vetë thelbit të politikës. Një keqmenaxhim i politikës madje mund të zhbëjë tërësisht efektet e një ulje të normës staturore të taksës. Është për këtë arsye që modernizimi i administrimit fiskal është një çështje parësore në programin tërësor të modernizimit të qeverisjes.

Fatkeqësisht, rastet janë të shumta të abuzimeve nga punonjësit tatimor në raport me biznesin, në shumë drejtime, që nga rimbursimi i TVSH, nxjerrja e detyrimit tatimor, arbitrariteti në sjelljen

ndaj biznesit vazhdon të jetë rregull dhe jo përjashtim. Progresi i reformave në këtë segment të administratës vazhdon të mbetet marxhinal, gjë që dëmton ndjeshëm klimën e biznesit në vend dhe zhbën efektet e pritshme pozitive të reformës fiskale që ka prezantuar qeveria.

Një rreze drite po duket në fund të tunelit: një projekt modernizimi i shërbimit tatimor që ka qenë në zbatim prej një viti, këtë muaj filloi me sukses zbatimin e vet në praktikë. Ky është projekti *e-filing* dhe *e-payment* i taksave. Tashmë tërheqja e formularëve, plotësimi, depozitimi dhe deri tek vetë pagimi i detyrimit tatimor është i disponueshëm *on-line*, fillimisht për biznesin e madh dhe, gradualisht me zgjerimin e infrastrukturës bazë, do të jetë i hapur për të gjithë sektorin privat. Ky është padiskutim progresi më i rëndësishëm në fushën e administrimit fiskal dhe që besojmë se do të pasohet nga hapa të tjerë të përfshirjes së shërbimeve të tjera ndaj tatimpaguesve në mënyrë elektronike.

Ndërfutja e teknologjisë në komunikimin midis administratës dhe biznesit ose qytetarit, besoj se është dhe reforma më e mirë modernizuese e qeverisjes dhe një instrument efektiv në luftën ndaj praktikave korruptive të administratës.

Në konkludim, megjithë progresin ndër vite të reformave lehtësuese fiskale, vetëm politikat fiskale nuk janë shëruesit e vuajtjeve të ekonomisë, nuk janë kura çudibërëse që do të sjellë më pas mrekullinë ekonomike. Ekonomia, ashtu si dhe e gjithë shoqëria shqiptare ka nevojë për qetësi, stabilitet politik, ndërhyrje minimaliste shtetërore në vendimmarrjen e sektorit privat dhe të qytetarit.

SEKTORIT PUBLIK – QEVERISJA DHE PERFORMANCA

PROF. ASOC. DR. ADRIAN CIVICI

Pse po vuajmë kaq shumë për të patur shërbime publike cilësore? Uji, energjia, transporti, shërbimi shëndetësor, pastërtia e qyteteve, telefonja e shtrenjtë, etj., çfarë të bëjmë për të qenë të kënaqur nga shërbimet e tyre? T'i modernizojmë e menaxhojmë më mirë?, t'i privatizojmë tërësisht... apo pjesërisht?, të pranojmë çmime më të larta në emër të cilësisë së tyre, të kënaqemi me ndryshimet e drejtuesve të tyre, apo t'i kërkojmë qeverisë të shtojë buxhetin dhe investimet për to? Pikëpyetjet janë të shumta ndërsa përgjigjet duhet të konvergojnë në zgjidhje efektive, në politika specifike që garantojnë sukses.

Cilësia dhe gjerësia e spektrit të shërbimeve të sektorit publik nuk është vetëm shqetësim i përfituesve të tyre, por ajo ka qenë dhe mbetet vazhdimisht në qendër të preokupimeve të punës dhe objektivave të të gjithë qeverive e administratave shtetërore. Në këtë proces lidhen e ndërthuren në mënyrë organike disa nga funksionet bazë të vetë qeverisë dhe shtetit, këtu “*përplasen*” doktrinat dhe shkollat ekonomike “*liberale, neo-liberale, intervencioniste, etatiste, etj.*”, këtu krijohen *marrëdhëniet politiko-elektorale me “popullin”*, këtu merr jetë një pjesë e rëndësishme e politikave fiskale e buxhetore, etj.

Për të gjitha këto arsye, *mirë-administrimi* dhe modernizimi i *sektorit publik* ka përbërë dhe vazhdon të bëjë vazhdimisht një nga temat më të diskutuara e analizuara dhe një nga objektivat më të përhershëm të çdo qeverie e administrate shtetërore. Pyetje e pikëpyetje të tilla si: si duhet të jetë një shërbim i këtij tipi, shtetëror, dmth publik apo privat?, cilat janë shërbimet që ai duhet të përfshijë?, cilat janë indikatorët që masin realisht performancën e tij?, sa përqind e buxhetit duhet të përdoret për këtë qëllim?, eksperiencia e cilit shtet apo grupime shtetesh është më e mira?, etj., vazhdojnë të “*mundojnë*” e të jenë në fokus të çdo qeverie apo publiku.

Pa dyshim, që edhe Shqipëria, me situatën aktuale tejte problematike në të cilën ndodhet sektori i saj publik, duhet të bëjë një skaner total të gjithë mënyrës së funksionimit, përbërjes dhe mbi të gjitha filozofisë së ndërtimit, financimit dhe administrimit të këtij sektori problematik. Dilemat dhe pikë-pyetjet janë të shumta. Intervali i zgjidhjeve të debatuar e propozuar fillon nga ruajtja e natyrës dhe thelbit shtetëror duke kërkuar vetëm modernizim të administrimit të tyre për tu mbyllur me propozimet që “në emër të efektivitetit dhe cilësisë së shërbimeve” ato të privatizohen 100% dhe shteti të tërhiqet plotësisht nga ky funksion. Në ndihmë të këtij debati dhe zgjedhjeve më të mira, mund të na shërbejnë dhe eksperiencat, politikat, sukseset por dhe dështimet e shumë vendeve të zhvilluara të cilat kanë ndërmarrë e vazhdojnë të ndërmarrin reforma të shumta në këtë drejtim. Le të fokusohemi tek eksperiencia e sintetizuar e OECD-së, që përfaqëson grupin e 32 vendeve më të zhvilluara të botës.

PSE DUHET REFORMUAR SEKTORI PUBLIK?

Gjatë 20 viteve të fundit, qeveritë e këtyre vendeve e kanë modifikuar në mënyrë të konsiderueshme mënyrën e administrimit të sektorit të tyre publik duke *privatizuar* pjesën dërrmuese të shërbimeve si p.sh. telekomunikacionin, energjinë elektrike, ujin, etj., kanë zvogëluar ndjeshëm *procedurat burokratike* të funksionimit të sektorit, i kanë bërë administratat dhe mënyrat e funksionimit të sektorit publik më transparente dhe krejtësisht të hapura për qytetarët.

Strukturimi kryesor i tyre është orientuar nga kufizimet dhe mundësitë buxhetore të çdo qeverie, por presioni më i madh për ndryshimin e tyre ka ardhur nga tre faktorë të tjerë: *zhvillimet sociale, rezultatet ekonomike dhe përhapja masive e teknologjive të reja*. Për pasojë, qeveritë kanë

qenë të detyruara të jenë më transparente, më tepër të orientuara ndaj kërkesave të shoqërisë se sa ndaj kufizimeve të tyre buxhetore, të pranojnë reduktimin e influencës dhe rolit të shtetit në këto shërbime, por nga ana tjetër, të kërkojnë shtimin dhe kompletimin e rolit të administratës publike me funksione të reja.

CILAT JANË SFIDAT KRYESORE NË KËTË FILLIM SHEKULLI TË XXI-TË?

Në mënyrë të përmbledhur sfida kryesore në këtë fillim shekulli qëndron tek « *gjetja e mënyrave dhe mjeteve për rritjen e efikasitetit të sektorit publik duke marrë seriozisht në konsideratë dhe qenë të kufizuar nga politikat shtrënguese buxhetore* ». Në këtë kuadër, përballë çdo qeverie e administrate shtetërore qëndrojnë disa pyetje të natyrës strategjike së zgjedhjes së politikave ekonomike e fiskale të tipit: (a) shteti duhet të rrisë prezencën e tij në ekonomi që të sigurojë më shumë të ardhura për të mbështetur sektorin e shërbimeve publike?; (b) duhet të rrisë akoma më tej tatimet dhe taksat për të mbushur buxhetin?; (c) duhet të shkurtoje disa lloje të tjera shërbimesh për të mbështetur sektorin publik?; (d) duhet të privatizojë masivisht për të alokuar kapitalet private drejt këtyre shërbimeve?; (e) duhet të përmirësojë administrimin e sektorëve problematikë duke aplikuar metodat e sektorit privat në to ?, etj.

Vende të ndryshme i kanë dhënë përgjigje me nuanca specifike zgjedhjes dhe politikave të tyre në favor të njërit apo tjetrit variant, por ta shikojmë në tërësinë e tij, kjo problematike ka evoluar sipas një trajektoreje pak a shumë të përbashkët për shumicën e vendeve të OCDE-së. Periudha e mbas Luftës së Dytë Botërore e deri në fillim të viteve 80-të të shek. XX-të u karakterizua nga një *prezencë totale e Shtetit*, i cili garantonte dhe ofronte në një pozicion pothuajse monopol pjesën dërrmuese të shërbimeve (ujë, elektricitet, arsim, shëndetësi, transport, telekomunikim, etj.). Megjithatë, mbas viteve 80-të, publiku u bë shumë më i ndjeshëm ndaj shërbimeve që i ofroheshin dhe mundësive të zgjedhjes, ndërkohë që fatura financiare dhe buxhetore e qeverive filloi të rritej shumë dhe të bëhej problematike dhe e papërbalueshme. Shumë qeveri në pamundësi për të financuar këtë *ekspansion të shërbimeve* vendosën: ose (a) të reduktojnë dimensionet e sektorit të tyre publik, ose (b) të ndryshojnë strukturën e tij, por gjithmonë duke privilegjuar privatizimin e tij.

Por, “*surpriza*” me e madhe si në fushën e teorisë ekonomike dhe filozofisë së zhvillimit ashtu dhe realitetit të përditshëm ishte fakti se “*gjatë 20 viteve të fundit prezenca e shtetit në këtë sektor jo vetëm që nuk është zvogëluar, por përkundrazi është zmadhuar në të gjitha vendet e OECD-së*”. Ajo që ka ndryshuar është *roli i tij*, mënyrat e ndërhyrjes dhe doza e këtyre ndërhyrjeve. P.sh., shumë vende kanë privatizuar monopolet shtetërore në fushën e energjisë, ujit, telekomunikimit, arsimit, shëndetësisë, transportit, etj., por nga ana tjetër shteti ka krijuar funksione të tjera të domosdoshme: rregullimin e tregut, eliminimin e monopoleve të sektorit privat, garantimin e konkurrencës dhe transparencës, unifikimin e standardeve bazë në shërbime, etj. Krahës evidencimit “*surprizë*” si një zhvillim i ri, kjo konsiderohet dhe si një eksperience e mirë për tu studiuar dhe marrë në konsideratë për të gjitha vendet që janë në proces reformash modernizimi të sektorit të tyre publik.

“LEKSIONET” KRYESORE TË REFORMAVE NË VENDET E OCDE-SË.

Në vijim të analizave për rezultatet e një periudhe 20 vjeçare reformash në fushën e modernizimit të shërbimeve publike, ekspertët e OCDE-së i kanë sintetizuar ato në disa konkluzione e rekomandime të cilat, pa dyshim që janë të vlefshme për çdo vend që ndodhet në fazën e kryerjes së reformave apo ka si objektiv realizimin e shpejtë të tyre. Ja disa prej tyre:

a. rezultatet e *reformave* shpesh ishin larg pritshmërisë dhe objektivave fillestare ç’ka dëshmon si për një planifikim të gabuar të tyre ashtu dhe për mosnjohje të realitetit nga strukturat

përgjegjëse.

b. Reformat nuk ishin të adaptuara me strukturën institucionale, mentalitetin publik dhe kontekstin e përgjithshëm të vendit duke u konceptuar në mjaft raste si “*reforma standarde*” apo thjesht duke kopjuar eksperiencën e të tjerëve pa e analizuar me kujdes atë në se përputhej apo jo me realitetet konkrete të çdo vendi e shoqërie.

c. Ritmi i reformave të sektorit publik nuk përputhej në kohë dhe hapësirë me reformat e tjera të modernizimit të funksionimit të shtetit.

d. Në mjaft raste reformat mbështeteshin në logjikën e « *qeverimit* » dhe jo në atë të « *qeverisjes* », pra i nënshtroheshin vetëm kompetencave dhe instrumenteve qeveritare pa e zgjeruar spektrin e tyre tek grupet e interesit, pushteti lokal dhe decentralizimi, shoqëria civile, biznesi, bota akademike, OJQ-të, etj.

e. Vlerësimi i efekteve të reformave apo planifikimi i tyre bëhej mbi një bazë treguesish dhe indikatorësh të mangët apo të pjesshëm të cilët në më të shumtën e rasteve ishin “*indikatorë opinionesh*” të tipit “*më mirë, më shumë, më shpejt, më cilësisht, më gjerësisht, etj*”, por nuk ishin të matshëm konkretisht me numra apo përqindje në mënyrë që të krijonin mundësi për vlerësime thelbësore.

f. Reformat nuk mund të jenë statike në kuptimin që “*bëj reformën, prit rezultatet pastaj vepro për ndryshime të tjera*”. Përkundrazi, reformat duhet të jenë dinamike në funksion të evolucionit të realitetit dhe ndryshimi i tyre duhet të jetë i vazhdueshëm.

g. Domosdoshmëria e futjes së *mekanizmave të tregut* në pjesën dërrmuese të shërbimeve të sektorit publik dhe kryesisht tek mënyra e shpërblimit dhe motivimit, rekrutimit të personelit, sanksionet dhe kontrollet, konsolidimi i institucionit të karrierës në ndërmarrjet e këtij sektori, depolitizimi dhe eliminimi i nepotizmit, dominimi i sistemit të meritave, transparencë e gjerë publike, eliminimi i burokracive të panevojshme apo formale, etj..

h. Politikat e kombinimit dhe “*krijimit të konkurrencës në treg ndërmjet sektorit privat dhe atij publik për të njëjtin shërbim*”, përgjithësisht nuk kanë dhënë rezultate pozitive. Për arsye të shumë faktorëve historike, gjeografike, politike, sociale dhe specifike, përjashtim bëjnë vetëm vendet skandinave (Danimarka, Suedia, Finlanda dhe Norvegjia) që sektorin publik e kanë po aq performant sa sektori privat. Eksperienca e tyre konsiderohet shumë specifike nga pjesa tjetër e vendeve të zhvilluara dhe nuk gjykohet se ajo është e mundur të aplikohet me sukses në çdo vend tjetër.

j. Reformat rrënjësore strukturore nuk mund të realizohen pa bashkëpunimin dhe konsensusin e nevojshëm politik e social dhe një vizion afat-gjatë e të qëndrueshëm.

k. Reformat në sektorin publik nuk duhen ngatërruar dhe barazuar me reformat në shërbimet publike, duke servirur shembullin e vendeve anglo-saksone si eksperiencën më të mirë në këtë aspekt.

Të gjitha këto eksperiencia, konkluzione e rekomandime do të ishin një sfond shumë i mirë reflektimi dhe eksperiencë për ekspertët dhe institucionet tona në gjithë procesin e debateve dhe zgjidhjeve në funksion të përmirësimit të performancës dhe modernizimit të sektorit dhe shërbimeve publike në Shqipëri.

POTENCIALI I ARSIMIT PRIVAT DHE INTERESAT INDIVIDUALË E PUBLIKË

DR. ERMAL HASIMJA¹

Ekzistojnë mendime të ndryshme shpjeguese rreth qëndrimit të opinionit publik apo edhe shtetit ndaj çështjes së zhvillimit të *arsimit të lartë privat*. Në fakt, vetë ekzistenca e debatit në ditët e sotme, të paktën në bisedat joformale në të cilat jam pjesëmarrës shpesh, vërteton se kemi tejkaluar etapën e korrupsionit. Në një *raport korrupsioni* mes shtetit dhe arsimit privat (p.sh. në marrjen e licensave) nuk mund të shquash qëndrime politike, strategjike, apo ideologjike. Fatmirësisht sot nuk na duhet të merremi me këtë problem.

Debatet rreth qëndrimit të shtetit nënkuptojnë dy teza të kundërta: e para, se *shteti* e shikon me *dyshim* dhe ndoshta me armiqësi arsimin privat, dhe e dyta, se shteti po e *mbështet* ose të paktën po e toleron *arsimin privat*. Unë do të preferoja të mos i shikoja këto si dy teza të kundërta, por si dy elementë kundërthënës të të njëjtit qëndrim. Shkurt: nga njëra anë, shteti shpall dhe ekzekuton relativisht mirë një politikë hapjeje ndaj arsimit privat, ndërkohë që paradoksisht zbulon edhe elementë të një *skepticizmi* të thellë ndaj tij dhe *njëanshmërie* të plotë ndaj universitetit publik. Një ilustrim i përsosur është rasti i trajtimit diferencial me bursa shtetërore i studentëve shqiptarë: prej tyre përfitojnë vetëm studentët e universitetit publik. E keqja më e madhe është se për shumicën e njerëzve kjo praktikë është aq normale, sa nuk bie ne sy fare.

Mund të shkoja edhe më thellë në analizën e qëndrimit të shtetit ndaj arsimit privat duke thënë se ai pasqyron një qëndrim të përgjithshëm skeptik ndaj sektorit privat, ose ndoshta përsëri, një qëndrim të dyfishtë e kundërthënës, tolerim/përkrahje dhe dyshim/kufizim. *Mentaliteti anti-kapitalist* në Shqipëri nuk është një dukuri e re. Le të kujtojmë, sa për ilustrim, se si në fillim të viteve '90, personazhi i biznesmenit ishte viktima e përhershme e estradës sonë. Kjo merr kuptim të veçantë nëse i besojmë parimeve të psikanalizës dhe pranojmë ta shikojmë humorin si katarsis të komplekseve tona të rrënjosura thellë.

Megjithatë qëndrimi i shtetit ndaj privatit që merret me arsim, ose ndaj arsimit si biznes, lidhet edhe me një konceptim më të hershëm se dhe vetë komplekset komuniste të të gjithë neve. *Shkolla publike*, masive, e hapur dhe madje e detyrueshme për të gjithë, është prodhim i procesit që lindi komb-shtetet dhe funksioni i saj themelor ishte pikërisht "*prodhimi*" i *qytetarit*. Jo i çfarëdo qytetari, por i një entiteti, fati dhe identiteti i të cilit lidhet pashmangshëm me fatin dhe identitetin kolektiv. Një fabrikë e tillë mund të funksionojë vetëm sipas një logjike unike dhe monopolizuese të së vërtetës, ose siç do të thoshte Lyotard-i, në kuadrin e një metanarrative publike.

Dëshira për të riparuar "padrejtësitë" e historisë së shkruar dhe për të ripërkufizuar vlerat e meritat historike është një dëshmi rudimentare e një qëndrimi të tillë. Një shkollë e këtij soji, nuk synon të prodhojë individë profesionistë, por një bashkësi identitare të qëndrueshme dhe të kontrollueshme nga vetë shteti. Ka vetëm dy momente që zbusin apo eliminonë këtë qëndrim: forca e korrupsionit dhe zbrapsja e shtetit brenda kufinjve administrativë minimalë.

Megjithatë, qëndrimi skeptik ndaj arsimit të lartë privat në Shqipëri është më tepër sesa një pasqyrim i qëndrimit skeptik ndaj sektorit privat në përgjithësi. Biznesmeni që shet televizorë apo makina është ndryshe nga biznesmeni që shet dije. I pari tolerohet më lehtë nga *etatizmi* sepse merret me vetveten. Ndërsa i dyti, *shitësi i dijes*, është shumë më i rrezikshëm, sidomos për arsyen sepse zhvlerëson monopolin e shtetit mbi fabrikën e prodhimit të qytetarit. Një universitet privat nuk synon të prodhojë qytetarë të një bashkësie identitare, por *individë profesionistë* që dijen do ta përdorin për qëllimet e tyre.

¹Pedagog i Univeristetit të Europian Tiranës

Një shembull hipotetik: një universitet privat nuk është i detyruar të verë në vend “falsifikimet” e historisë. Ai mund të mos pranojë se jemi populli më i vjetër në Europë (apo në planet), mund të ketë interpretime alternative të viteve të tranzicionit, mund të inkurajojë studentët-individë të vazhdojnë studimet në fusha të paplanifikuara nga gjenialiteti i strategjive prodhuese të ndonjë ministri: shkurt, mund të mos realizojë funksionin për të cilin u krijuar shkolla publike shqiptare 120 vjet më parë.

Është pikërisht kjo që përbën njëkohësisht, qoftë burimin e frikës e skepticizmit qoftë përkundrazi, vlerën themelore të arsimit të lartë privat. Kjo nuk do të thotë se universitetet private nuk i shërbejnë vendit, apo janë kundër interesave të tij. Përkundrazi, siç do të përpiqem të tregoj më poshtë, *universitetet private* i shërbejnë vendit shumë më tepër sesa universiteti i atrofizuar publik. Mirëpo universitetet private e bëjnë këtë ndryshe: jo përmes qytetarit, por përmes individit.

Kjo tablo shërben për të kuptuar më mirë perceptimin e një pjese të mirë të opinionit publik dhe të vetë shtetit për arsimin e lartë privat. Një perceptim stereotipik relativisht negativ. Një sqarim këtu: kur flas për shtetin, e kam fjalën për çdo sektor që paguhet me paratë e taksapaguesve, përfshirë edhe autoritetet e universitetit publik. Ashtu si kur flas për opinionin publik, përfshij edhe shoqërinë civile si dhe partitë politike që nuk janë në pushtet.

Në këtë pikë mund të përmbledhim arsyet e *skepticizmit* ndaj arsimit privat:

- refuzimi i idesë së *liberalizimit* të sistemeve të prodhimit dhe përcjelljes së dijes;
- *aversioni etatist* ndaj lidhjes së arsimit me tregun;
- aversioni i përgjithshëm ndaj *tregut* në përgjithësi;
- pasojat e *fetishizimit komunist* të dijes si prodhim i një të vërtete origjinale universale;
- logjika *egalitariste* dhe *kolektiviste* e një pjese të opinionit publik;
- paranoja ndaj krijimit të dallimeve në mundësitë e shkollimit mes shtresave të ndryshme;
- reagimi i kompleksuar i një pjese të kufizuar (por me ndikim) i kuadrove të sektorit publik të cilët sektori privat i ka neglizhuar për shkak të mediokritetit.

Nuk do të dëshiroja të shpjegoja përse arsimi privat paraqet potencial më të madh zhvillimi sesa arsimi publik, por do të merrem më tepër me atë që universitetet private mund të bëjnë më mirë se *universitetet publike* për interesat e publikut, apo thënë nga një pikëpamje më radikale, për interesat e konsumatorit.

Së pari, arsimi privat realizon *lirinë e zgjedhjes* sepse tejkalon ngurtësinë dhe arbitraritetin përzgjedhës të sektorit publik, duke i dhënë mundësinë gjithsecilit të studiojë në degën që i pëlqen. Fatkeqësisht, universiteti publik nuk e ofron sot këtë mundësi. Megjithatë kjo nuk është as problem dhe as faji i tij. Është thjesht një e dhënë e tregut. Duhet të jetë e qartë se nuk e shoh sektorin privat dhe publik si armiq të përbetuar, por si konkurrues të njeri-tjetrit.

Së dyti, arsimi privat realizon *barazinë më të lartë* të mundshme të zgjedhjes duke i dhënë mundësinë secilit të investojë aq sa dëshiron në shkollimin e tij. Universiteti publik, deri më sot, trajton njësoj një student ngelës që nuk dëshiron të investojë as kohë dhe as para në shkollimin e tij, me një student që dëshiron të investojë supozojmë 10.000 euro për të ndërtuar bazën e një karriere profesionale.

Arsimi privat fut fuqishëm *konkurrencën* si faktor zhvillues. Deri para disa vitesh konkurrenca në arsim nuk ekzistonte. Nuk është rastësi që përmirësimi relativ i kushteve të punës së stafit pedagogjik në universitetet publike është përqendruar në vitet e fundit, kur institucionet private janë shndërruar në pole të fuqishme tërheqës ndaj pedagogëve të aftë.

Arsimi privat paralizon dhe dekonstrukton *monopolin shtetëror* mbi prodhimin dhe përcjelljen e dijes. Në të njëjtën vijë logjike ai zhbën natyrshëm metanarrativat politike, shoqërore apo historike që tredhin mendimin kritik intelektual. Për shembull, për nga vetë natyra e tij e pavarur dhe policentrike do të refuzonte kërkesat tjetërsuese që mund t'i bëhen historisë (si shkencë) për të

përcaktuar merita, vlera apo mëkate, njësoj si të ishte një nëndegë e etikës kombëtare. *Demitizimi i realitetit dhe liberalizimi i ligjërimit* do të jenë një nga efektet madhorë të konkurrencës së nxitur nga sektori privat.

Jo rastësisht, në listën e prioriteteve të kontrollit të regjimeve autoritare apo totalitare në çastin e instalimit të tyre, arsimi vjen menjëherë pas mediave dhe i paraprin gjithmonë kontrollit të sipërmarrjeve private të natyrës së pastër ekonomike. Madje në raste si ai i ndonjë regjimi fashist, junte ushtarake apo monarkie teokratike, kontrolli shtetëror mund të tolerojë edhe tregun privat, por kurrë lirinë e arsimit privat.

Arsimi privat, ndonëse në një përmasë më të kufizuar, kontribon në shfuqizimin e *prirjeve etatiste*. Qoftë edhe përmes shembullit të funksionimit jashtëzakonisht pozitiv të disa universiteteve private, ai dëshmon se shteti nuk mund të jetë menaxhuesi më i mirë në të gjitha fushat dhe se arsimi privat mund të demokratizojë dhe zhvillojë një sektor më mirë sesa ai.

Duke konstatuar problemet e universiteteve publike është e qartë se flukset e ardhshme të *pedagogëve* të tyre do të vijnë kryesisht nga brezat e studentëve të shkolluar nga universitetet private. Zhvillimi i arsimit privat plotëson nevojat e atyre segmenteve të tregut të punës që sot mbeten në pritje. Për shembull, universiteti në të cilin angazhohem përgatit aktualisht specialistë të *marrëdhënieve publike* dhe *komunikimit* apo marrëdhënieve ndërkombëtare, degë këto që nuk ofrohen në universitetet publike.

SHENDETESIA - RRUGA E GJATE DREJT SE MIRE

PROF. ASOC. DR. EDUART HASHORVA¹

ABSTRAKT. *Një sistem shëndetësor i mirë do të ishte ai sistem që do të ishte i aftë të ofronte shërbimin shëndetësor bazë, lehtësisht të arritshëm e cilësisht të pranueshëm për popullatën, dhe me eficiencë të lartë. Duke analizuar ecurinë e sistemit shëndetësor në vend, kjo ese nxjerr në pah problematikën dhe mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të tij.*

CILI DO TË ISHTE NJË SISTEM SHËNDETËSOR I MIRË?

Tri janë treguesit kryesorë që vlerësojnë një sistem shëndetësor; aksesit, cilësia dhe eficientia e tij që me fjalë më të thjeshta do të thotë sa i arritshëm është ky shërbim për popullatën (mbulimi gjeografik i territorit me institucione e personel shëndetësor por edhe pengesat subjektive si pagesat, korrupsioni etj.), sa e kënaqur është popullata për shërbimin që merr (niveli profesional i mjekëve dhe personelit tjetër shëndetësor, aparaturat e pajisjet bashkëkohore, etj.) dhe sa shëndet “prodhoet” me sasinë e burimeve financiare që janë në dispozicion (mirëmenaxhimi i burimeve financiare nga profesionistët e menaxhimit shëndetësor). Pra, një sistem shëndetësor i mirë do të ishte ai sistem që do të ishte i aftë të ofronte shërbimin shëndetësor bazë, lehtësisht të arritshëm e cilësisht të pranueshëm për popullatën, dhe me eficiencë të lartë.

Parë në këndvështrimin e mësipërm, sistemi ynë shëndetësor sot është larg të qenit i mirë; ai vuan nga probleme të shumta të cilat janë “majisur” shumë e kërkojnë zgjidhje të shpejta e rezultative. Sa për ilustrim mjafton të përmendim faktin që një qytetar shqiptar kontakton me mjekun mesatarisht 1.6 herë në vit kur mesatarja e kontaktit të një qytetari të Bashkimit Europian me mjekun është 6.9 herë në vit.

PO CILËT JANË DISA NGA PROBLEMET MË TË MPREHTA E OPSIONET PËR ZGJIDHJEN E TYRE?

Financimi i pamjaftueshëm dhe menaxhimi jo eficient i burimeve financiare. Një nga “sëmundjet” kronike të sistemit tonë shëndetësor është financimi i pamjaftueshëm. Pavarësisht etiketimit të shëndetësisë si sektor prioritar, financimi publik i shëndetësisë në këto 17 vite tranzicion nuk e ka kaluar nivelin e 3 përqindëshit të PBB. Ky nënfinancim ka sjellë edhe pasojat e njohura në nivelin e zhvillimit të këtij sektori. Megjithatë duhen dalluar dy probleme: Së pari, realisht, nëse një sistem shëndetësor financohet në këtë nivel (pra me më pak se 3 përqind të PBB) nuk mund të mbijetojë, por duhet të kolabohet. Praktikisht sistemi ynë edhe pse me shumë probleme serioze, (fatmirësisht), ende funksionon. Kjo shpjegohet me faktin që burimet të tjera financiare si pagesat e drejtpërdrejta të popullatës për shërbime shëndetësore private dhe ato nën – dorë që janë në nivele të larta, e kontribuojnë që PBB – ja e përdorur për sistemin e shëndetësisë, sipas një studimi të Bankës Botërore, të shkojë deri në rreth 5 përqind.

Problemi i dytë ka të bëjë me eficientinë e përdorimit të burimeve financiare në sistemin tonë shëndetësor. Alokimi i fondeve realizohet mbi baza historike, mbështetur kryesisht në shpenzimet

¹Ish zv. Ministër i Shëndetësisë

dhe kapacitetet e institucioneve shëndetësore dhe jo mbi nevojat dhe përparësitë reale të popullsisë, sidomos të atyre me të varfra dhe më të privuara nga shërbimet. Ende mungon një mekanizëm i përcaktuar dhe standard për alokimin e buxhetit të shëndetësisë për institucionet shëndetësore. Në këtë drejtim po hasen vështirësi për arsye të kapaciteteve të pamjaftueshme teknike dhe pengesave strukturore, që e mbajnë të ndarë funksionin e planifikimit të shërbimeve nga funksioni i planifikimit të buxhetit.

Vendi ynë ka përcaktuar skemën kombëtare të sigurimit si financuesen e shërbimeve shëndetësore të të gjitha llojeve e bindur nga përparësitë që ka kjo e fundit. Për këtë, me asistencën e institucioneve të huaja, në vitin 1995 u krijua Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) si një institucion relativisht i pavarur me tri qëllime kryesore: Përmirësim të financimit duke nxitur popullatën të siguronte shëndetin e saj, përmirësim të sasisë dhe cilësisë së shërbimit shëndetësor me anë të nxitjes së mjekeve dhe personelit tjetër mjekësor me shpërblime më të mira dhe pavarësi nga politika. Mirëpo, për arsye kryesisht subjektive të politikave pa vizion e keqadministrimit, kjo skemë është ndeshur me një sërë vështirësish dhe problemesh, të cilat kanë ndikuar në procesin e shtrirjes dhe funksionimit të saj, duke kompromentuar rëndë të tria qëllimet për të cilat e krijua. Kështu, kontributet nga të vetëpunësuarit dhe sektori privat janë grumbulluar në një masë të vogël dhe të pamjaftueshme, si pasojë e mungesës së informacionit dhe të ndërgjegjësimit të këtyre kategorive të popullsisë për përfitimet që vijnë nga sigurimet shëndetësore. Metodot e aplikuara për nxitjen e një sasive e cilësie më të mirë të shërbimit nga mjekët e personeli tjetër shëndetësor kanë qenë të pasuksesshme ndërsa politika ka ndërhyrë vrazhdë në funksionimi e këtij institucioni nëpërmjet emërimit të drejtuesve partiakë e joprofesioniste.

Financimi i shëndetësisë sonë karakterizohet nga pamjaftueshmëria e fondeve publike për të mbuluar në mënyrë të kënaqshme shërbimet shëndetësore. Nga ana tjetër, pacientët shqiptarë paguajnë shuma të mëdha (disa dhjetëra milionë euro në vit) në klinikat private jashtë vendit, veçanërisht për sigurimin e shërbimeve të specializuara diagnostiko - kurative, sidomos të atyre që kërkojnë teknologji të avancuara. Të dhënat jo të plota flasin për disa dhjetëra milionë euro të shpenzuara në vit nga pacientët shqiptarë në spitalet e Turqisë, Greqisë, Maqedonisë, Italisë etj. Gjithashtu, pacientet paguajnë në mënyrë informale për një pjesë të shërbimeve që u ofrohen në spitalet dhe klinikat publike. Natyrisht, të gjitha këto shuma shkojnë në xhepat e mjekëve dhe të personelit tjetër shëndetësor, ndërkohë që pagesat e ligjshme janë pothuajse simbolike. Nëqoftëse këto pagesa do të vilesnin nga shërbimet shëndetësore publike dhe do të përdreshin me efektivitet, pa dyshim që do të ndikonin shumë në përmirësimin e cilësisë së këtyre shërbimeve.

OPSIONE PËR ZGJIDHJE.

Shtim të financimit publik të shëndetësisë e kombinuar me përmirësimin e mekanizmave të decentralizimit (autonomisë së shërbimeve mjekësore) dhe me financimin e shërbimeve nga skema e sigurimeve shëndetësore.

Zgjerim i skemës së sigurimeve shëndetësore drejt shërbimit spitalor dhe shërbimit më të mirë shëndetësor privat.

Përpunim i mekanizmave që nxisin përmirësimin sasior dhe cilësor të shërbimit shëndetësor duke aplikuar mbulimin e paketave të shërbimit.

Aplikim të bashkepagesave dhe pagesave të drejtpërdrejta legale e transparente për shërbime shëndetësore jo esenciale.

Numri i kufizuar dhe politikat e gabuara në menaxhimin e burimeve njerëzore.

Sistemi ynë shëndetësor zotëron sot një numër të kufizuar burimesh njerëzore; statistikat për 1000 banorë janë: 1.3 mjekë, 3.7 infermiere e personel të mesëm mjekësor, 0.5 mjekë familje, etj. etj. të cilat janë 2 deri në 3 herë më të vogla se ato të vendeve të BE – se, ku synojmë të integrohemi. Nga na tjetër, ky numër i kufizuar burimesh njerëzore, si rezultat i politikave klienteliste e të papërgjegjshme, është shpërndarë në mënyre të pabarabartë duke lënë një pjesë të madhe të territorit, sidomos zonat veriore e verilindore të pa mbuluara ose të mbuluara keq me shërbim shëndetësor. Kjo pasi ende mungojnë planet kombëtare të plota të burimeve njerëzore në sektorin e shëndetësisë të cilat të bëjnë parashikime afatmesme e afatgjata mbi lëvizjet e largimet e mjekëve të përgjithshëm apo specialistet e kategorive të ndryshme, daljet në pension etj. që janë të domosdoshme me qëllim që të ruhet ekuilibri midis “prodhimit” të burimeve të reja njerëzore me këto lëvizje.

Tradicionalisht, sistemi ynë shëndetësor ka trashëguar mangësi specialistesh në fusha të caktuara si shëndeti publik, menaxhimi shëndetësor, ekonomia shëndetësore, promocioni shëndetësor, politikat dhe planifikimi i shëndetësisë etj. Kjo ka sjellë pengesa serioze veçanërisht në menaxhimin e institucioneve shëndetësore sipas koncepteve bashkëkohore. Për më keq, po të vështroni me kujdes strukturën e specializimeve pasuniversitare të këtyre viteve të fundit, do të shikoni se specialistet e sipërpërmendur, zënë një pjesë fare të vogël të tyre, ndërsa specialistet “me bereqet” si kirurgjia, obstetrike – gjinekologjia, kardiologjia, etj. zënë numrin më të madh, por që realisht nevojat tona për to janë fare të vogla. Për çfarë politike mund të flitet në këto raste, veçse abuzive e të papërgjegjshme ?

Sistemi ynë shëndetësor sot po përballët edhe me një problem tjetër të madh, me humbjen e elitës së tij profesionale. Kjo hemorragji e vazhdueshme po ndodh për disa arsye si; largimit të specialistëve jashtë vendit, daljes graduale në pension të specialistëve më në zë të shërbimeve të specializuara universitare, politikave frenuese që pengojnë tërheqjen e klinikistëve të rinj të shkolluar në përëndim, mungesës së specializimeve universitare afat-gjata në vende me sistem mjekësor të zhvilluar, etj. Pa dyshim që kjo politikë dritëshkurtër do të sjellë pasoja afatgjata lidhur me ofrimin e shërbimeve të specializuara në nivelin dytësor dhe tretësor, duke pasur veçanërisht impakt në nivelin e mësimdhënies dhe të formimit të mjekëve të rinj nga Fakulteti i Mjekësisë.

Një nga handikap – et më të mëdha e me pasoja të rënda në cilësinë e shërbimit shëndetësor që ofrohet nga sistemi ynë shëndetësor është mungesa e institucionalizimit të një sistemi të edukimit në vazhdimësi. Praktikisht, ky proces është domosdoshmëri për freskimin dhe përditësimin e njohuri profesionale dhe është i lidhur ngushtë me kreditimin e licencimin e detyrueshëm profesional duke ndikuar fuqishëm në përmirësimin e cilësisë së shërbimit. Le të jemi më të qartë; si rezultat i mungesës së një sistemi të edukimit të vazhdueshëm, një mjek që diplomohet sot është i detyruar që gjatë gjithë jetës së tij profesionale të diagnostikojë e mjekojë pacientet e tij, në rastin më të mirë, me metodat e deri vitit 2007, duke neglizhuar kështu zhvillimet e fuqishme e përparimet e shkencës mjekësore ndër vitet që do vijnë. Kjo është arsyeja që një pjesë e mjekëve përdorin ende metodat e 15 apo 20 viteve më parë për të mjekuar pacientet e tyre, disa prej të cilave koha i ka lënë pas. Kjo situatë mund të duhet të ndryshojë sa më parë.

E fundit, por më e rëndësishmja; zëvendësimet e here pas hershme, pa kritere shkencore të personelit drejtues e teknik të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institucioneve të tjera shëndetësore publike në qendër e në rrethe, nisur këto nga interesa të ngushtë partiake apo abuzive, janë një dëm shumë i madh që fatkeqësisht po i bëhet në mënyrë periodike shëndetësisë sonë. Këto “revolucione

proletare” që ndodhin sa herë që ndërrohen drejtuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, shembulli më tipik është ky i fundit, dëmtojnë rëndë profesionalizmin, memorien institucionale dhe dekurajojnë karrierën profesionale e meritokracinë në administrimin e sistemit shëndetësor, e si të tilla duhet të marrin fund.

OPSIONE PËR ZGJIDHJE.

Hartimi i një politike kombëtare të burimeve njerëzore në shëndetësi e cila të përcaktojë qartë nevojat, strategjitë e mekanizmat për plotësimin e tyre.

Krijimi i tregut kombëtar të punës në shëndetësi duke aplikuar me transparencë të plotë shpërblim të diferencuar në vartësi të kërkesë – ofertës për të plotësuar vendet vakante kudo që ndodhen.

Krijimi i një qendre kombëtare të edukimit të vazhdueshëm të mjekëve dhe personelit tjetër shëndetësor në vend, si një kombinim i kontributeve të Ministrisë së Shëndetësisë në rolin e financuesit, të Fakultetit të Mjekësisë në rolin e trajnuesit dhe Urdhrit të Mjekëve në rolin e koordinuesit të procesit.

Krijimi i Shkollës së Shëndetit Publik si pjesë organike e Fakultetit të Mjekësisë për përgatitjen e specialisteve të shëndetit publik, pra edhe të menaxherëve të shëndetësisë.

Menaxhimi jo eficient (amator) i sistemit shëndetësor.

Fatkeqësisht, sistemi ynë shëndetësor zotëron sot kapacitete të pakta në fushën e menaxhimit shëndetësor. Si pasojë e politikave të munguara dhe/ose të dështuara, edhe ai numër tepër i kufizuar specialistësh të formuar (jashtë vendit) për menaxhimin e shërbimeve shëndetësore punojnë jashtë sektorit publik, kryesisht në organizmat e huaja, biznese private ose organizatat jo fitimprurëse.

Tradicionalisht, në rolin e menaxherëve të institucioneve tona shëndetësore janë angazhuar klinikistë të shquar (kirurgë, kardiologë etj.) të cilëve, shpesh, u kanë munguar edhe konceptet bazë të menaxhimit. Parimisht kjo zgjidhje përmban konflikt interesi pasi një klinikist është i interesuar më shumë për ecurinë e të sëmurit e më pak për menaxhimin e rreptë. Nga ana tjetër, angazhimi i klinikistit në drejtimin e menaxhimit të institucionit ka qenë gjithmonë i mangët (part-time) pasi puna në klinikë i merrte kohë të konsiderueshme. Mirëpo, e ashtuquajtura reformë që po bën lidhshipi aktual i Ministrisë së Shëndetësisë në këtë drejtim duke zëvendësuar të gjithë drejtuesit e institucioneve shëndetësore me pseudomenaxherë, që në rastin më të mirë janë ekonomistë agrarë të patrajnuar e që se njohim fare shëndetësinë e problematikën e saj, është dëmi me i madh që ju shkaktua sistemit tonë shëndetësor që me krijimin e tij, pasojat e të cilit do të rëndojnë gjatë.

Spektori i shëndetësisë ende nuk ka përpunuar modele bashkëkohore të drejtimit dhe menaxhimit të spitaleve, poliklinikave si edhe të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Nuk ekzistojnë standarde të menaxhimit modern mbi të cilat të mbështetet praktika e menaxhimit të shërbimeve shëndetësore, veçanërisht shërbimeve spitalore, të cilat janë komplekse dhe të kushtueshme. Sistemet e informacionit klinik e financiar janë pak të zhvilluara dhe kjo vështirëson futjen e praktikave të përparuara të menaxhimit modern. Edhe ai informacion që mblidhet nuk shfrytëzohet sa e si duhet për mirëmenaxhimin e institucioneve. Janë të pakët specialistët e fushës së menaxhimit të informacionit shëndetësor.

Mungesa e menaxherëve të shëndetësisë përkeqësohet nga fakti i mungesës së një “fabrike” të prodhimit të këtyre menaxhereve në vend. Ende dhe sot në vendin tonë mungon një shkollë e

Shëndetit Publik e cila do të përgatiste krahas specialisteve të tjerë edhe menaxherët e shëndetësisë. Edhe ndonjë iniciative gjysmake e gjysmë ilegale që është shfaqur, është karakterizuar nga papërgjegjshmëria dhe mungesa të theksuar në seriozitetin dhe cilësinë e përgatitjes së “master – ve” të shëndetit publik, dhe vetëm sa e ka rënduar gjendjen.

OPSIONE PËR ZGJIDHJE.

- Përmirësimi i aftësive menaxhuese të drejtuese aktualë të shëndetësisë nëpërmjet trajnimeve afatshkurtër e afatmesëm;
- Fuqizimi i kapaciteteve menaxhuese nëpërmjet politikave të reja të punësimit të të trajnuarve jashtë shtetit;
- Aplikimi i modeleve bashkëkohorë moderne të menaxhimit institucional, sidomos spitalor, të decentralizuara e autonom, me sisteme të avancuara përpunimi të informacionit e vendimbështetjes, etj.
- “Prodhimin” në vend të menaxherëve të shëndetësisë nga Shkolla e Shëndetit Publik që duhet të ngrihet si më sipër.

ZHVILLIM I VRULLSHËM POR KONFUZ E PASTANDARDIZUAR I SHËNDETËSISË PRIVATE

Ne sistemet ekonomiko-shoqërore që bazohen në ekonominë e tregut, ekzistenca e tregut shëndetësor privat krahas atij shtetëror është domosdoshmëri për vlerat e mëdha komplementare e konkurruese që ai krijon. Nisur edhe nga mungesa e traditës, gjatë këtyre viteve të tranzicionit, është nxitur, inkurajuar dhe mbështetur krijimi i tregut shëndetësor privat në shëndetin parësor e në atë spitalor. Për te ilustruar këtë rritje të vrullshme, mjafton të përmendim faktin që vetëm në periudhën 1997 – 2005, numri i kabineteve, klinikave, laboratorëve, farmacive, apo klinikave dentare është rritur nga 6 deri në 10 herë krahasuar me vitin 1997. Por fatkeqësisht vihet re se në praktikë, shtrirja dhe zhvillimi i aktivitetit të sektorit privat ka ecur me hapa më të shpejta se ndërtimi i kuadrit rregullator, duke sjellë për pasojë një numër problemesh që lidhen kryesisht me cilësinë e sigurinë e shërbimeve të ofruara. Pra duhet theksuar se privatizimi në shëndetësi është një mekanizëm me vlera të padiskutueshme plotësuese, konkurruese, e shërben si model efieciënce për sektorin shëndetësor publik. Por, privatizimi është një mekanizëm me vlere vetëm atëherë kur bazohet në politika e strategji të hartuara me kujdes, mbështetet në akte rregullatorë e programe që garantojnë cilësinë e sigurinë e nevojshme për popullatën që shërbehet prej tij. Në të kundërtën, pra kur këto mungojnë, siç është rasti ynë ku sektori privat nuk raporton volumin e punës, as rezultatet, as akreditohehet e monitorohet me rreptësi teknike, privatizimi kthehet në një mekanizëm të rrezikshëm do të thotë që në rastin më të mire ti lesh të sëmuret në mëshirë të fatit e në rastin më të keq në dorë të spekulantëve.

OPSIONE PËR ZGJIDHJE.

Përmirësimi rrënjësor i legjislacionit duke filluar me hartimin e një ligji bazë mbi aktivitetin privat në shëndetësi duke u mbështetur në modelet e BE.

Hartimi dhe përmirësimi i standardeve të detyruara për licencim për shërbimin mjekësor në të gjitha aktivitetet private si klinika, laboratorë, klinika stomatologjike, spitale, etj.

Ngritja e struktura të posaçme në formë inspektorati me aftësinë, profesionalizmin, autoritetin e kompetencat e duhura, për monitorimin dhe kontrollin periodik të aktivitetit privat në shëndetësi.

Shëndetësia dhe politika

Zhvillimi apo dështimi i sistemit shëndetësor, më shumë se cilido sektor tjetër i jetës së një vendi, është rrjedhojë e politikës. Kjo për faktin e thjeshtë se shëndeti i njeriut është i lidhur ngushtësisht me arsimimin e tij, me kushtet e strehimit, të ushqimit, të higjienës, të veshjes, të mjedisit që e rrethon, të ujit të pijshëm e cilësisë së ajrit, të rrugëve (aksidentet), të stresit nga jeta e vështirë, etj. Pra në këtë kontekst, shëndeti i qytetarit është rezultante e zhvillimit ekonomiko – shoqëror të një vendi. Është iluzive dhe e pamundur që të realizosh një shëndet të mirë për popullatën e një vendi të varfër e me shume halle. E natyrisht që për të gjitha këto, politika ka rolin e përgjegjësine e saj të madhe.

Por duhet theksuar se megjithëse problemet e shtjelluara në këtë shkrim janë tërësisht teknike, ato shkaktohen por edhe mund të zgjidhen vetëm nga politika. Një politikë që për kaq vite me radhë, financon me pikatore shëndetin e qytetarëve të saj, që në mënyrë të përsëritur, vë në drejtim të një fushe kaq specifike e delikate siç është shëndetësia, njerëz anonime, me përvojë minimale ose krejtësisht jashtë sistemit, që përdor postet drejtuese të sistemit shëndetësor si qerasje për militantët partiake pa u merakosur fare për zhvillimin e këtij sistemi, pra për ruajtjen dhe forcimin e shëndetit të qytetarëve të saj, është veçse e papërgjegjshme dhe aventuriere.

Shëndeti është një e drejtë universale e çdo qytetari e si i tillë, politika është e detyruar ta realizojë atë.

SEKTORI BANKAR SI MODEL SUKSESI I MANAXHIMIT PRIVAT

ARTAN SANTO¹

ABSTRAKT. *Megjithë që ekonomia përgjatë këtyre viteve ka pësuar luhatjet e ndjeshme të saj, sektori bankar ka njohur rritje të vazhdueshme, falë konceptit tërësisht novator dhe nuhatës që të jep qënësia e plotë private.*

Pas 17 vjetësh rresht, ne ende tentojmë të kërkojmë dhe të gjejmë se çfarë është më e mirë për Shqipërinë, duke mbajtur si përparësi, dëshirën e shtetit për të shkuar drejt një *“përkujdesje tërësore ndaj pronës”*, apo duke konsideruar edhe logjikën që *“pronësia e gjerë private”* do të mund të ndihmojë shtetin ende të brishtë. Mirëpo po të kërkojmë përse-të e asaj se çfarë ka ndodhur gjatë këtij harku kohor do të biem në gabimet e derisotme të politikës, e cila merret fuqishëm me të djeshmen, ndërkohë që të gjithë ne kemi nevojë të mendojmë e të veprojmë se ç’duhet të bëjmë nesër.

Shqipëria sot është një vend me rreth 2.9 milione rezidente, nga të cilët grupmosha 25-65 vjeç mund të jetë e aftë të veprojë energjikisht në *drejtimin e vendit*. Jane pra, 2 milione rezidente ata që presupozohet se drejtojnë dhe drejtohen nga rregullat që ekzistojnë apo që duhet të vendosen ne nje vend si yni. Me një fjalë, me këtë popullësi që përkon me numrin e nxenesve ne nje shkollë te mesme në Shanghai apo me një lagje të Milano-s, ne nuk arrijmë dot të mirëkuptohemi, të drejtojmë dhe të mirëmbajmë veten tonë. E gjitha kjo sepse *sektori publik* është deri më sot ende *“terminologji”*, pasi është *shteti ai që drejton fort, por jo se është i forte*. Për më tepër sepse *sektori privat ndihet jo i lirë* për të vepruar, ndonëse tepër kërkues në nismat e tij, por që liria e veprimt dhe e nismave te tij, mbytet nga individët shtetarë, a individe *“pranë shtetit”* që luajnë në emër të ligjit të pashkruar dhe diktatit në emër të shtetit te dobet por te forte ne kesi rastesh. Kështu që shteti, mbetet një fikSION ne mendjen e qytetarit që nuk ka drita dhe ujë, të biznesmenit që me mundim zhdoganon mallin, por që pak para tij dikush tjetër e kalon traun e doganes pa kurrfarë kontrolli, apo të njëmijë paradokseve njerëzore që si për çudi i gjejmë në çdo skuttë Shqiperisë sonë të dashur.

Në një vend si i yni ku rregulli i shkruar, ligji i dekretuar, vendimi i firmosur a nje urdher i leshuar, ka vlere vetem per me te dobtin, ndersa per pjesen tjeter eshte eshte opsional, duhet te na bej te ndjehemi sa te rrezikuar nga pafuqishmeria e shtetit, po aq edhe te kanosur nga individi i veshur me fuqi te pa merituar. Është mëse e nevojshme që të hiqet dorë sa më parë nga përkatësitë e mëdha që shteti ka në ekonominë e vendit. Prova e frikës ndaj privatit mendoj se është e tejkaluar, tanimë kërkohet të mospengohet ai, përkundrazi të *nxitet në veprimatrinë e tij private*, në mënyrë që shumatorja e tyre të krijojë shtetin e fortë. Nuk mund të ketë shtet të fortë me individë të dobët, në të kundërt do të kishim shtet diktatorial postkomunist.

Më kot ne rekemi të krijojmë nisma. Aksioma japoneze *“kopjo dhe perfeksiono”* është më e thjeshtë. Ne lindëm të fundit në këtë treg të lirë, çfarëdo që kërkojmë të bëjmë, të tjerët e kanë testuar prej dekadash. Kërkohet moral profesional dhe qytetar e më pas politik që për fare pak kohë të realizojmë çdo gjë.

¹Artan Santo është Menaxher i Përgjithshëm i Bankës “Credins”

Në këndvështrimin profesional, në aspektin e rritjes së vlerave dhe të masës së fitimit, pak rëndësi ka *ngjyrimi politik*, pasi të majtët kanë pasur flamurin rozë e të kuq, por kanë shkruar me stilolaps blu. Ndërkohë të *djathtët janë tepër socialë*, duke harruar se shteti social ndërtohet mbi një masë të madhe të pasurish që paguajnë varfërinë e tjetrit, por që deri me sot janë ende të skajshëm në vëmendjen e shtetit. Nga logjikat e rralla, ne mos e vetmja, te vendimarrjeve shumengjyreshe politike, ka qene privatizimi masiv i sektorit bankar shqiptar. U fillua në vitin 1994-1995 me krijimin e të pares banke mikse shqiptaro-italiane, e me pas me privatizimin e BKT, nga turqit e deri në kalimin e Bankes së Kursimeve përpara tre vitesh në perkatesi të RZB-se austriake.

Sot, krejt ndryshe nga dje, sistemi bankar është sistemi më avanguard në ekonominë shqiptare, ku gjallon më shumë konkurrencë, më tepër kërkesa për produkte e shërbime të. Ky sistem jo vetëm krijon mundësi të gjera për plotësimin e nevojave, por rrit dukshëm edhe masën e fitimit. Një spirale që rrit drejtpërsëdrejti të *ardhurat e shtetit, nga pjesa e fitimit që i kalon atij* duke mbajtur peshë në sigurimin e të ardhura për vetë buxhetin e shtetit. Megjithë që ekonomia përgjatë këtyre viteve ka pësuar luhatjet e ndjeshme të saj, *sektori bankar ka njohur rritje të vazhdueshme*, falë konceptit tërësisht novator dhe nuhatës që të jep qënësia e plotë private.

Për vitin 2006, rezultati neto i sistemit bankar shqiptar ishte rreth 7.45 miliardë lekë, ose me një rritje ndaj një viti më parë prej 12.9 përqind. Ndërsa në gusht të vitit në vazhdim, aktivet si sistem bankar arritën në nivelin e 693,26 miliardë lekë, ose me një rritje prej rreth 11 përqind krahasuar me dhjetorin e vitit 2006. Natyrshëm që janë tregues impresionues, dhe mbi të gjitha që menaxhimi, administrimi dhe vetë menyra se si është konceptuar ky sistem, përfaqëson për Shqipërinë arritjen më të madhe duke përmbushur kushtet optimale të një marrëdhënieje tepër korrekte dhe profesionale Privat-Shtet. Madje sot është shteti që për interesa të mëdha publike u drejtohet bankave për realizimin e projekteve ambicioze veçanërisht në infrastrukturë.

Mirepo kjo filozofi drejtimi ndryshe, në kushte dhe në një mjedis normal kërkohej të transferohej jo vetëm si dije dhe jo vetëm të qëndrojë në një sektor, por duhej përhapur si një mundësi tepër komforte për privatizimet e mëdha dhe për mënyrën e krijimit të marrëdhënieve gjithashtu të mëdha e me tepër interes midis sektorit publik dhe atij privat. Ndoshta për interesa me shumë emërtime, u dashka të vonohet privatizmi i shpërndarjes në sektorin energjitik a në atë hidrik, në krijimin e artificave bajate nga të gjitha palët në mosdhënien e lejeve për ndërtim, ku vet shteti humb shumë më tepër se privati që do të paguajë komisionet përkatëse legale për marrjet e lejeve etj etj..

Ndërkohe, shteti ende mban barra të jashtëzakonshme, pasojë e *mosprivatizimeve* të sektorëve të rëndësishëm të ekonomisë. Madje qeveritë përgjatë këtyre 17 viteve nuk po arrijnë as të formalizojnë “kontrata manaxhimi” reale dhe të qëndrueshme me *individë të suksesshëm*. Këta të fundit, nga një anë krijojnë vlera për atë periudhë të mbetur kohe ku pronësia është ende publike, deri në momentet sa të shkeputet dhe nga ana tjetër, krijojnë një kastë njerëzish, të cilët do të jenë drejtuesit e ardhshëm me një tjetër mentalitet të drejtimit të sektorit publik. Pak, madje shumë pak vlerësohet individit në Shqipëri tonë të dashur. A e keni vënë re? Të gjithë presidentët e vendit, kanë dekoruar çdo ambasador që ikën, çdo vizitor që ka një emër, por që edhe këta nuk janë shqiptarë dhe kursen çdo meritë për shumë të tjerë shtetas të vendit të vet që çdo vit i japin këtij vendi aq shumë. Në kujtohemi për bashkëpatriotët tanë vetëm kur ata nuk janë më mes nesh. Por kjo nuk ka më vlerë në vlerat që ne kërkojmë të ndërtojmë.

Kështu që formula e ndryshimeve të qenësishme bëhet më e thjeshtë nga sa mund të duket (në qoftëse duam, ose duan). *Shteti (administrata e tij) të qëndrojë në rolin e moderatorit, të një kujdestari që mban rregulla të njëjta loje për të gjithë*, pa zhgarravitur letra poshtë tavolinës për ata që nuk i do dhe të votojë vetëm për dashamirësit. Ndërsa detyrat e tjera janë pjesë e masës së njerëzve të zgjuar që vetëm ata e dinë se ku lëndon ekonomia dhe vetëm ata mund ta zgjidhin më shpejt se kushdo tjetër. Mirëpo ka individë që pavarësisht se mund ta mendojnë kështu krijojnë vështirësi që politika të tilla të mund të realizohen. Keto janë ata shtetaret e “veckel” të pa vlere, por të vlerësuar nga politikantët kalimtarë të qeverive të ndryshme, të cilët ndonëse me mosdashjen

tone kolektive, jane determinues ne “zhgarravitjet poshte tavolinave”. Natyrshëm që të tillë, do të kenë të gjithë sistemet, por jo kaq shumë që kemi parë përgjatë këtyre afër dy dekadave, dhe jo kaq shumë që lindin çdo ditë.

Vetëm kur prona të mos jetë më e “të gjithëve”, por me një emër atëherë edhe “ndërmjetësit” nuk do të arrijnë të lindin. Vetem individi me pronë e pasuri mundëson realisht zgjidhjen më të shpejtë, me më pak shpenzime dhe më të mundshme për t’u realizuar. *Qenesia private ofron zgjidhjen më të mire për konsumatorin*. Kështu psh. çdokush që vjen në bankën Credins merr zgjidhje të menjëhershme, ose së paku, merr një përgjigje të plotë e të saktë, duke pasur mundësinë që të vendosë menjëherë se si duhet të veprojë. Atëherë nga të gjithë kuptohet se *qënësia private është e interesuar në zgjidhje të shpejta*, duke eliminuar agoninë e pritjes, të humbjes së parave, të shpërfytyrimit nga mungesa e dritave a e ujit. Unë në pronën time, gjithkush tjetër në pronën e tij, është natyrshëm i interesuar të fitojë sa më shumë në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, brenda kornizimit ligjor që të jep mundësi të zhvillohesh, punosh e të fitosh.

Së fundmi, në këtë histori 17 vjeçare cdo ngjyre politike ka kërkuar që brenda mandatit të saj të realizojë “aq vepra në të mirë të publikut” sa që të ketë mundësi që të premtojë gjysmën e pa bërë për të siguruar një *mandat të dytë politik*. Duke harruar që veprat e mëdha në shërbim të njerëzimit nuk bëhen as me plane 5 vjeçarë sikurse bëheshin dikur dhe as brenda një harku kohor 4 vjeçar të mandatuar. Njerëzit e zgjuar këto i realizojnë duke ia *transmetuar brezave* nga dekada në dekadë, asnjëherë duke prishur, por *vetëm duke ndërtuar*. Edhe këtu ka një shembull nga eksperiencia e një prej vendeve më të zhvilluara evropiane. Në Republikën Federale Gjermane të asaj kohe, me shembjen e murit të Berlinit, pjesa lindore e qytetit, në një pjesë të ndërtesave kishte ndërtime me parafabrike, tamam në qendër të qytetit. Askush nuk mendoi t’i prishte ato. Ata vetëm riveshën fasadën, me logjikën e arkitekturës së pjesës tjetër.

SFIDAT DHE PROBLEMET E FORMIMIT TË MENAXHERËVE TË RINJ, TË AFTË PËR T'JU PËRGJIGJUR NEVOJAVE TË SEKTORIT PUBLIK

PROF. DR. FATMIR MEMAJ¹

“Eshtë gjithnjë koha e duhur për të bërë diçka të drejtë”

- Martin Luther King -

NË VEND TË HYRJES

Në se do t'i hedhim një vështrim të vëmendshëm, arsimit të lartë në vendin tonë, në këtë periudhë tanzicioni, duhet të theksojmë se shpesh problemet madhore të tij janë politizuar dhe nuk janë trajtuar me kujdesin e duhur profesional. Probleme të tilla madhore si, hapja e universiteteve të reja publike dhe private, hapja e degëve të reja në këto universitete, kapacitet e tyre, kurrikulat dhe mjaft probleme të tjera, shpesh janë bërë pa u studiuar gjatë, me pak nxitim dhe të nisur nga dëshira e mirë e përmirësimit të numrit të studentëve për 1000 banorë ose të nisur nga politizimi i problemit si nga forcat në pushtet por, edhe nga opozita.

Në këto kushte, kemi kohë që përpara sistemit të arsimit të lartë në Shqipëri kemi patur probleme të pazgjidhura por, dhe shpesh i kemi shtuar me ose pa dëshirë problemet dhe sfidat që duhen përballuar. I vendosur në këtë situatë, problemet që ka arsimit të lartë shqiptar shfaqen ku me intensitet më të lartë dhe ku me intensitet më të ulët edhe në pjesët përbërëse të tij.

Për një trajtim më të drejtë të problemit të arsimit të lartë shqiptar, mendoj se së pari, duhet ta analizojmë atë në disa këndvështrime dhe duke mbajtur parasysh nga një këndvështrim historik mënyrën se si janë krijuar, se si janë acaruar dhe se si janë intensifikuar problemet e shfaqura. Këndvështrimi i parë, është ai i trajtimit të problemeve të mjedisit të përgjithshëm, në të cilin zhvillohet sistemi i arsimit të lartë dhe sidomos ai i problemeve dhe i sfidave që po përballon sot sistemi arsimor *parauniversitar* në vendin tonë. Ndërsa një këndvështrimi i dytë, është ai i trajtimit të problemeve me të cilat po përballon vet *arsimi i lartë* dhe në këtë kuadër ai i arsimit ekonomik në veçanti.

DISA PROBLEME TË MJEDISIT KU ZHVILLOHET ARSIMI I LARTË DHE NDIKIMI I TYRE NË KËTË MJEDIS

Duke u përpjekur të kryejë një analizë të mjedisit të përgjithshëm në vendin tonë, mendoj se ky *“mjedis tranzicioni”* është një mjedis që lë pak vend për të sjell shembuj pozitiv dhe nxitës për studentët që të studiojnë me ngarkesa të mëdha dhe të arrijnë një përgatitje cilësore. Këtu, e kam fjalën për faktin, se në realitetin shqiptar, gjen mjaft shembuj kur individë me arsimim të *cunguar* dhe me nivel të lartë të ardhurash të llojit jolegal, shfaqen përpara studentëve tanë duke u sorollatur rrugëve të qyteteve tona kryesore, me makina të shtrenjta, lluksoze dhe me veshje të kushtueshme. Për fatin tonë të keq, askujt “nuk i bëjnë përshtypje” dhe askush nuk kërkon të dijë mënyrën se si i kanë “bërë paratë”, këta individë, për një jetë kaq të kushtueshme. Ndërkohë, ka mjaft raste kur intelektualë, të niveleve të ndryshme arsimore, në disa raste edhe njerëz mjaft të talentuar dhe

¹Autori është zv.Dekan i Fakultetit të Ekonomisë

me emër në profesionin e tyre, janë fare të papunë ose kanë një punë “sa për të thënë” dhe me të ardhura mjaft modeste.

Pra, ne sot gjendemi në një pozitë mjaftë të dyzuar, ku të përpiqesh të moralizosh dhe të edukosh të rinjtë me ndjenjën e punës dhe atë të studiuarit për rezultate cilësore, në kushtet kur të gjithë jetojmë në një mjedis të tillë “që zhvillohet në një nonsens”, është një detyrë paksa e vështirë, për të mos thënë e pamundur, për t’u realizuar.

Nga ana tjetër, shfaqet një problem më specifik por, po aq i vështirë. Po të sjellim në kujtesë një shprehje popullore, që thotë se “me miell të zi nuk bëhet bukë e bardhë”, duhet të theksojmë se sistemi i lartë arsimor në Shqipëri “po gatuan atë lëndë të parë” që i vjen nga *sistemi parauniversitar*. Është e kuptueshme se *masivizimi* i arsimit të lartë ka sjell si pasojë, që në këtë sistem arsimor, të hyjnë gati të gjithë ata nxënës që mbarojnë shkollën e mesme. Tashmë, kemi kohë që duhet t’i japim përgjigje pyetjes së shtruar para nesh: Me kete masimizim a po e shpime përpara apo po i krijojmë probleme arsimit të lartë? Me rritjen tepër të shpejtuar dhe të pastudjuar që po i bëjmë duke “rritur kapacitetet” e tij, do të arrijë vallë ky sistem arsimor të realizojë qëllimin e tij final, atë të përgatitjes së një brezi të ri e të aftë për të ecur përpara?

Natyrisht, që po krijohet përshtypja se kemi kaluar në “një fazë obeziteti” ku na duhen trajtime të kujdesëshme dhe profesionale për të mos kaluar në “sëmundje të tjera” edhe më të rënda. Pra, po jetojmë në një periudhë kur përveç nxënësve të mirë dhe atyre me nivel mesatar, *statusin e studentit* po e fitojnë shumë lehtësisht edhe gati të gjithë nxënësit me nivel të dobët. Në se duhet të përmendim këtu, edhe dobësitë që paraqesin një pjesë e shkollave të arsimit të mesëm (publike dhe private, sidomos ato nëpër zonat periferike), kjo gjë shpesh e bënë të dyshimtë edhe statusin e “nxënësve të mirë” dhe sidomos atë të “nxënësve mesatar”. Mendoj, se asnjë sistem universitar sado i mirë dhe i përparuar që të jetë, nuk mund të jetë në gjendje dhe as nuk mund t’i mbyll dot mangësitë që i vijnë nga një *edukim jociësor* në sistemin arsimor parauniversitar.

Vitet e fundit, po vihet re një prirje pozitive lidhur me *sistemin e arsimit të mesëm profesional*, duke i dhënë këtij më tepër hapësirë dhe frymëmarrje. E theksoj këtë fakt, sepse mungesa apo dobësitë e këtij lloj arsimimi i kanë detyruar shpesh prindërit dhe nxënësit që t’i drejtohen arsimit universitar megjithëse ata e dinë fare mirë se nuk janë të aftë për rezultate cilësore, por shpesh janë të paafte edhe për rezultate pozitive në arsimin e lartë. Si rezultat në krye të 8, 10 apo më shumë viteve ata marrin një diplomë dhe quhen specialist me arsim të lartë, por *niveli profesional* i tyre lë shumë për të dëshiruar. Pra, nga njera anë shteti shpenzon (më mirë të themi shpërdoron) mjete monetare dhe burime njerëzore për “të prodhuar” specialistë të tillë që nuk i duhen askujt dhe nga ana tjetër, ky grup studentësh rrit presionin negativ mbi stafet akademike, jo vetëm për të arritur rrezultate të pamërituara por, në disa raste edhe duke i lodhur pedagogët dhe duke bërë që ata të paraqesin përpara auditoreve me mjaft studentë jociësor, një nivel pune me mangësi.

Në këtë kuadër, duhet të shtojmë edhe faktin se, bazuar në preferenca politike, njohje personale dhe fafëfisnore, rryshfete dhe korrupsion, ka raste kur këta të ashtuquajtur specialistë, zënë bile poste të larta në administratën publike (më shpesh preferojnë tatimet dhe doganat). Ky fakt, e rëndon edhe më tepër motivimin e të rinjëve për të luftuar për një edukim cilësor dhe për arritje të rezultateve të larta.

Në këtë këndvështrim, dua të theksoj, se herë pas here, vihet re edhe një prirje tjetër negative, kur nivele të ndryshme të pushtetit qendror dhe atij vendor, u japin përparësi në punësim dhe stimuj të ndryshëm financiar, studentëve që kanë studiuar *jashtë vendit*. Është e natyrshme, dhe të gjithë e dimë se në vendet e zhvilluara ka mjaft universitete që kanë një nivel shumë më cilësor se universitetet tona. Megjithatë, nuk mund të lëmë këtu pa theksuar se edhe në këto vende ka mjaft institucione të arsimit të lartë, me një nivel më shumë më të ulët cilësor, se sa universitetet tona. Këtë, e mbështes edhe në eksperiencën e vizitave të shumta që kam bërë personalisht, në universitete të vendeve të ndryshme ne botë. Pra, kategoria e atyre studentëve që kanë studjuar jashtë vendit, është një kategori që merret e mirëqenë si cilësore, kur në realitet, në pjesën më të

madhe të rasteve, nuk është e tillë. Nga një vëshrim empirik edhe ata studentë që kanë mbaruar studimet jashtë vendit, janë me strukturë të njëjtë cilësore me studentët që kanë studjuar në universitetet tona.

Po të shtojmë këtu, faktin e preferencave edhe për studentët që kanë përfunduar studimet jashtë vendit, por me rezultate minimale, bile edhe me stërzgjatje të afateve të studimit, atëhere gjendja aktuale përkeqësohet dhe logjika e këtij diferencimi jo vetëm që nuk ka vend por, është edhe me një trajtim dashakeqë për arsimin e lartë shqiptar. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm, se këto politika jo vetëm nuk nxisin por, përkundrazi frenojnë zhvillimin e arsimit tonë si dhe fyejnë mjaft nga *studentët cilësor* të universiteteve shqiptare.

DISA NGA PROBLEMET E ARSIMIT TË LARTË

Tani, le të kalojmë në këndvështrimin e dytë, në vetë problemet e arsimit të lartë dhe në veçanti, ato të arsimit të lartë për përgatitjen e *menaxherëve*. Problemi i parë në këtë këndvështrim është fakti se, rritjes së madhe të numrit të studentëve nuk i jemi përgjigjur me rritjen e *stafit pedagogjik* si nga ana cilësore ashtu dhe nga ana sasiore. Dihet, që në vendet e zhvilluara ka raporte të caktuara të numrit të studentëve për një pedagog. Kur ky raport rritet së tepërmi dhe në mënyrë të pakuptimt, duke arritur deri edhe në 50:1 apo edhe 70:1, atëhere, kuptohet se kjo *mbingarkesë* bëhet e papërballueshme dhe cilësia e arsimit do të bjerë.

Kështu, në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës një staf prej 104 pedagogësh (së bashku me pedagogët e jashtëm) përballon ngarkesën e mbi 5.000 studentëve me kohë të plotë dhe rreth 1500 studentë me kohë të pjesëshme të nivelit të parë të studimeve. Po të shtojmë këtu, edhe ngarkesën që vjen nga studentët e nivelit “Master” dhe studentët e Doktoraturës atëhere është e kuptueshme se ngarkesa që përballohet është “jologjike”.

Kjo ngarkesë tejnormave, shpesh shoqërohet edhe me pengesa administrative dhe ligjore, për të paguar mbingarkesën që përballojnë stafet akademike në universitete. Pra, ne vetë kemi krijuar një situatë, kur nga njera anë kemi nevojë për shtimin sasior të stafeve (akademike dhe ndihmëse) të universiteteve dhe nga ana tjetër edhe në qoftë se do të supozojmë se ky shtim sasior i stafeve bëhet i mundur do të kalojmë në një problem tjetër edhe më të vështirë për tu përballuar, problemi edhe vështirësitë që duhet të përballohen për të gjetur *staf akademike cilësore*.

Këtu është vendi, për të theksuar edhe një vështirësi tjetër. Theksojmë se gjendja është rënduar edhe më tepër nga *largimi* i shumë prej profesorëve të konsoliduar në karrierën e tyre akademike, drejt politikës, administratës publike, bizneseve private, etj. dhe kjo sepse të ardhurat dhe stimuli i përftuar në këto pozicione janë më të mëdha se sa ato në *karrierën akademike*. Largimi i një pedagogu është një veprim që realizohet shumë shpejt, por përgatitja e tij është një proces i gjatë e shpesh jo i lehtë. Ky proces ka kushtuar vite dhe zëvendësimi i tij kërkon vite e munde të tjera. E gjitha kjo ka ndikuar dhe ndikon negativisht në cilësinë e edukimit universitar.

Një faktor që duhet analizuar, është edhe fakti që mjaft nga pedagogët kryejnë *punë të dyta* ose edhe më shumë. Kur këto punë, janë brenda profesionit tyre (punë studimore, konsulencë, etj) ky fakt ka anën e vet pozitive, sepse këta pedagogë janë shpesh profesionalisht më të përgatitur dhe janë në gjendje që në auditorë, përballë studentëve të tyre, të kombinojnë teorinë me praktikën, duke u paraqitur para studentëve në mënyrë cilësore. Pra kjo gjithë ndikon pozitivisht, duke bërë që pedagogu ta mbaj auditorin e vet “të gjallë” dhe të ndiqet me mjaft inters.

Megjithatë, ekziston edhe ana tjetër e medaljes. Dypunësimi ka edhe anën e vetë negative, sepse shpesh, këta pedagogë vijnë në auditore të lodhur, ose i spetojnë (në disa raste nuk i zhvillojnë) orët e mësimi, duke sjellë *çoroditje* tek studentët e tyre. Pra, edhe këtu duhet gjetur një balancë midis punës akademike në fakultet dhe punëve të tjera jashtë fakultetit, bile edhe duhet të ketë një deklaram dhe një data bazë të plotë të punëve të bëra me qëllim që kjo eksperiencë (në formë studimesh, konsulence, materiale konferencash etj., të jetë e mundëshme të studjohet dhe të përdoret edhe nga pedagogë të tjerë.

Probleme më specifike të edukimit të manaxherëve të rinj

Duke ndjekur logjikën tonë, ne jemi duke kaluar nga një sfond më i përgjithshëm në një sfond më specifik, pra nga problemet e shoqërisë, tek problemet e arsimit, tek problemet e arsimit të lartë dhe le të vazhdojmë të disa probleme më specifike në përgatitjen e ekonomistëve dhe manaxherëve (por jo vetëm të tyre). Këtu duhet të theksojmë se, përjashtuar rastet e veçanta, në sistemin tonë të edukimit, e sidomos në atë të edukimit universitar, ende nuk ka hyrë gjerësisht përvoja e *leksioneve të hapura*. E theksojmë këtë sepse, ka përpjekje të ndryshme por, gjithsesi ende këto përpjekje, mbeten të shkëputura, shpesh të paorganizuara dhe të rastit ose që zhvillohen në një hark kohor tepër të shkurtër. Pra, e kemi fjalën për rastet kur, me organizime të caktuara, individë të shquar, në karrierë dhe me reputacion, nga biznesi, nga bankat, nga administrata publike, nga institucionet ndërkombëtare, nga media, apo nga shoqëria civile etj., të vijnë nëpër universitete dhe të japin leksione për probleme të caktuara. Këto lloj leksionesh nuk janë të detyrueshme në planet mësimore, por mund të zhvillohen një herë ose dy herë në javë dhe në stendat e studentëve, mjaftë kohë përpara, oranzatorët e këtyre takimeve (pedagogë apo shoqata dhe grupime studentësh) të shpallat emri i lektorit dhe tema të cilën ai do të trajtojë.

Studentët do të mund të përzgjedhin pjesëmarrjen ose jo në leksionet e hapura, në varësi të interesave të tyre për përgatitjen e temave të kursit dhe të diplomave, dhe për më tepër, për arsye të fokusimit të tyre në drejtim të punësimit në të ardhmen. Kështu, ata do të shkojnë në këto leksione me kënaqësi dhe do të përfitojnë prej tyre më tepër sesa në se do të vendosen rregulla si ato me të cilat ata ndjekin leksionet, thjesht për hir të *detyrimit* dhe kërcënimit të mungesave. Pra, askush nuk mund ti organizojë ose të detyrojë pjesëmarrjen e tyre. Kjo eksperiencë, mjaft e zhvilluar në perëndim, nuk ka të bëjë fare me seminarët speciale që ne zhvillojmë tani, ku pjesëmarrja e studentëve është e detyruar nga rregullat e shkollës.

Gjithashtu, duhet të punohet më tepër nga eksperiencia e *panaireve të punësimit*. Në këtë fushë, ka një eksperiencë të mirë nga bashkëpunimi i fakultetit të Ekonomisë me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, Bashkinë e Tiranës dhe GTZ-në, ku të paktën një herë në vit, në mjediset e Pallatit të Kongreseve, ose të Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës “Pjetër Arbërori”, organizohen panairë punësimi. Por, tashmë ka ardhur koha që të ecet më përpara. Mendoj, se vetë organizimet studentore në bashkëpunim me pedagogët dhe dekanatin, duhet të organizojnë në mjediset e Fakultetit të Ekonomisë, ditë të bizneseve të llojeve të ndryshme. Në këto aktivitete, bizneset e ndryshme, me anë të stendave të caktuara, të mund të prezantojnë vetveten dhe të përpiqen të rekrutojnë për punë në të ardhmen studentët e viteve të fundit të studimeve.

Gjithashtu, organizimet studentore duhet të jenë më aktive dhe në bashkëpunim me departamentet, duhet të krijojnë databazën e studentëve të viteve të fundit e që përfundojnë studimet. Kjo databazë, duhet të mirëmbahet dhe përditësohet me informacion të ri rreth statusit të punësimit të studentëve të diplomuar. Pra, ajo duhet t’i shërbejë së pari të gjithë biznesmenëve që i drejtohen fakultetit të Ekonomisë për ndihmë, për të intervistuar studentë për punësim dhe njëkohësisht edhe studentëve të vitit të fundit dhe të sapodiplomuarve për të prezantuar vetveten në tregun e punës. Nga ana tjetër, kjo databazë do të shërbejë fakultetit për të patur informacion rreth statusit të punësimit dhe vendeve të punës të ish studentëve. Në këtë mënyrë edhe lidhja midis fakultetit dhe ish studentëve mbahet e gjallë për vitet në vijim.

Një kujdes veçantë, i duhet kushtuar edhe temave të kursit dhe punimit të diplomës. Së pari, mendoj se studenti, nuk duhet të ketë temë kursi në shumë lëndë, sepse, këto tema do të ishin të përcipta dhe pa vlerë (për të mos thënë se në disa raste do të ishin thjesht kopje materialesh të gjetura aty këtu, bile edhe në internet). E mjaftueshme do të ishte që studenti të kishte punime kursi vetëm në vitet e larta dhe vetëm një punim në semestër, pra gjithsej katër punime kursi. Ky punim mund të mbrohej para një komisioni pedagogësh të kursit dhe temat më të mira mund të paraqiteshin në një konkurim me vlerësim ku në komision të kishte edhe përfaqësues nga biznesi, administrata publike dhe aktorë të tjerë aktiv dhe të interesuar në fushën e edukimit ekonomik.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, është problemi i lidhjes së teorisë me praktikën për

studentët, pra procesi i *praktikës mësimore*. Tashmë, po konsolidohet eksperiencia e fituar nga praktikat mësimore, por numri i madh i studentëve e bën të vështirë sistemimin e tyre për të zhvilluar praktikën pranë bizneseve, bankave, administratës publike, institucioneve ndërkombëtare, etj. Kjo gjë, kërkon një bashkëpunim më të mirë të Fakultetit me këto institucione, sepse shpesh deri tani pranimi i studentëve në praktikë është trajtuar më tepër si një ndihmesë që u jepet pedagogëve në lidhjet e tyre personale me biznesin, dhomat e tregëtisë, drejtuesit e bankave, drejtuesit e administratës publike, etj., sesa si një detyrim që kanë edhe këto institucione për të investuar për përgatitjen cilësore të menaxherëve të rinj. Megjithatë, dua të theksoj se ka mjaft shembuj ku studentët pas përfundimit të praktikës dhe të studimeve janë punësuar aty ku kanë zhvilluar praktikën. Pra, dobishmëria e praktikës ka qenë mjaft e lartë.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Si përfundim, pavarësisht anëve negative dhe problemeve si dhe vështirësive të funksionimit të disa aspekteve të arsimit publik të theksuara mësipër, në asnjë mënyrë nuk mund të mohoj *arritjet* e deritanishme të sistemit arsimor shqiptar në kushtet e tranzicionit dhe në asnjë rast nuk do të doja të ulja *vlerat* e mjaft studentëve cilësorë të arsimuar brenda vendit, të cilët pa asnjë dyshim mund të krahasohen me nivelet më të larta të studentëve në vende të ndryshme të zhvilluara. Zhvillimi i vendit kalon përmes sfidave dhe vështirësive, por ajo që ne duhet të bëjmë është të punojmë për ta shpejtuar atë. Në këto kushte reforma që po ndërmerren në arsimin shqiptar është e mirëpritur dhe mjaft e domosdoshme. Ajo që duhet bërë është një konsultim edhe më i gjerë i hapave të saj për të patur rezultate sa më të mira.

Gjithashtu stafeve drejtuese të fakulteteve të ekonomisë, profesoratit të tyre dhe organizimeve studentore u del detyra që të jenë më aktiv dhe më të preokupuar për të ralizuar më mirë lidhet e fakulteteve me bizneset dhe praktikën ekonomike të vendit. Duhet të kuptohet mirë se universiteti dhe fakultetet nuk janë vetëm institucione mësimore, por institucione mësimore shkencore të lidhura ngusht me praktikën e përditëshme. Edhe vetë studentët e sapodiplomuar ose që vazhdojnë studimet mund të bëjnë më shumë vërejtje dhe sygjerime për përmirësimin e punës dhe jo të qëndrojnë pasiv.

BIBLIOGRAFIA

- Malaj A, Memaj F, dhe Hida S., "Albania, Financial Management in the Education System: Higher Education" Working Paper, Bamberg, Gjermani Dhjetor 2005,
- Memaj F, Hodaj H, dhe Tabaku J., "3rd international conference on education and economic development" Tema "Economic education in Albania and labour market challenges" organizuar nga Technological educational institute of Epirus Prevezë, Greqi 26-27 Maj 2006,
- Memaj F., "Autonomia dhe menaxhimi financiar në universitete: Rasti i Shqipërisë" Studim i realizuar për UNESCO - CEPES, Rumani, 2003
- Memaj F dhe Tabaku J., "Rritja e autonomisë financiare për shkollat e larta- kusht për zhvillimin cilësor të arsimit të lartë" Revista "Buletini shkencor", Universiteti "L. Gurakuqi", Shkodër, 2004, bashkëautor
- Memaj F., "Albania: vortices of imbalance" Revista "Higher Education in Europe" botues Routledge, pjesë e Taylor & Francis Group, Volumi 29, Nr. 3 / Londër, Tetor 2004
- Memaj F., "Probleme të bashkëpunimit të pedagogëve dhe studentëve me praktikën" Konferenca "Rritja e shpirtit sipërmarrës në universitete" Fakulteti i Ekonomisë, UT, Tiranë 9 Dhjetor 2005
- Memaj F., "Albanian Economic Education and the Challenges of the Labour Market" Konferenca "Il sistema Italia di formazione universitaria e post-universitaria ad il mercato del lavoro in Albania e nei Balcani" Konferencë e Ambasadës Italiane, Tiranë Janarr 2006.
- Memaj F. "Rritja e shpirtit sipërmarrës në universitete – forcë shtytëse për lidhjen e teorisë me praktikën" Revista "Ekonomia dhe Biznesi" Nr. 1 (21) 2006
- Stringa O. dhe Memaj F., "Mendimet e studentëve për arsimin e lartë" Revista "Buletini i Ekonomisë" Nr. 4, 1996
- Report on Trends and Development in Higher Education in Europe, 1998-2003, Meeting of Higher Education Partners, Paris, 23-25 June 2003.

EVOLUCIONI DHE SFIDAT E SHTETIT RREGULLATOR NË EUROPE

BURKARD EBERLEIN¹

ABSTRAKT. *Subjekti i këtij artikulli është rri-regullimi i shërbimeve dhe infrastrukturave publike në kontekstin e ri të liberalizimit të tregut. Është një subjekt që po fiton gjithnjë e më shumë rëndësi në përcaktimin e politikave publike në Europë: telekomunikacioni, transportet ajrore, hekurudhore, elektriciteti, gazi, uji, janë shembuj sektorësh ose rrjetesh industriale që tradicionalisht në Europë ishin pronë ose monopole ekskluzive të shtetit dhe që u bënë objekt i një rri-rregullimi. Lëvizja e përgjithshme drejt privatizimit të ndërmarrjeve publike dhe liberalizimit të tregjeve të monopolizuar në ekonomitë europiane nuk çoi në një tërheqje të plotë të shtetit. Në të kundërt, qeveritë kanë “rri-rregulluar” fort aktivitetet ekonomike. Kjo bashkë-egzistencë paradoksale e liberalizmit me regullimin i dha shkas tezës së G. Majone “ngjitja e shtetit rregullator në Europë”. Ky artikull eksploron një dimension deri diku të lënë mënjanë që është ai i kontigjencave institucionale dhe variacioneve të shtetit rregullues. Duke u nisur nga shembuj të marrë në fushën e ndjeshme të variacioneve të infrastrukturave dhe shërbimeve publike (rregullimi ekonomik) artikulli kundërshton vizionin e Majone sipas të cilit paska një konvergjencë midis procesit rregullues të vetëm të bazuar mbi efikasitetin dhe kompetencën. Përkundrazi, argumenti kryesor është se natyra dhe rezultatet e rregullimit ekonomik do të varen kryesisht nga konfigurimet institucionale specifike duke përfshirë njëkohësisht nivelin europian, kombëtar dhe sektorial.*

SHTETI RREGULLATOR NË EUROPE

Rreth fundit të viteve '70, një erë privatizimi, liberalizimi dhe çrregullarizimi filloi të frynte mbi ekonomitë europiane. Në përgjithësi, ndërmarrjet tregtare publike ishin subjektet e para të privatizimit. Pas një nisje të mirë me telekomunikacionet, procesi i liberalizimit dhe privatizimit (të pjesshëm) u shtri në shërbimet publike si elektriciteti. Edhe vetë Franca, bastion tradicional i shërbimit publik nuk i shpëtoi dot kësaj lëvizjeje. Megjithatë, ky evolucion nuk çoi në një tërheqje të thjeshtë dhe të qartë të shtetit si aktor ekonomik i fuqishëm. Në të kundërt, përpjekja për të përcaktuar kufijtë midis tregut dhe shtetit, shkaktoi një rri-rregullim të skajshëm të proceseve ekonomike sipas niveleve të ndryshme politikë: nacional, europian, dhe ndonjëherë edhe ndërnacional. Shpjegimi më i mirë i këtij paradoksi midis ri-rregullimit dhe liberalizimit, na jepet nga Giandomenico Majone që flet për një ndryshim të paradigmës midis shtetit “pozitiv” (ndërrhyrës) dhe shtetit rregullator¹. Ky ndryshim përfshin një dimension njëherazi funksional dhe territorial. Nga pikëpamja funksionale, shteti dikur prodhues i të mirave dhe shërbimeve, bëhet rregullator asnjëanës i proceseve të tregut. Nga pikëpamja territoriale, funksioni rregullator supozohet të kalojë nga niveli kombëtar në nivelin europian².

¹Profesor në Universitetin Politeknik të Mynihut, Gjermani.

Megjithatë, edhe nëse ideja e Majone mbi “*forcimin e shtetit rregullator*” u pranua gjerësisht, ajo nuk është testuar empirikisht. Kjo është e vërtetë sidomos për “rregullimin ekonomik” të pushtetit monopolist (esenciale për infrastrukturën dhe shërbimet) për t’u kundërvënë ndaj “rregullimit social”, (d.m.th. mjedisi, shëndeti, siguria). Veç të tjerash, teza e Majone mbështetet mbi parimin e një **konvergjence** drejt një modeli të rregullimit unik midis bashkësive të ndryshme institucionale.

Ky artikull ka për qëllimin thellimin e dimensionit deri diku të neglizhuar, **kontingjences institucionale** dhe variacione të shtetit rregullator. Do të flasim në fillim për nevojën dhe për konceptin e rregullimit në infrastruktura dhe do të përcaktojmë më pas se çfarë sifidash paraqet rregullimi për vendimmarrësit politikë në kalimin drejt një “shteti rregullator” në gjirin e ekonomive europiane. Në të kundërt me vizionin teknokratik të Majone, që mburr konvergjencën drejt një procesi rregullues unik të bazuar mbi kompetencën dhe efikasitetin, duam të tregojmë se rregullimi është një proces shumë politik dhe se pasojat politike të rregullimit ekonomik varen thellësisht nga konfigurimet institucionale specifike ku përfshihen si niveli kombëtar europian dhe organizatat sektoriale. Këto variabla institucionale duhet të drejtojnë kërkimet e ardhshme mbi shtetin rregullator në Europë.

PASOJAT E LIBERALIZIMIT PARADOKSI I RI-RREGULLIMIT

Duke hedhur vështrimin pas, e dimë tashmë se vala e privatizimit, liberalizimit dhe “çrregullimit”, që ka prekur ekonominë politike të vendeve të industrializuara gjatë 15 viteve të fundit, nuk ka çuar në një tërheqje të plotë të shtetit si aktor ekonomik³. Përkundrazi, qeveritë janë angazhuar në një rri-rregullim të aktiviteteve ekonomike. Shprehja kaq e zakonshme e “çrregullimit” në këtë kontekst është zhgënjyese. Përshembull në fushën e pafund të tregjeve financiarë, rregullimi i shtetit ka pësuar rritje të ndjeshme⁴. Në fakt nocioni i “reformave rregullatore”⁵ përshkruan shumë më saktësisht atë që ka ndodhur, në masën ku, siç vë në dukje Steven Vogel, ajo mund të kombinojë mjaft mirë “treg më i lirë” me “më shumë rregulla”⁶. Megjithë presionet e forta për një çangazhim të shtetit – presione të natyrës ideologjike dhe teknologjike, të ushtruar nga tregu ose nga urdhëresat e integrimit europian, - qeveritë vazhdojnë të ushtrojnë në nivele të ndryshme, një kontroll të rëndësishëm mbi proceset e tregut.

THEMELET E RI-RREGULLIMIT

Përse qeveritë merren me një rri-rregullim ekonomik në sektorët që kishin zgjedhur fillimisht për të liberalizuar ose privatizuar? Kjo pyetje duhet të rishikohet në kontekstin e shkaqeve që janë në themel të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi. Në një ekonomi tregu, kjo ndërhyrje justifikohet me atë që ekonomistët quajnë “dështime të tregut” (market failure): në disa rrethana, tregjet nuk janë mënyra më efikase e shpërndarjes dhe koordinimit social. Infrastruktura dhe shërbimet publike që mund të përshkruhen si një “varietet sistemesh të mbështetjes së përgjithshme prej nga varen pjesa më e madhe e aktiviteteve ekonomike, kulturore dhe politike”⁷ janë konsideruar tradicionalisht si sektorë ekonomikë që kërkojnë ndërhyrjen e shtetit, dhe kjo për shumë arsye.

Nga pikëpamja politike, këto shërbime dhe infrastruktura, janë parë si shumë të ndjeshme, në masën ku realizimi i tyre prek sigurinë ushtarake dhe mirëqënien e një vendi dhe gjithë popullsisë e një vendi varet prej tyre. Nga pikëpamja ekonomike, infrastruktura konsiderohet si “e mirë publike”, (kolektive) d.m.th. konsumimi i të cilave nuk është as ekskluziv as nuk ngjall konkurrencën midis individëve. Ato mund të shihen edhe si të mira tutelare, (merit goods) që nuk janë vlerësuar sa duhet nga forcat e tregut ose nga konsumatorët. Por argumenti ekonomik më i rëndësishëm për të justifikuar ndërhyrjen e shtetit, është ai “i monopolit natyror”. Kemi të bëjmë me një monopol

natyror kur, në raport me ekonomitë për shkallë, të zgjerimit dhe të dëndësisë, furnizimi i një infratruckture nga një ndërmarrje e vetme, është më efikas sesa kur merret përsipër nga më shumë ndërmarrje⁸. Monopoli natyror është parë tradicionalisht si një karakteristikë kryesore e industrive të infrastrukturës që mbështeten mbi rrjete të mëdha (linja telefonike, hekurudha, rrjete elektrike, etj), me një shkallë të madhe “sistemizimi” dhe “eksternaliteti”⁹. Megjithatë, teoritë ekonomike të kohëve të fundit kanë treguar se rrjetet fizike duhet të ndahen qartë nga operacionet ose shërbimet e siguruara nga këto rrjete dhe se monopoli natyror shpesh identifikohet me rrejtin fizik.¹⁰

Nëse monopoli është modeli më efikas i sigurimit të një shërbimi ose një infrastrukture, atëherë qeveria duhet të marrë masa që monopolizuesi të mos abuzojë me pushtetin e tij. Në vetevete, privatizimi ose liberalizimi nuk prek arsyet strukturore që motivojnë ndërhyrjen e shtetit: as ndryshimin e kontrollit mbi të drjetat e pronës me anë të privatizimit, as dobësimi i shtrëngimeve (liberalizimi) nuk sigurojnë në vetvete, tranzicionin e sukseshëm drejt një tregu konkurses dhe drejt një niveli kënaqjeje dhe cilësie në sigurimin e një shërbimi. Me fjalë të tjera, nuk bëhet fjalë për një pronë publike (monopol) dhe lojë të lirë të forcave të tregut, por për një zgjedhje midis formave të ndryshme të ndërhyrjes së shtetit. *Grosso modo*, ka dy opsione të mundshme: ose shërbimet e infrastrukturës ofrohen nga një monopol publik, ose janë pronë e drejtpërdrejtë e shtetit dhe kontrollohen nga qeveria; ose qeveria përcakton procedurat që i lejojnë të kontrollojë sjelljen e monopolizuesve privatë (rregullimi publik).

Në Europë, në sektorët e infrastrukturës mbizotëroi deri vonë opsioni i parë. Kurse në Shtetet e Bashkuara, më shumë vend mori opsioni i dytë, pra rregullimi publik i një sektori privat. Tronditjet aktuale në ekonomitë europiane na shtrojnë pyetjen mos vallë po asistojmë në një ndryshim drejtimi drejt modelit amerikan? Kjo pyetje është në zemër të teorisë së Majone mbi “ngjitjen e shtetit rregullator në Europë”. Por para se të shkojmë më larg, do të donim të ndaleshim pak te koncepti i rregullimit.

KONCEPTI I RREGULLIMIT

Kuptimet e termit “rregullim” janë të panumurta¹¹. E vetmja pikë e përbashkët është se nocioni i rregullimit supozon kufizimin e zgjedhjes (private) nga imponimi i rregullave (publike). Një analizë më e thellë tregon një ndarje midis kuptimit europian më të gjerë dhe qasjes amerikane më të ngushtë të rregullimit.

Për shumë ekspertë europianë, rregullimi, si prodhim rregullash, ka të bëjë me një spektër të gjerë aktivitetesh qeveritare, madje me ndërtimin e të gjithë qeverisjes. Sipas Robert Boyer, në “Teoria e rregullimit”, rregullimi ka të bëjë me bashkësinë e rregullave që qeverisin mënyrat e prodhimit kapitalist¹². Mbi baza teorike të ndryshme, Dyson propozon një përkufizim po aq të gjerë të termit kur flet për karakter të katërfishtë të rregullimit: rregullimi si fenomen kulturor, (d.m.th konceptimet e rolit të shtetit në ekonomi dhe në shoqëri), si një mekanizëm formal që i përket institucionit. (“rregullator ekspert”), si një proces politik dhe koalicioni, dhe së fundmi si një proces nxënieje¹³. Hancher dhe Moran e përdorin konceptin e “hapësirës rregulluese” kontoret e të cilës janë përcaktuar që në themel nga ndërveprimet midis organizatave publike dhe private në ekonomitë kapitaliste të avancuara¹⁴.

Në kontekstin amerikan, rregullimi është një koncept i përcaktuar më ngushtësisht dhe i zhvilluar më mirë. Studimi i rregullimit ka arritur madje një status nëndispline në shkencat ekonomike dhe politike. Rregullimi, në kuptimin amerikan, zbatohet ndaj kontrollit publik të ushtruar mbi aktivitetet ekonomike të sektorit privat në emër të interesit publik¹⁵. Rregullimi, si formë e dallueshme e kontrollit qeveritar, supozon në parim një organizëm qeveritar që ka në ngarkim të nxjerrë rregulla shtrënguese mbi disa vendime ekonomike (private) me anë të procedurave administrative dhe juridike¹⁶. Shpirti i rregullimit “alla amerikan” është përshkruar nga Selznik kur e përcakton rregullimin si “kontroll të përhershëm të një organizmi publik mbi aktivitetet që janë të vlerësuara nga një komunitet”¹⁷. Aktivitetet e tregut janë të vlerësuara, në kuptimin që ato

meritojnë të jenë të mbrojtura, por ato kanë gjithashtu nevojë të jenë të kontrolluara. Kjo është dilema themelore e rregullimit. “kontrolli” në kuptimin që e përdorëm ne, i referohet faktit se rregullimi është më tepër se nxjerrja e një ligji, por që ai kërkon, veçanërisht, “një lloj mbikqyrje të aktiviteteve të rëndësishme, një vlerësim të përhershëm të vlerave publike në lojë, dhe kapacitet juridik për t’u përgjigjur ndaj ndryshimit të nevojave dhe të rrethanave”¹⁸.

Sipas konceptimit amerikan, kontrolli mund të përkufizohet si *një kontroll i jashtëm i tregut i ushtruar nga juridiksioni publik në mënyrë të përhershme dhe rast pas rasti*. Ky përkufizim përfshin zbatimin (rast për rast) të së drejtës së konkurrencës (antitrust). Kontrolli rregullator nuk ushtrohet domosdoshmërisht nga një organizëm i pavarur. Autoritetet e konkurrencës ose minisritë tradicionale mund të jenë gjithashtu aktorët kryesorë publikë. Përqafimi i këtij konceptimi amerikan më formal për rregullimin, nuk do të thotë se e lëmë mënjatë **kontingjencën** dhe dimensionin institucional të procesit të rregullimit. Por këtu qëndron edhe gabimi kryesor i qasjes së Majone për sa i përket rritjes së shtetit rregullator në Europë, dhe për të cilën do të flasim tani.

NGJITJA E SHTETIT RREGULLATOR NË EUROPE

Në punimin e tij novator mbi ngjitjen e shtetit rregullator në Europë, Majone përpiket të mbushë boshllëkun që ndan traditën rregullatore amerikane nga zhvillimet që vihen re kohët e fundit në ekonominë politike europiane¹⁹. Në dobësimin e pronës publike si model tradicional qeverisje në Europë, ai sheh një ndryshim të paradigmes midis shtetit pozitiv ose ndërhyrës dhe shtetit rregullator²⁰. Nën presionin e zhvillimeve teknologjike, ekonomike dhe ideologjike, mënyrat tradicionale të ndërhyrjes dhe të kontroleve qeveritare, u rrënuan, dhe kjo jo në favor të tregut të lirë, por në favor të formave të reja të ndërhyrjes publike. Majone vëren një evolucion të rolit të shtetit: dikur “prodhues i të mirave dhe shërbimeve” shteti shndërrohet në “rregullator dhe funksioni i tij kryesor është të sigurojë që aktorët ekonomikë luajnë sipas rregullave të përcaktuara të lojës”²¹.

Majone e përcakton rregullimin si një nga tre tipet kryesore të ndërhyrjes në ekonomi, kurse dy të tjerat janë rishpërndarja e të ardhurave dhe stabilizimi makroekonomik. Dobësimi i shtetit kejsian ndërhyrës dhe rishpërndarës, nxjerr në skenë një shtet të ri rregullator, instrumenti kryesor i të cilit është fabrikimi i rregullave. Molla e sherrit nuk janë më atributet buxhetore por rishikimi dhe kontrolli i rregullave, dhe në këtë sektor, ndërhyjnë aktorë të rinj, veçanërisht rregullatorë, gjykatës dhe ekspertë. Duke patur parasysh diferencat sipas vendeve për sa i përket shpejtësisë dhe shtrirjes së ndryshimeve, Majone pohon se duket, gjithsesi, një prirje e qartë drejt një “shteti rregullator”.

Këtu qëndron aspekti funksional i argumentit të tij. Nga pikëpamja territoriale, Majone sheh një zhvendosje të funksioneve të reja rregullatore nga niveli nacional në nivelin europian. Centralizimi relativ i funksioneve rregulluese, nga ana e kërkesës, shpjegohet si një mënyrë për të korrigjuar efektet e jashtme të politikave dhe për të zvogëluar koston e transaksioneve. Centralizimi vjen gjithashtu nga mosbesimi reciprok i shteteve antare në lidhje me rregullimet nacionale të secilit²². Nga ana e ofertës, ngjitja e konsiderueshme e rregullimit në nivel europian përbën mjetin më të lehtë për vendimmarrësit politikë, dhe veçanërisht për Komisionin Europian, për të promovuar programe politike europiane: politikat rregullatore lejojnë të hiqen shtrëngimet buxhetore dhe barrierat sistematike që pengojnë integrimin.

Puna e Majones është një pikënisje e shkëlqyer, megjithatë, ka probleme në imazhin që ai jep për procesin rregullues. Kjo ndodh për shkak të një përcaktimi ekonomik tepër të ngushtë për rregullimin. Rregullimi, sipas Majone, mjaftohet me korrigjimin e dështimeve të tregut dhe ndahet qartë nga problemi i korrigjimit të rezultateve të tregut, d.m.th nga çështja e rishpërndarjes. Siç e thotë vetë Majone, “të marrësh si kriter kryesor normativ, efikasitetin mikro-ekonomik, do të thotë se instrumentat e rregullimit nuk duhet të ishin përdorur për të arritur objektiva politike të rishpërndarjes ose objektiva të tjerë sociale”²³. Dhe kjo sepse “në një demokraci, politikat dhe

institucionet e rishpërndarjes mund të legjitimohen vetëm nga përgjegjësia politike e drejtpërdrejtë”. Kjo do të thotë se këto çështje nuk duhet të lihen në duart e rregullatorëve të pavarur dhe pa përgjegjësi politike. Megjithatë, çështjet e efikasitetit, të përcaktuara si “lojra me shumë pozitive ku të gjithë mund të fitojnë” mund të delegohen te organizmat rregullues të pavarur me kusht që “politikatat dhe institucionet e orientuara mbi efikasitetin, të jenë në thelb të legjitimuara nga rezultatet që arrijnë²⁴.”

Nga pikëpamja normative, kjo qajse na lejon të rrokim problemin në legjitimitetin e vendimit jo mazhoritar. Argumenti ynë është se është shumë e vështirë të ndash në praktikë problemet e efikasitetit dhe të rishpërndarjes dhe të kufizosh rregullatorët vetëm me çështjen e efikasitetit mikroekonomik. Bëhet fjalë për një argument të përgjithshëm që tejkalon kuadrin e thjesht rregullimit ekonomik të ekonomive dhe infrastrukturës të ndjeshme politikisht dhe që kanë implikime të rëndësishme nga pikëpamja e shpërndarjes. Procesi politik i rregullimit nuk përjashton çështjet e drejtësisë dhe të shpërndarjes. Në fakt ka efekte shpërndarëse ku përfshihen humbës që nuk janë shpërblyer për fitimet e efikasitetit, tek të cilët nuk kanë akses. Caparoso bën një vërejtje të ngjashme në lidhje me faktin që Majone “nuk ngre çështjen e *cui bono* ky problem vjen ngaqë orientimi i tij bazohet mbi efikasitetin”²⁵.

Është e qartë se ndërhyrja ekonomike tradicionale nëpërmjet pronës publike nuk ishte e orientuar vetëm dhe vetëm mbi efikasitetin e tregut. Qeveritë përdornin pronën publike ose lejën ekskluzive për të gjithë llojet e qëllimeve sociale dhe politike që merrnin shpesh përparësi mbi shqetësimin për efikasitetin e shpërndarjes: siguri kombëtare, zhvillimi ekonomik, shpikjet teknologjike, shpërndarja e të ardhurave midis shtresave ose midis rajoneve. Në se procesi i liberalizmit mund të priret të kufizojë rolin e qeverisë në atë të rregulluesit të tregjeve duke patur vetëm perspektivën e efikasitetit, nuk duhet të prisim nga këto të fundit që të braktisin fare hapur objektiva të tjerë socialë dhe politikë që kishin dikur në kontekstin e pronës publike. Çështja është të dihet nëse – dhe si – kalimi nga prona publike në rregullimin publik munda të vendosë në plan të parë çështjet e efikasitetit, në dëm të çështjeve të tjera? Përmbledhtazi, çfarë ndikimi ka tranzicioni drejt rregullimit publik mbi natyrën dhe impaktin e ndërhyrjes qeveritare? Para se t’i përgjigjemi kësaj pyetjeje na duket me vend të thellojmë pak më shumë çështjen e sfidave të rregullimit.

SFIDAT E RREGULLIMIT; ÇFARË ËSHTË NË LOJË

Cilat janë sfidat dhe problemet specifike të rregullimit publik? Fillojmë nga objektivat. Do të bëjmë një dallim midis *rregullimit të rendit të parë dhe rregullimit të rendit të dytë*. Rregullimi i rendit të parë ka të bëjë me nevojën për të krijuar dhe ruajtur tregje konkures. E thënë në përgjithësi, flasim këtu për funksionin rregullator si inkurajues të krijimit të tregjeve të reja dhe favorizues të konkurrencës. Kjo detyrë është veçanërisht e rëndësishme për sa i përket shërbimeve publike. Ashtu si e kemi theksuar edhe më lart, shërbimet publike përfshijnë industrinë e organizuara në rrjete dhe që janë, të paktën për sa i përket rrjeteve fizikë, monopole natyrorë. Si rrjedhim, shfuqizimi i kufizimeve mbi tregun, nuk do të nxisë konkurrencën, ose nuk do të krijojë konkurrencë, meqë vendosjet e reja në treg do të supozojnë investime të parikuperueshme në aktivë specifikë dhe jo të rishpërnarshëm. Në këto kushte tregjet monopolistikë “do të kundërshtohen” me vështirësi, domethënë të hapur ndaj konkurrencës.

Në këtë kontekst, rregullimi bëhet i domosdoshëm për të kufizuar efektet e konkurrencës, duke kufizuar, në mënyrë të përgjithshme, sjelljen antikonkurrenciale të monopolizuesve (p.sh. kontrollin e çmimeve dhe përfitimeve), dhe më specifikisht, duke futur rregullat e pro-konkurrencës që do t’u lejojnë konkurrentëve të kenë akses në instalimin e rrjeteve. Këto instalime përbëjnë pikën mbytëse të konkurrencës, problem që do e zgjidhë rregullimi me anë të çështjes së “aksesit të duhur” apo “instalime esenciale”, pra rrjeti. Ekzitojnë edhe instrumente të tjerë që lejojnë të preket monopoli natyror: të shpërndahet monopoli publik pikërisht para privatizimit, në monopole

zonalë, me qëllim që t'i hapet rruga të famshmes *yardstick competition* ose të organizohet një ofertë për lirim nga taksa ose lejë për monopol të kufizuar në kohë ("konkurrencë mbi fushën"). Këto detyra kërkojnë një kontroll të vazhdueshëm nga ana e një organizmi publik të aftë për të vëzhguar dhe reaguar, rast pas rasti, ndaj zhvillimeve të tregut. Rregullimi bëhet një punë e përhershme, me përjashtim të rastit kur karakteristikat e monopolit natyror mund të kapërcehen me anë të ndryshimeve teknike.

Në praktikë, ky rregullim i rendit të parë I drejtuar mbi efikasitetin, plotësohet ngë një rregullim i rendit të dytë ose rregullim social dhe politik, që më tepër ka të bëjë me korrigjimin e efekteve të padëshiruara të tregut sesa me korrigjimin e dështimeve të tregut. Përsëri, kjo çështje është veçanërisht e rëndësishme për rastin e shërbimeve publike. Që në momentin që të gjithë zgjedhësit varen nga këto shërbime, rëndësia politike është shumë e madhe²⁶. Qeveritë duhet të veprojnë në mënyrë të tillë që interesat e disa përdoruesve (të shërbimeve), kur nuk janë plotësuar nga forcat e tregut, të merren parasysh. Ato për shembull duhet të garantojnë një servis minimum me një çmim të arritshëm nga të gjithë qytetarët. Të tjera çështje të natyrës politike mund të merren parasysh, si p.sh fakti që disa përzierje (të shëndetshme ekologjike) burimesh energjie të respektohen nga furnizuesit privatë të energjisë. Sigurisht, nuk ka kufij objektivë në lidhje me atë çka mund të konsiderohet si shërbim publik apo detyrim ndaj të tjerëve. Vendimi është politik.

Kushti i dyfishtë i rregullimit, - njëherësh investime të mëdha në aktivet specifike dhe një dimension politik shumë i rëndësishëm- mund të shihet si problematik. Nga njëra anë, duke patur parasasysh domosdoshmërinë e ndërhyrjes së qeverive, rreziku për investitorët privatë është shumë i madh, - me përjashtim të rastit kur këta veprojnë në një fushë ku amortizimi i aktiviteti është shumë i shpejtë dhe përfitimet në afat shkurtër janë shumë të rëndësishme. Për të tërhequr investitorë të rinj, qeveritë duhet të krijojnë sisteme kontrolli të besueshme dhe që ofrojnë stabilitet afatgjatë. Kjo do të thotë se duhet të krijojnë mekanizma që kufizojnë veprimin administrativ arbitrar dhe rregullimin e pakontrolluar. Por nga ana tjetër, qeveritë rezisojnë edhe duke i patur krahë e këmbë të lidhura dhe me hapësirë veprimi të kufizuar, për të bërë rregullime përballë zhvillimeve të reja. Një degë e ekonomisë institucionale e koncepton këtë konfigurim si një "kontratë të paplotë" (incomplete contracting) midis qeverisë ose rregullatorit dhe – industrisë që e pëson këtë rregullim. Edhe nëse detyrimet sociale dhe politike shprehen në një licencë, rregullat dhe detyrimet janë subjekt interpretimi dhe nuk sigurojnë zgjidhje për çdo problem në të ardhmen. Për pasojë, rregullimi do të jetë i përhershëm dhe në një farë mase rrezikshmërisht në dorë të qeverisë (diskrecionar). Në këtë perspektivë, problemi kryesor është se liria e ndërhyrjes së qeverisë kufizohet për të mbrojtur të drejtat e pronës private, por në të njëjtën kohë funksionet e ndërhyrjes rregullatore që kanë të bëjnë me rritjen e mirëqënies në emër të interesit publik, neglizhohen. Një tjetër degë e ekonomisë institucionale njih nevojën e një kontrolli politik dhe fokusohet mbi mënyrën se si forma dhe zgjidhjet institucionale mund të sigurojnë nga njëra anë, autoritetet rregullatore, të konsideruara si agjentë administrative, të mbeten nën kontrollin efektiv të eprorëve të tyre politikë (d.m.th parlamenti ose ekzekutivët e zgjedhur) dhe nga ana tjetër këto autoritete rregullatore të mund të kontrollojnë në mënyrë efektive industrinë që janë objekt i rregullimit të tyre. Modelet formale të kontrollit politik nuk lejojnë që të kapet kompleksiteti institucional i procesit politik të rregullimit²⁷.

Pikëpamja e shkencës politike kërkon një konceptualizim më të sofistikuar të procesit të rregullimit që të mund të njohë diversitetin dhe dinamikën e shqetësimeve legjitime dhe të interesave që janë në lojë. Kështu mund të argumentonim, se "kontrata e paplotë" nga pikëpamja e ndryshimit të preferencave dhe të politikave ndaj ndryshimit të tregut, është një tipar karakteristik i jetës politike demokratike. Por, shërbimet e infrastrukturës dhe të interesit publik shtrojnë çështjen e të drejtave të qytetarëve dhe të problemeve të shpërndarjes. Aksesit në të mirat sociale ose të merituar bazë, (p.sh elektriciteti) mund të shihet si "një e drejtë pozitive ose një liri"²⁸. Nisur nga kjo, u hodh ideja se duhet të ketë kufizime ndaj "markandizimit" të shërbimeve publike, gjë që përmban në mënyrë të pashmangshme një lloj përgjegjësie të shërbimeve publike²⁹. Kjo pasqyrohet në

konceptin juridik amerikan për ndërrmarrjen “e prekur nga një interes publik”, e shprehur për herë të parë nga gjykata e lartë në 1887 në çështjen e famshme *Munn Vs Illinois*. Një trajtim më i gjerë i rëndësisë së rregullimit do të përfshijë efikasitetin mikroekonomik dhe të drejtat politike të qytetarëve. Në këtë perspektivë, sugjerojmë dallimin e katër tipeve të problemeve me të cilët përballlet rregullimi publik.

E para kë të bëjë me një marrëdhënie “të vazhdueshme” dhe kontrolli midis rregullatorit dhe industrisë së rregulluar. Kjo marrëdhënie karakterizohet ngë një asimetri e thellë informacionale. Për një rregullim efektiv, rregullatori varet kryesisht nga informacioni i kontrolluar nga monopolizuesi. Në përgjithësi, objektivi i rregullimit, pra respektimi i rregullave, supozon një lloj bashkëpunimi midis organizmave rregullues dhe industrive të rregulluara. Nevoja për të bashkëpunuar, mund të çojë rregullatorin të bëjë disa lëshime mbi disa objektiva të rregullimit si detyrimet e interesit publik. Këtu është një nga burimet e rëndësishme të kapjes së rregullatorit nga industria e rregulluar.

Tipi i dytë i problemit ka të bëjë me harmonizimin e vështirë midis qëllimeve të konkurrencës dhe qëllimeve të shërbimeve publike. Rregullatorëve u ngarkohet shpesh të ndjekin objektiva të paqartë dhe kontradiktore. Kjo mund t’u sjellë atyre hapësirë më të madhe veprimi, por mund edhe të paralizojë veprimin e tyre në masën ku vendimet e tyre do të jenë vazhdimisht në pikëpyetje, ngaqë nuk do të kenë arritur objektivat.

Tipi i tretë i problemit ka të bëjë me shpërndarjen e pushtetit rregullues midis trupave qeveritarë, dhe për pasojë me çështjen e koordinimit. A do të ketë organizimi rregullues pushtetin e nevojshëm për të kryer me sukses disa detyra, apo disa pushtete të rëndësishme do të sigurohen nga qeveria apo nga organizma rivale? Efikasiteti rregullator mund të vuajë nga mungesat e koordinimit ose konfliktet midis organizmave të ndryshëm. Në këtë kuptim një organizëm që ushtron kontrollin mbi një industri të vetme, është më shumë i ekspozuar ndaj një rreziku *kapjeje*, sesa një organizëm që ushtron kontrollin mbi disa sektorë.

Tipi i fundit i problemit mund të formulohet nga pyetja që vijon: “kush ruan rojet?”³⁰ d.m.th kush rregullon rregullatorët? Nga njëra anë rregullatorët kanë nevojë për një lloj pavarësie politike për të kryer punën e tyre. Nga ana tjetër, vendimet e rregullatorëve të pavarur, nuk kanë kurrëfarë përgjegjësie politike. Rreziku këtu nuk është devijimi nga objektivat e rregullimit, në përfitim të industrisë, por në përfitim të vetë rregullatorit. Me një fjalë, kontrolli mbi rregullatorin mund të jetë i pamjaftueshëm dhe projektet institucionale të inkurajimit apo sanksionimit nuk do të mund të zgjidhnin problemin.

Si përmbledhje, rregullimi ekonomik paraqet një numër të madh vështirësish por kjo nuk do të thotë se format e mëparshme të administrimit ekonomik – prona publike ose monopoli – nuk hapnin asnjë problem. Por në kontekstin e mëparshëm, konflikti midis qëllimeve konkurruese, në parim, mund të zgjidhej nga hierarkia ministeriale kombëtare. d.m.th që qeveria në fuqi vendoste se kush ishte “interesi publik”. Tranzicioni drejt një tregu të liberalizuar dhe europian mund të bëjë të mendosh se përcaktimi i vjetër i “interesit publik” (si edhe koalicioni që e mbështeste) i orientuar mbi pronën publike, do të vihej seriozisht në diskutim. Sot mund të shtrohet pyetja se cilat janë pasojët reale të kalimit drejt rregullimit publik në kontekstin e post-liberalizimit.

KALIMI NË RREGULLIMIN PUBLIK: NJË MODEL?

Duket sikur zhvillimi i rregullimit publik si një formë e ndërhyrjes publike do të shkaktojë pasoja strukturale afat gjatë në kuadrin e proceseve politike: një “juridikizim” të politikës (rregulla juridike të detajuara dhe zgjidhje konfliktesh në gjykata), një pluralizim dhe një formalizim të marrëdhënieve midis shtetit dhe grupeve të interesit (zhvillimi i grupeve të interesit në një fushë të vetme, procedurë formale pjesëmarrjeje), dhe më përgjithësisht, një shkallë më e lartë konflikti dhe pasigurie në nivelet e marrjes së vendimeve³¹.

Për shembull, për Majone, koalicioni korporatist i prodhimit i përbërë nga aktorët politikë, shefat e

ndërmarrjeve publike dhe sindikatave, që dominon dhe përcakton interesin publik në një kontekst të pronës shtetërore, duhet të dalë në hije për tua lënë vendin strukturave më pluraliste³². Urdhrat e konkurrencës europiane, të forcave të tregut ose të shtrëngesave rregulluese (kontroll rregullator kombëtar dhe rregullim ndërkombëtar i konkurrencës) duhet të bashkohen për të ulur përfitimet e monopoleve dhe për të rritur përfitimet e konsumatorëve, në kurriz të grupeve të prodhimit. Në këtë perspektivë, duhet të dilnin dy grupe të reja: nga njëra anë gjykatat dhe institucionet e ngarkuara me rishikimin e ligjeve në përgjithësi, dhe nga ana tjetër, ekspertët dhe rregullatorët. Grupet e interesit të ndërmarrjes do të humbin rëndësinë e tyre në përfitim të grupeve joekonomike të lidhur me një fushë të vetme. Ajo çka mendon Majone, duket se është një amerikanizim i vendeve europiane që do të thotë se, gjatë tranzicionit drejt një shteti rregullator, korporatizmat kombëtarë do të zëvendësohen nga tipe organizmash më pluraliste.

Është legjitime të përqëndrohemi tek ndryshimet strukturale tip dhe afatgjatë, por është gjithashtu e rëndësishme të shmanget pengesa e funksionalizmit. Në lidhje me këtë, pozicioni i Majone mund të kritikohet për atë sa ai tradhëton, së pari, një pozicion normativ dhe analitik të karakterizuar nga vendimet teknokratike në kontradiksion të plotë me karakterin e domosdoshëm politik të pushtetit rregullues të tregut. Së dyti, dhe ky është një element shumë i rëndësishëm, arsytimi i Majone çon në pohimin kategorik të një konvergjence transsektoriale dhe transnacionale drejt një modeli unik rregullimi. Në të kundërt, ne mendojmë se ka një rrugë kërkimi të hapur që do të lidhej me mënyrën se si qeveritë, në nivele të ndryshme administrimi territorial dhe në funksion të organizimeve të ndryshme institucionale, do të përballen me sfidën e rregullimit dhe cilat do të jenë pasojat. Edhe pse nuk mund të pohoet se modeli i ri-rregullimit europian do të ndjekë pikë për pikë atë të SHBA-ve, eksperiencia amerikane e ri-rregullimit na shërben si një pikënisje e mirë për një reflektim mbi faktorët institucionalë që kushtëzojnë procesin e rregullimit.

MODELI AMERIKAN DHE DEBATI TEORIK: MËSIMET MBI KONTINGJENCËN INSTITUCIONALE.

Si zgjidhje përballë problemve të rregullimit, Shtetet e Bashkuara kanë adoptuar një rregullim statutor të kryer nga organizma ose komisione me qëllim të vetëm ose të drejtuara mbi një industri të vetme. Parimi bazë është t'u caktohet ekëpertëve që gëzojnë një autonomi relative në raport me kontrollin politik të drejtpërdrejtë ose të ushtruar nga partitë politike – detyra delikate e vlerësimit të interesit publik dhe e marrjes së vendimeve. Federal Trade Commission ose Federal Communication Commission, janë shembuj të këtij lloj organizimi. Por kjo nuk do të thotë se organet rregulluese dhe komisionet veprojnë në pavarësi të plotë.

Shtetet e Bashkuara konsiderohen si prototip i shtetit rregullator. Historia e rregullimit amerikan modern fillon në fund të shekullit të XIX-të. Zhvillimi i shoqërive të mëdha private dhe i trusteve shkaktuan një reagim rregullator shumë të fortë përballë mosebesimit shumë të thellë që nxisnin ndërmarrjet e mëdha. “Vendi i *trustit* ishte edhe vendi i *antitrustit*³³”. Por meqë mosbesimi ndaj *big government* ishte po aq i madh sa ai ndaj ndërmarrjeve të mëdha, ishte e qartë se prona publike nuk mund të ishte një zgjidhje. Në të kundërt nga Europa, në SHBA, beteja sociale kundër kapitalizmit nuk ishte e përqëndruar mbi çështjen e pronës, por mbi çështjen e rregullimit. *Sherman antitrust act* në 1890 dhe krijimi i Interstate Commerce Commission në 1887 për të rregulluar hekurudhat shënuan fillimin e shtetit rregullator model në Sh.B.A. Ky tip rregullimi ekonomik ishte përqëndruar mbi kontrollin e liberalizimit të tregut dhe kontrollin e çmimeve. Pas hekurudhave, rregulli u shtri gradualisht edhe në transportet rrugore, shërbimet telefonike, linjat ajrore, elektricitetit, radio, televizion dhe gaz natyror.

Vetëm në vitet '60 rregullimi mori një përmasë më të gjerë duke përfshirë në objektivat e tij cilësinë e produkteve të konsumit dhe sigurinë e vendit të punës, shëndeti dhe mbrojtja e mjedisit. Ky rregullim “i ri” ose “social” i dha shkas zhvillimit të jashtëzakonshëm të aktiviteteve dhe organizmave të rregullimit. Dhe vetëm duke u nisur nga ky moment, disa karakteristika themelore të

rregullimit sipas modelit amerikan - pra një rregullim ligjor i bazuar mbi përdorimin e procedurave gjyqësore- janë zhvilluar plotësisht: ligje shumë të detajuara dhe shumë specifike; një rregullim i bazuar mbi ballafaqimin, me agjentë më të prirur për të ndërmarrë procedura gjyqësore por edhe me një liri të kufizuar vendimi; roli aktiv i gjykatave; mundësi të konsiderueshme pjesëmarrjeje për zonat joindustriale dhe mundësi e një kontrolli publik të hoëllësishëm³⁴.

Zhvillimi në rritje i rregullimit, ka shkaktuar një debat teorik shumë të pasur mbi natyrën e procesit rregullator. Fillimisht, rregullimi ishte konsideruar nga pikëpamja e perspektivës konceptuale të teorisë ekonomike normative të rregullimit. Sipas kësaj teorie, rregullimi i shërbente interesit publik, në masën ku ai u përgjigjej dështimeve objektive të tregut. Si kundërvënie me “tezën e interesit publik” teoria ekonomike pozitive e rregullimit pretendonte se rregullimi nuk i shërbente interesave publikë, por interesave privatë të caktuar. Teoria e re ekonomike pozitive e rregullimit u formulua për herë të parë në artikullin e famshëm të ekonomistit Geroges Stigler, që nisej nga shpërndarja e kostos dhe përfitimeve të rregullimit. Stigler hodhi idenë se “si rregull i përgjithshëm, rregullimi arrihet nga industria dhe ndërtohet dhe zbatohet për t’i shërbyer së pari asaj³⁵”. Rregullimi është një e mirë e kërkuar nga industria për mbrojtjen e saj. Më vonë, Peltzman, e përgjithësoi nocionin e rregullimit si një treg ku agjentët e qeverisë u shesin rregullimin firmave që e blejnë.³⁶ Me fjalë të tjera, organizmat rregullues “u kapën” nga industritë që synonin të kontrollonin në emër të interesit publik.

Këto kontribute që mbrojnë “kapjen” janë të frytshme në masën që ato tërheqin vëmendjen mbi proceset politike dhe të orientuara mbi interesat që qëndrojnë pas rregullimit. Megjithatë, teoria ekonomike e rregullimit nuk ka ditur të shpjegojë rregullimin social të viteve ’70 për të cilin nuk dimë të themi nëse mbronte interesat e ndërmarrjeve³⁷. Në masën ku kjo teori mbështetej mbi një konceptim të institucioneve politike si kuti të zeza, ajo nuk dinte të shpjegonte suksesin e programeve të çrregullimit, të nxitur nga vetë organizmat rregullues, si ishte rasti i kompanive ajrore në fillim të viteve ’70³⁸. Me sa duhet, një kuadër analitik më kompleks, do të ishte i nevojshëm për të shpjeguar skemat e ndryshme dhe rezultatet e politikave të rregullimit.

Duke u mbështetur mbi Theodore Loëi, politologu James Q. Eilson, tregoi se tipet e politikave rregullatore në të ardhmen do të vareshin nga përqëndrimi dhe shpërndarja e kostove dhe përfitimeve³⁹. Skema tradicionale shpërndarëse që teoricienët e “*captation*” kishin në kokë, - pra e përfitimeve të përqëndruara, dhe e kostove të shpërndara gjerësisht, favorizon këtë “*captation*”. Një grup i vogël ndërmarrjesh i prekur nga një organizëm rregullimi mund të tundohet fort të organizojë ose ushtrojë presione mbi këtë organizëm. Nuk është e njëjta gjë për publikun e gjerë ku kostot për person janë më të dobta. Por nëse përftimet shpërndahen gjerësisht dhe kostot përballohen nga një grup i vogël- si është rasti për pjesën më të madhe të kohës, për rregullimin social- sipërmarrësit politikë ose liderët e grupeve të interesit publik mund të përballojnë me sukses problemet e veprimit kolektiv dhe të mobilizojnë interesat e konsumatorëve.

Teoritë e “*captation*”, që përqëndrohen vetëm mbi pushtetin superior të interesave të prodhimit, nuk korrespondojnë më me politikat aktuale amerikane të rregullimit. Këto teori janë përpunuar në kontekstin e rregullimit ekonomik të epokës së *Neë Deal*. Mjedisi politik i përgjithshëm ka ndryshuar ndjeshëm që prej asaj kohe, dhe është e njëjta gjë për rregullimin ekonomik. Shumica e vëzhguesve bien dakort me faktin se grupet e interesit politik kanë ndryshuar: “Situata aktuale përcakton një varietet dhe një shumëllojshmëri më të madhe të grupve politike se sa në epokën ku është zhvilluar doktrina e “*captation*”⁴⁰». Disa zhvillime të rëndësishme në nivelin e proceseve politike i kanë paraprirë shfaqjes së një pluralizmi më të madh në proceset rregulluese: një shumëllojshmëri më e madhe mundësish aksesi në Kongres për konsumatorin, objektiva juridike më të saktë dhe një kontroll juridik i rëndësishëm.

Shtysa e rëndësishme e konsumatorëve, grupeve ekologjike, ose grupe të tjera të interesit publik dhe ndikimi i tyre mbi politikat rregulluese, kanë kundërshtuar pohimin sipas të cilit interesat e prodhuesve duhet të mbizotëronin përgjithmonë. Por, as disa aspekte të teorisë së “*captation*”, më pak të drejtuar mbi industrinë, nuk veprjnë në këtë kuadër empirik⁴¹. Një numur studimesh

kanë treguar shumëllojshmërinë e aktorëve dhe faktorëve që kishin një impakt mbi politikat rregulluese: personeli i organizmave rregullues; presidentët, komisionet e Kongresit, Gykatat, konteksti ekonomik dhe politik në përgjithësi dhe pushteti i ideve të lidhura me paradigmat e reja ekonomike. Si përfundim, dukej se kishte dalë në skenë një sistem pushtetesh dhe presionesh që shërbente si kundërpeshë.

Çfarë mund të nxjerrim nga kjo panoramë e shkurtër e procesit të rregullimit në SH.B.A.? Së pari, se as argumenti normativ i interesit publik përballë dështimeve të tregut, as teoria pozitive e kapjes e bazuar mbi mbizotërimin e prodhuesve nuk mjaftojnë për të kuptuar procesin e rregullimit në kontekstin aktual. Rregullimi nuk ka të bëjë vetëm me funksionimin efikas të tregut; ai hap gjithashtu një fushë politike të rëndësishme të lidhur me trajtimin e konflikteve të shpërndarjes dhe me ndjekjen e objektivave sociale dhe politike të formuluar nga aktorë të ndryshëm, duke përfshirë këtu vetë agjentët apo administratorët e rregullimit. Më pas, se interesat dhe aktorët që mund të ushrojnë ndikim mbi proceset dhe rezultatet e rregullimit, janë të shumtë. Nga njërë anë, në kundërshtim me atë që teoria e “**captation**” përpigëj të provonte, rregullimi publik, në të kundërt nga prona publike, nuk është në vetvete pluralist. Nga ana tjetër, rregullimi publik nuk çon në një “**captation**” nga ana e prodhuesve ose në një përforsim të të drejtave të konsumatorëve.

Si përfundim, dhe është kjo pika më e rëndësishme, natyra politike dhe rezultati i procesit të rregullimit varen kryesisht nga burimet dhe shtrëngesat institucionale specifike. Pluralizmi i zhvillimit ekonomik që vërehet sot në Sh.B.A., është në të vërtetë produkt i karakteristikave specifike (dhe aktuale) të sistemit politik amerikan. Në radhë të parë, një shkallë e lartë hapjeje, dhe një numur i madh rrugësh hyrëse në proceset e marrjes së vendimeve. Funksionimi i Kongresit, sidomos, lehtëson rolin e *policy entrepreneurs* dhe aksesin e grupeve të interesit, ndërsa vendi dhe roli i gjykatave (kontrolli i ligjeve dhe vendimeve rregulluese) të çojnë në një marrëdhënie disi formale dhe konfliktuale midis autoriteteve dhe ndërmarrjeve. Rëndësia tepër e madhe e faktorëve institucionalë që konfigurojnë natyrën e proceseve rregullues mund të ilustruhet nëpërmjet vëzhgimit apo krahasimit të modelit amerikan dhe eksperiencës britanike.

RREGULLIMI BRITANIK:

Ndryshimet e mëdha dhe trashëgimia institucionale

Në Europë, Britania e Madhe ka qenë pararendësja e pakundërshtueshme në fushën e liberalizimit, privatizimit, dhe ri-rregullimit. Nga pikëpamja formale, ai është i vetmi vend në Europë për të cilin mund të themi se një shtet rregullator i dallueshëm shumë lehtë, është zhvilluar me një turmë organizmash rregullues që mbulojnë infrastrukturën dhe shërbimet publike të liberalizuara dhe privatizuara.

Situata britanike para privatizimit mund të përmbledhet si vijon: rregullimi, në kontekstin e pronës publike, ishte realizuar nga këshilli drejtues i ndërmarrjes nën mbikqyrjen ose përgjegjësinë e ministrit. Këshilli drejtues gëzonte një autonomi substanciale për sa i përket ecurisë së përgjithshme të ndërmarrjes por shteti ndërhynte në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të përsëritur, sapo ishte fjala për financa dhe investime. Aktorët kyresorë ishin shefat e ndërmarrjeve të sektorit publik, ministria kompetente, ministria e thesarit dhe sindikatave, që gëzonin një mbrojtje të fortë dhe kishin një ndikim të konsiderueshëm.

Pas privatizimit dhe liberalizimit, një sistem i ri rregullimi u vu në zbatim, me dy aktorë të rinj: Monopolies dhe Merger Commission, (MMC), në bashkëpunim me Office of Fair Trading, autoriteti tradicional britanik i konkurrencës; dhe organizma rregullues të krijuar së fundmi”.⁴²

Organizma rregullues të një industrie të vetme u krijuan në fushën e telekomunikacionit (OFTEL), gazit (OFGAS), elektricitetit (OFFFER), ujit (OFFËAT dhe për mjedisin NRA); dhe për hekurudhat (strukturë e dyfishtë: ORR, Office of the Rail Regulator dhe OPRAF, *franchise subsidies*). Këto administrata, nuk kanë rang ministrash, drejtohen nga një drejtor i përgjithshëm i emëruar nga ministri). Ka një ndarje komplekse të përgjegjësiave midis drejtorit të përgjithshëm dhe ministrit.

Liçenca për shërbimet që do të ofrojnë, ku figurojnë të drejtat dhe detyrimet kryesore, jepet nga ministri. Detyra e rregulluesit është të zbatojë këtë liçencë në kushtet e parashikuara. Një nga instrumentat kryesorë të rregullimit të shërbimeve është vendosja e çmimeve tavan me anë të formulës RPI-x,⁴³ më tepër se rregullimi i nivelit të rendimentit që zbatohet në SH.B.A.

Me t'u dhënë liçenca, ka dy mënyra për të modifikuar kushtet. Nga njëra anë, drejtori i përgjithshëm mund të kërkojë një marrëveshje me mbajtësin e liçencës për të bërë modifikimet e nevojshme. Nga ana tjetër, nëse kjo marrëveshje nuk arrihet, drejtori i përgjithshëm mund t'i drejtohet MMC. "Por vendimet e MMC kanë vetëm vlerë këshille për ministrin, ai mund t'i pranojë ose t'i refuzojë". Tjetër skenar, secila palë mund t'i ankohet drejtësisë për tjetrin në rast dhunimi specifik të liçencës⁴⁴. Por meqë ankimi te MMC – që funksionon si një lloj gjykate apeli – e bën procedurën formale tepër të rëndë, dhe ngë fakti se amendamentet ndaj një liçence nuk mund të bëhen pa negociim me pronarin e kësaj të fundit, shumë pak raste janë drejtuar te MMC ose te gjykatat.

Por, objektivat e rregullimit dhe funksionet statutoire të drejtorit të përgjithshëm ashtu si janë shprehur respektivisht në tekstet e ligjit të Parlamentit, janë të paqarta dhe kontradiktore (një përzierje e objektivave pro-konkurrencialë me të korrigjimit të tregut) dhe mndësojnë një lloj fleksibiliteti për rregulluesin). Përveç kësaj, rregullatorët kanë lirinë e përdorimit të strategjive informale dhe të negociuara përderisa pak dispozita statutoire të përgjithshme dhe shtrëngesa procedurale, rëndojnë mbi veprimet e tyre. Përgjegjësia e tyre para parlamentit është e besueshme, (edhe pse ministri mund të imponojë linja drejtuese), rishikimi juridik është i varfër, (gjykatat nuk ndërhyjnë mbi bazat e një vendimi dhe rregullatori nuk ka detyrim statutor për të dhënë arsytet ose për të kërkuar këshilla) dhe ka pak pengesa juridike të mundshme në të kundërt me atë që përcakton në SH.B.A (*US Administrative Procedures Act*). Të gjithë faktorë që kufizojnë në sasi të konsiderueshme mundësitë e pjesëmarrjes publike në organizmat jo industrialë. Edhe nëse disa organizata konsumatorësh, (Consumer Council) specifike për një industri, u vunë në punë për të shqyrtuar ankesat dhe për të këshilluar drejtorin e përgjithshëm, përdoruesit e shërbimit publik kanë shumë pak akses formal në proceset e marrjes së vendimeve.

Si rrjedhojë, procesi i rregullimit në Britani përshkruhet si një lojë e mbyllur, lloj negociatash ose ujdish informale të përhershme midis rregullatorit dhe shërbimit të rregulluar⁴⁵ dhe ku "prodhimi i rregullave mbizotërohet nga një komunitet i mbyllur profesionistësh"⁴⁶. Kjo lojë e mbyllur e rregullimit është në natyrën britanike të fushës së rregullimit: një natyrë e mbizotëruar nga fshehtësia, jo formalizmi, besimi reciprok, radikalisht e kundërta e sistemit rregullator amerikan, shumë më i legalizuar dhe i bazuar mbi ballafaqimin⁴⁷.

Gjithsesi, kjo nuk do të thotë se nuk ka patur ndryshime radikale në administratë dhe në shërbime. Rregjimi i ri i rregullimit i zbatuar pas privatizmit, përmban në realitet elementë konvergjence me modelin amerikan që shpëputen nga disa aspekte të stilit konsensual dhe të mbyllur të politikës britanike: organizmat rregullues për një industri të vetme, të cilëve nuk u ishte kushtuar vëmendje gjatë krijimit, kanë arritur të vendosen në zemër të vetë procesit të rregullimit që karakterizohet sot nga konfrontime dhe debate publike shumë më të hapura. Në kryqëzatën që kanë nisur për "një konkurrencë më të drejtë dhe për mbrojtjen e konsumatorëve" këta rregullatorë individualë kanë shpalosur pushtetet e tyre statutoire në maksimum dhe janë angazhuar në aksione në shumë fusha, duke fituar kështu "eksperiencë, kompetencë dhe pushtet"⁴⁸.

Në këto kushte, këto skema të reje rregullatore evouluan dhe morën kuptim në një kontekst institucional më specifik. Kështu, pushteti i konsiderueshëm i rregullatorëve individualë, që punojnë për të imponuar konceptimin e tyre të qëllimeve të rregullimit, mund të dilte vetëm në një mjedis politik ku shtrëngesat dhe procedurat formale janë dobësuar shumë. Një zhvillim i tillë është vështirë të imagjinohet për sistemin amerikan, kaq shumë të "ligjzuar". Për të ilustruar rëndësinë e impaktit politik në kontekstin institucional ku ushtrohet procesi i rregullimit, do të vëzhgojmë nga afër mënyrën me të cilën organizmat rregullatore britanike trajtuan problemin e kontrollit të shërbimeve private.

Detyra e këtyre kontrolluesve, që ka ta bëjë me nxitjen e konkurrencës dhe mbrojtjen e konsumatorëve / përdoruesve në tregun e ri, u bë tepër e vështirë nga disa vendime të qeverisë tepër determinuese në

momentin e privatizimit. Struktura e tregut e krijuar nëpërmjet procesit të privatizimit, favorizon qartë interesat e monopoleve ekzistues dhe të aksionerëve, dhe nuk përmbushte kushtet për një treg potencialisht konkurrues. Në këtë mënyrë, industrinë, me përjashtim të asaj të elektricitetit, nuk janë ristrukturuar, d.m.th të shkatërroheshin para privatizimit, dhe çmimet për aktivizimin e nivelit tavan u fiksuan në nivelin fillestar, d.m.th në nivelin e ndërmarrjes së nacionalizuar⁴⁹. Si shpjegohet që një qeveri, kaq në favor të tregut, të lerë të ndodhë një gjë e tillë? Përtej arsyeve të forta ideologjike, qeveria donte që privatizimi të ishte i shpejtë dhe lançimi i veprimeve mbi shërbimet të ishte një sukses në tregun e bursës⁵⁰. Për këtë arsye, pati një konvergencë interesash midis drejtorive në fuqi dhe (aksionerëve të ardhshëm) dhe qeverisë.

Pra është e qartë se disa aksionerë të paktën nga të koalicionit të vjetër, kanë patur një ndikim jo të vogël në përcaktimin e kuadrit të ri rregullues. Kurse sindikatat, kanë humbur statusin e tyre prej të privileguari dhe në sistemin e ri, punësimi ishte shënjestra e parë për reduktimin e kostove në shërbimet e privatizuara. Duke qenë kjo situatë, ish kuadrot dhe ish shefat e ndërmarrjeve publike, u bënë shefa të fuqishëm ndërmarrjesh në sektorët privatë, (ku paguheshin më mirë) dhe mbroheshin nga interesat e qeverisë në veprimet me vlerë të madhe. Nisur nga ky moment, karteli i vjetër i prodhimit, pa të thellohen dallimet midis fituesve dhe humbësve.

Puna rregulluese bëhet më e vështirë, sa më pak konkurrese dhe më tendencioze pas privatizimit, të bëhet struktura e tregut, duke kërkuar nga ky fakt një ashpërsi dhe pushtet diskrecionar më të madh nga organizmat rregullues⁵¹. Në disa raste, marrëdhënia midis rregullatorit të industrisë dhe industrisë së rregulluar, ëshë bërë objekt përballjesh të ashpra publike, si është rasti i *British Gas*, kompani e privatizuar si një monopol i integruar, drejtoria e së cilës nuk donte të bashkëpunonte me OFGAS, organizmin rregullues. Sapo në treg u shfaqën konkurrentë të rinj, puna e rregullatorit u bë më e lehtë, përderisa ai zotëron më shumë burime informimi dhe mund të zbatojë ndaj disa kompanive strategjinë “përça dhe sundo”.

Kjo asimetri themelore e burimeve të pushtetit midis rregullatorit publik dhe kompanive të shërbimeve sigurisht nuk është specifike për kontekstin britanik. Britania e madhe nuk është i vetmi vend ku kompanitë e shërbimeve zotërojnë burime të mëdha financiare dhe organizative të rëndësishme. Megjithatë, në të kundërt me sistemin amerikan, rregullatori britanik ka pak pushtet kur duhet të detyrojë kompanitë të tregojnë llogaritë dhe regjistrat e tyre. Një vëzhgues ka vërejtur se “nga njëra anë, sistemi britanik i rregullimit të negociuar “kërkon një farë besimi midis rregullatorit dhe ndërmarrjes së rregulluar” dhe “një bashkëpunim reciprok”, por nga ana tjetër, ndërmarrjet inkurajohen pak për të bashkëpunuar prandaj “sillen si kundërshtarë të lirë në veprimet e tyre dhe maksimizues të përfitimeve individuale”⁵².

Në sistemin britanik, është e sigurt se qeveria e tanishme gëzon pushtete reale ndëhyrjeje. Një shembull i mirë për këtë është taksa unike mbi përfitimet e jashtzakonshme të kompanive të shërbimeve e mbledhur nga qeveria në vitin 1997. Duke patur parasysh këtë, në një sistem ekonomik ku shërbimet marrin formën e veprimeve në bursë, drejtoritë e ndërmarrjeve janë më të ndjeshme ndaj gjykimit të investitorëve të City dhe të tregjeve financiare, sesa ndaj konsumatorëve mbi tregun dhe prodhimet, ose ndaj interesit publik të përgjithshëm - vetëm nëse i pengon rregullatori. Përfitimet dhe investimet e huaja nëpërmjet shkrirjeve dhe riblerjeve e theksojnë këtë tendencë, duke i bërë kompanitë e shërbimit shënjestra të vështirë për t'u kontrolluar në kuadrin e një rregullimi kombëtar ose ristrukturimit të tregut të tillë që të favorizojë konkurrencën.

Kështu, bashkimi i dy karakteristikave institucionale në Britaninë e Madhe, shkakton pasoja politike të konsiderueshme: a) fakti që marrëdhëniet qeveri-ndërmarrje tradicionalisht bazohen mbi besimin dhe se qeveria kur nuk zbaton politikën e shkopit, ka pak pushtet për të kontrolluar ose ndërhyrë në menaxhimin e ndërmarrjeve, ditë pas dite, b) fakti që kompanitë e shërbimit funksionojnë gjithnjë e më tepër sipas logjikës së “vlerës së aksionariatit” tipike për tregun financiar, që i korrespondon logjikës ekonomike britanike të nxitur nga CITY.

Në këtë perspektivë, shumë vëzhgues bien dakord me faktin se, si rregull i përgjithshëm, aksionerët, dhe jo konsumatorët, janë fituesit e mëdhenj të rishpërndarjes së re të shkaktuar nga rregullimi i shërbimeve. Një vëzhgim më i hollësishëm zbulon variacione të rëndësishme: midis përdoruesve

të mëdhenj industrialë dhe përdoruesve të vegjël shtëpiakë; midis industrive të ndryshme, midis situatës fillestare dhe aktuale, ku falë një tavanizimi më strikt të çmimeve, një efikasiteti më të madh, dhe një konkurrencë më e fortë në disa sektorë industrialë, konsumatorët janë (ose do të jenë së shpejti) më mirë se më parë. Mund të themi se mesatarisht, aksionerët trajtohen më mirë se konsumatorët dhe se konsumtorët industrialë trajtohen më mirë se ata shtëpiakë.

Eksperienca britanike tregon se pasojat politike të kalimit nga prona publike në rregullimin publik, nuk u përgjigjen thjesht ligjeve universale. P.sh nuk ka rregull absolut sipas të cilit kalimi në rregullimin publik, do të rriste përfitimet e konsumatorëve në dëm të grupeve të prodhimit. Përkundrazi, proceset e rregullimit dhe rezultatet politike duhet të vëzhgohen dhe analizohen në funksion të mjedisit të tyre institucional. Në pjesën në vazhdim, do të përpiqemi të përcaktojmë cilët janë faktorët institucionalë që meritojnë një vëmendje të veçantë.

Modele konfigurimesh institucionale në politikat e rregullimit.

Për nevojat e analizës, është e arsyeshme të përqëndrohemi mbi tre faktorë institucionalë që mbështesin në formën e hipotezës, përkufizimin tonë të procesit të rregullimit në ekonomitë europiane.

ORGANIZIMI DHE KAPACITETI I SHTETIT

Ky aspekt ka të bëjë me strukturën dhe organizimin e proceseve të vendimarrjeve dhe të kontrollit të rregullimit. Ai zbatohet, veçanërisht, ndaj kapacitetit të organizmave të shtetit për të arritur objektivat e rregullimit. Në një perspektivë vertikale, analiza jonë ka të bëjë me ndarjen organizative të punës midis niveleve të ndryshme politike, dhe sidomos, midis nivelit europian dhe nivelit kombëtar. Në disa raste, niveli mbikombëtar, mund të luajë një rol të rëndësishëm, si p.sh, rregullimi i mediave në Gjermani. Kështu, struktura e administratës territoriale, (federale ose e centralizuar) ka të bëjë gjithashtu. Në një perspektivë horizontale, duhet gjithashtu, të kuptohet shpërndarja e pushteteve formale dhe ndërveprimeve informale midis aktorëve të ndryshëm publikë të angazhuar në rregullimin publik. A ka një organizëm rregullator për një industri të vetme? Në ç'mënyrë ndahen pushtetet midis ministrive, organizmave rregullues, dhe komiteteve legjislativë që mbikqyrin gjithçka? Cili është roli i autoriteteve të konkurrencës në procesin e rregullimit?

Kapaciteti i shtetit nuk varet vetëm nga organizimi i brendshëm i pushteteve publike dhe organizimit. Ai varet gjithashtu nga shtrëngesat e shumta që rëndojnë mbi ushtrimin e këtyre pushteteve. Në këtë rast, duhet të shtrojmë çështjet e mëposhtme: cilat janë kufijtë kushtetues të pushtetit diskrecionar të qeverisë në fushën e rregullimit? A veprojnë organizmat rregullatorë sipas traditës së vendosur nga e drejta publike ku gjykatat mund të rishikojnë procesin e marrjes së vendimit, si për nga forma ashtu edhe nga përmbajta?

MARRDHËNIET SHTET-SHOQËRI

Do të flasim këtu për modele të vendosura ndërveprimi midis aktorëve publikë dhe privatë ku do të zhvillohet marrdhënia midis rregullatorit publik dhe njësisë private që do t'i nënshtrohet rregullimit. Bëhet fjalë sidomos për format e ndryshme të përfaqësimit dhe ndërmjetësimit të interesave⁵³. Në disa sisteme, shteti tradicionalisht luan një rol të dorës së parë dhe zë një vend preponderues në administrimin e ekonomisë. Në Francë p.sh, vend shumë etatist, ekziston një marrëdhënie shumë e fortë midis ministrive të shtetit dhe një farë numri ndërmarrjesh të mëdha aktiviteti i të cilave ka rëndësi të madhe strategjike për politikat kombëtare. Kjo lloj marrëdhënie mund të çojë një klientelizëm sidomos për sektorët e monopolizuar tepër të mbrojtur. Në sisteme të tjera, marrëdhëniet midis aktorëve publikë dhe privatë janë dukshëm më pluralistë, por

karakterizohen gjithashtu nga ballafaqime të forta. Ashtu si e kemi parë në rastin e Sh.B.A-ve, marrdhëniet midis organizmave qeveritarë dhe ndërmarrjeve janë më formale dhe më konfliktuale njëkohësisht. Së fundmi, sisteme të tjerë ndërveprimi midis aktorëve publikë dhe privatë do të favorizojnë rregullimet korporatiste, d.m.th marrdhëniet e shkëmbimit dhe bashkëpunimit midis organizmave qeverisës, disa ndërmarrjeve dhe aktorëve të tjerë ekonomikë, më shpesh në nivelin e një sektori apo të një industrie të veçantë.

Modelet e ndërveprimit publik-privat mund të reflektojnë, në mënyrë të përgjithshme, stile të politikës nacionale, ose të kenë në brendësi norma dhe vlera kulturore, të lidhura psh, me rëndësinë relative që i jepet efikasitetit, në raport me shpërndarjen e drejtë të shërbimeve. Sistemet e besimit - të përgjithshëm ose specifikkisht politikë - ose “referencialët” sektorialë⁵⁴ që kanë të bëjnë p.sh me vlerat e zgjidhjeve politike, do të përcaktojnë karakterin e marrdhënieve rregullatore.

STRUKTURA E TREGUT

Ajo përcaktohet kryesisht nga numri dhe natyra e ndërmarrjeve dhe marrdhënieve që ato ndërtojnë me njëra-tjetrën. Së pari, është e qartë se puna e rregullimit në një treg ku ka një farë konkurrence dhe ku rregullatori nuk do të ndeshet me një monopol të vetëm, do të jetë më e lehtë. Ky rregullator do të zotërojë burime të ndryshme informimi dhe mund të përdorë kompanitë.

Por struktura e tregut sektorial do të konfigurohet gjithashtu nga shkalla e ekspozimit ndaj forcave të tregut ndërkombëtar. Në planin e rregullimit kombëtar, nëse sektori përbëhet nga një lojtar i madh ndërkombëtar, pozicioni i saj, në krahasim me atë të situatës së ndërmarrjeve ku veprimet kufizohen nga tregu i brendshëm, nuk do të jetë i njëjti. Element tjetër që bën gjithashtu pjesë në çështjet e rrahura kohët e fundit mbi konkurrencën rregullatore⁵⁵: nëse operatori i vjetër kombëtar, mund të kërcënojë, në mënyrë të besueshme, se disa pjesë të çështjes së tij do t'i transferojë tek juridiksionet ku shtrëngesat e rregullimit janë më të vogla, ai mund të bëjë presion për të liruar darën e rregullimit kombëtar. (është efekti i famshëm “Delaçare”)

Së fundmi, teknologjia, ose shpejtësia e ndryshimeve teknike do të luajë rol të rëndësishëm në përcaktimin e strukturës së tregut. Disa shërbime si uji, paraqesin karakteristika të forta të monopoleve natyrore. (që nga sigurimi, shpërndarja, furnizimi). Nga ana tjetër, për sa i përket telekomunikacionit, ndryshimet teknologjike kanë qenë të tilla sa që – me shfaqjen e rrjeteve të reja të telekomunikacionit- (celularë, internet, dhe madje rrjete elektrike), karakteristikat e monopolit natyror janë ose do të jenë së shpejti të vjetra.

Këta tre faktorë shpjegojnë variacionet institucionale, në fushën e ri-rregullimit. Variacionet ose kontingjencat institucionale përmbledhin dy dimensione: së pari dimensionin kombëtar. Kjo është veçanërisht e vërtetë për faktorin e parë, kapaciteti i shtetit, por edhe ndryshimet nacionale mund të jenë të rëndësishme në nivelin e marrdhënieve shtet-shoqëri, dhe në një masë më të vogël, në nivelin e strukturës së tregut. Dimensionin e dytë është ai i variacioneve sektoriale dhe ka të bëjë kryesisht me të gjitha strukturat e tregut, por edhe me marrdhëniet shtet-shoqëri që mund të variojnë në funksion të disa karakteristikave sektoriale. Si rrjedhim, disa karakteristika sektoriale specifike, për.shembull agrikultura mund të ndikojnë mbi aftësinë e shtetit.

SI ËSHTË GJENDJA NË EUROPE?

Rregullimi në shumë nivele

Qasja komparativiste e disa organizatave sektoriale dhe kombëtare, nuk duhet të maskojë faktin se modelet e rregullimit kombëtar nuk mund të analizoheshin pavarësisht nga sistemi i qeverisjes europiane me shumë nivele. Në këtë kontekst të përgjithshëm ku shtet-kombi është vënë në diskutim- njëherazi si sovranitet territorial dhe si kuadër analize-ideja e mbrojtur nga Majone

sipas të cilës shteti rregullator do të jetë më tepër një shtet europian sesa një shtet-komb, nuk mund të rrokej kaq lehtë nga kërkitimi krahasues. Në të kundërt, kjo ide duhet të trajtohet si një pyetje empirike e hapur drejt mënyrës se si do të reagojnë midis tyre rregullimet e ndryshme në nivelin kombëtar dhe europian dhe cilat do të jenë pasojat. Në këto kushte, edhe pse marrin pjesë në ndërtesën e madhe europiane, karakteristikat institucionale kombëtare, mbeten gjithsesi variabla të rëndësishëm.

Gjatë analizës së eksperiencës britanike, nuk e trajtuam dimensionin vertikal – europian- të rregullimit, sepse privatizimi britanik dhe politikat e ri-rregullimit i kanë paraprirë me kohë zhvillimeve në nivelin europian, ose “në shumicën e rasteve, kanë ecur në një hap me Komunitetin”⁵⁶. Në fakt, Komisioni Europian, nuk e ka vënë më në diskutim, që prej një kohe të gjatë, sigurimin tradicional të shërbimeve publikë nga monopolet e mbrojtura. Në vitet ’80 dhe ’90 kjo gjëndje ndryshoi radikalisht dhe liberalizimi i shërbimeve publike në shkallë europiane dalin në plan të parë të programit politik të Komunitetit⁵⁷. Një debat i plotë mbi efektet reciproke të rregullimeve kombëtare do të tejkalonte kuadrin e artikullit tonë. Do të mjaftohemi me zhvillimin shkurtimisht të pikave në vazhdim.

Nëse ligji dhe politika europiane ndaj konkurrencës mbështjellin në mënyrë substanciale hapësirën dhe politikat kombëtare në fushën e rregullimit të tregut, ato nuk zëvendësojnë as përcaktojnë plotësisht qasjet e ndryshme kombëtare të rregullimit. Së pari, rregullatorët europianë duhet të lënë në duart e shteteve antarë transferimin e direktivave në juridiksione të ndryshme kombëtare dhe të mbikqyrë zbatimin e tyre. Në këtë mënyrë, rregullimi do të zbatohet në kuadrin specifik të rregullimeve të ndryshme kombëtare. Më pas nuk ka asnjë centralizim të funksioneve rregullatore në nivel europian dhe pa dyshim nuk do të ketë kurrë. Parimi i njohjes reciproke favorizon më tepër “funksionimin dhe pasojën paralele të rregullimeve *mbinacionale, nacionale dhe subnacionale*”⁵⁸ gjë që lë një hapësirë diskrecionare të rëndësishme. McGoëan dhe Eallace hodhën hipotezën se një lloj ndarjeje e punës midis rregullatorëve kombëtarë dhe europianë do të organizohet në të ardhmen: rregullatorët kombëtarë do të merren drejtpërdrejt me kompanitë dhe qytetarët, ndërsa rregullatorët europianë do të kenë për detyrë rregullimin e rregullatorëve kombëtarë⁵⁹.

Cilat janë pasojat politike të këtij rregullimi me shumë nivele? Së pari, ai mund të hapë rrugë të reja për përfaqësimin e interesave. Ata që janë humbës në nivelin e ngushtë, mund të përmirësojnë pozicionin e tyre në një nivel më të gjerë. Më pas sistemi i BE-së, më i fragmentuar dhe pluralist, mund të jetë më pak pre e “**captations**” – që do t’i shërbenin esencialisht interesave të prodhimit-se sa sistemi kombëtar tradicional. Interesat e prodhimit, në shumë raste, janë kundërbalancuar nga interesat e konsumatorëve dhe nga interesa të tjera (mjedisore)⁶⁰. Por – dhe është një pikë thelbësore- konteksti politik europian ofron një forum shtesë dhe fut një aktor të ri në debatin mbi interesin publik në rregullimin e tregut. Kjo mund të lejojë një prejre shkurt të konfliktit midis, nga njëra anë, “tregëtizimit” të shërbimeve dhe nga ana tjetër mbrojtjes së “shërbimeve kryesore” dhe të drejtave të qytetarit.

Në mesin e viteve ’90, debati politik europian përqëndrohej kryesisht mbi nevojën dhe përfitimet e liberalizimit të tregut në shërbimet publike sipas logjikës së “integrit negativ”⁶¹. Megjithatë sa më shumë përparon logjika e tregut të hapur tipike për integrimin negativ, drejt zemrës së shërbimeve publike, aq më shumë përballlet me një rezistencë të fortë politike⁶². Po kështu, lëvizja e liberalizimit balancohet gjithnjë e më shumë nga pranimi se vlera të tjera sociale, përtej konkurrencës duhet të merren parasysh dhe duhen mbrojtur, dhe se mund të imponojmë për shembull disa detyrime të shërbimit publik⁶³. Shumë vendime të gjykatës europiane të bëjnë të mendosh se në fushën juridike, parimi i konkurrencës plotësohet progresivisht dhe kundërbalancohet nga një trup i dytë juridik që e vë theksin mbi vlera të tjerë sociale si ndershmëria (drejtësia) ndërzonale në një kontekst kombëtar. Por, klauzola e re e traktatit të Amsterdimit për sa i përket rolit legjitim “të shërbimeve me interes ekonomik të përgjithshëm” sinjalon, pa i ngritur pengesa formale logjikës së integrit negativ, se duhet t’i jepej më shumë peshë qëllimeve të ndjekur nga misionet e shërbimit publik⁶⁴.

Si përfundim, modelet institucionale dhe tendencat politike, europiane dhe kombëtare, ndërfiten

në mënyra të ndryshme në procesin e rregullimit të tregut. Të dy nivelet – dhe ndërveprimet që organizohen rreth tyre, duhet të merren parasysh kur studiohet shteti rregullator në Europë. Në këtë perspektivë më të gjerë, çfarë drejtimi mund të marrë kërkimi empirik që ka për qëllim të eksplorojë variacionet institucionale të “ngjitjes së shtetit rregullator në Europë”? Përçapja e parë logjike do të ishte të identifikoheshin dhe të mblidheshin të gjithë tipet e infrastrukturave dhe të shërbimeve publike në Europë që janë privatizuar ose liberalizuar, pastaj janë ri-rregulluar. Nuk bëhet fjalë për një kusht pa interes meqë, nga shumë këndvështrime, ky proces sapo ka filluar. Nëse në telekomunikacione dhe në transportet ajrore, procesi i liberalizimit ka filluar në shumë vende, ai është ende në hapat e parë për gazin dhe elektricitetin. Britania e Madhe, është i vetmi vend në Europë ku procesi i liberalizimit ka prekur tashmë të gjithë tipet e shërbimeve publike. Si rrjedhim, detyra e parë do të ishte të bëhej një bilanc i saktë i procesit të liberalizimit dhe ri-rregullimit në sektorë të ndryshëm dhe në vende të ndryshme. Kjo përçapje do të na lejonte të kishim një bashkësi rastesh për një studim të ri-rregullimit. Përzgjedhja e rasteve, logjikisht, duhet të drejtohet nga hipoteza teorike e variacionit ndërsektorial dhe ndërkombëtar. Të gjitha konfigurimet institucionale të mundshme (d.m.th të gjithë kombinimet e faktorëve të zhvilluar më lart, duke futur këtu edhe llojet e ndryshme të ndërveprimit të niveleve të ndryshëm në Europë) duhet të ishin raste, idealisht flasim. Bashkësitë institucionale mund të ishin sistematikisht të lidhura me rregjime rregullues specifike dhe me performancën e tyre. Sigurisht, duke parë numrin e rasteve të mundshëm, do të ishte një detyrë e vështirë. Megjithatë, është koha të shkohet përtej studimit të këtyre rasteve që shpesh përqëndrohen në sektorë të veçantë si telekomunikacioni dhe prirjen të neglizhohen variacionet e mëdha në treg dhe në dinamikën teknologjike në nivelin e tre fushave infrastrukturore, pra komunikacioni, transporti dhe furnizimet.

Vala a tretë e studimeve të ekonomisë politike

Studimi i shtetit rregullator në Europë mund të shihet si një valë e tretë zhvillimi në studimet e fundit në ekonominë politike europiane. Periudha e parë përqëndrohej mbi çështjen e të diturit përse, në fillim të viteve '70, u zhvillua një lëvizje e fortë “tregëzimi” në forma të ndryshme – veçanërisht liberalizim dhe privatizim- në vendet e OCDE. Në periudhën e dytë, në fillim të viteve '90, kërkuesit u përballën me paradoksin e ri-rregullimit: përse, ndërsa duhet të kishte ndodhur tërheqja e shtetit, qeveritë filluan të rregullonin sektorët ekonomikë që i kishin liberalizuar fillimisht? Këto dy pyetje i shtynë shkencëtarët të kërkojnë faktorë të përbashkët për kontekste të ndryshme që të mund të shpjegonin a) shtysën drejt “tregëzimit” b) nevojën ose dëshirën për të ri-rregulluar. Me një fjalë, kërkimi ishte orientuar mbi konvergencën. Në fund të viteve '90, shohim të profilizohet një periudhë e tretë kërkimesh empirike dhe teorike në të cilën qasja duhet zhvendosur nga konvergjenca drejt kontigjencave dhe variacioneve institucionale. Nëse duam të kuptojmë më mirë arkitekturën, mekanizmat dhe pasojat politike të shtetit rregullator, që sapo ka filluar të shfaqet në ekonominë politike europiane, na duhet të studiojmë me kujdes rolin dhe kontekstet institucionale specifike në të cilat zenë vend proceset e rregullimit.

Përgatiti: Blerta Hyska

¹Giandomenico Majone « From the positive to the Regulatory State : causes and consequences of changes in the Mode of Governance » *Journal of Public Policy*, 17 (2) 1997, f. 139-167.

²Për një pikëpamje të përgjithshme mbi këtë subjekt, cf. Giandomenico Majone: *Communaute Européenne: un Etat regulateur*, Paris, Montchrestien, 1996.

³Wolfgang Muller, Vincent Éright (eds) *The State in Western Europe, retreat or redefinition?* numur special i *West European Poilitcis*, 17 (3) 1994.

⁴Suzanne Lutz « The revival of the Nation State ? Stock exchange regulation in an aera of Globalized Financial Markets » *Journal of European Public Policy*, 5(1), 1998, f. 153-168.

⁵Mark Thatcher « Regulatory Reform in Britain and France : organizational structure and the extension of competition » *Journal of European Public Policy*, 15(3), 1994, f. 441-464.

⁶Steven K. Vogel, *Freer Markets, More Rules : Regulatory Reform In Advanced Industries Countries*, Ithaca, Cornell University Press, 1996.

⁷Ira Denakaus, Volker Schneider, “The Privatization of Infrastructures in Germany” in Jan Erik Lane (ed), *Public Sector Reform: Rationale, Trends and Problems*, Londres, Sage, 1997, f. 64-113 (66)

- ⁸William S. Sharkey *The Theory of Natural Monopoly*, Cambridge, Mass, Cambridge University Press, 1982.
- ⁹Charles B. Blankart, Gunter Knieps, "Netzökonomik" *Jahrbuch für Neue Politische Ökonomie*, 11 (3), 199, f. 73-87.
- ¹⁰Kjo ide e ka burimin e saj në konceptin ekonomik të contestable markets. Cf. Èilliam Baumol, (ed) *Contestable Markets and the Theory of Industrial Structure*, Neë York, Harcourt Brace Jovanovich, 1982.
- ¹¹Për një vështrim të përgjithshëm mbi këtë koncept, cf. Barry. M. Mitnick, *The political economy of Regulation, Creating, Designing, Removing Regulatory Reforms*, Neë York, Columbia, University Press, 1980.
- ¹²Robert Boyer, *Teoria e rregullimit*, Paris, La decouverte, 1987.
- ¹³Kenneth Dyson « Theories of regulation and the Case of Germany » in Kenneth Dyson, *The politics of German Regulation*, Aldershot, Dartmouth, 1992, f. 1-28.
- ¹⁴Leigh Hancher, Michael Moran "Organizing regulatory space" in Leigh Hancher, Michael Moran, *Capitalism, Culture and Economic Regulation*, Oxford, Clarendon Press, 1989, f. 271-299.
- ¹⁵Barry M. Mitnick, *The political economy of Regulation*, f. 7, dhe Alfred E. Kahn, *The Economics of Regulation: principles and institutions*, 1971.
- ¹⁶Roger G. Noll "Government Regulatory Behavior a Multidisciplinary Survey and Synthesis" në Roger G. Noll *Regulatory Policy and the Social Sciences*, Berkeley University of California Press, f. 9-63
- ¹⁷Philip Selznick "Focusing Organizational Research on Regulation" në Roger G. Noll *Regulatory policy and the social sciences*, f. 363-367. Philip Selznick, cituar f. 364.
- ¹⁸Për një qasje më të plotë, cf. G. Majone, *La Communaute Europeenne un Etat Regulateur?*
- ¹⁹G. Majone, « From the positive to the regulatory state », art. Cit f. 139-167.
- ²⁰G. Majone "Cross National Sources of Regulatory Policy Making in Europe and the United States" *Journal of Public Policy*, 11, 1991, f. 79-106.
- ²¹G. Majone, *The development of social regulation in the European Community: policy externalities, Transaction Costs, Motivational Factors*, EUI, Working Paper SPS N. 95/2, Florence, European University Institute, 1995.
- ²²G. Majone, *Controlling Regulatory Bureaucracies: lessons from the American experience*, EUI Working Paper, SPS N. 93/3, Florence European University Institute, 1993, f. 28.
- ²³G. Majone, *Independence vs. Accountability? Non Majoritarian Institution and Democratic Government in Europe* EUI, Working Paper, SPS N. 94/3, Florence European University Institute. 1994, f. 23.
- ²⁴James A. Caporaso, "The European Union and the Forms of State: Westphalian, Regulatory or Post-Modern?" *Journal of Common Market Studies*, 34 (1), 1996, f. 29-52.
- ²⁵Brian Levy, Pablo T. Spubler, "A framework for Resolving the Regulatory Problem" in Brian Levy, Pablo Spubler, *Regulations, Institutions and Commitment, Comparative Studies of Telecommunications*, Cambridge, Cambridge University Press, 1996, f. 1-35.
- ²⁶Marc A. Eisner (ed) "Crossing the Organizational Void: the Limits of Agency Theory in the Analysis of Regulatory Control", *Governance*, 9 (4), f. 407-428.
- ²⁷Andrew Dilnot, Dieter Helm, "Energy policy, Merit Goods, and Social Security" in Dieter Helm (ed) *The Market for Energy*, Oxford, Clarendon Press, 1989, f. 55-73.
- ²⁸John Ernst, *Whose Utility? The social impact of public utility privatization and regulation in Britain*, Milton, Open University Press, 1994.
- ²⁹Martin Shapiro *Who Guards the Guardians? The Judicial Control of Administration*, Athens, Georgia, University of Georgia Press, 1998.
- ³⁰G. Majone "From the positive to the regulatory state" art. Cit dhe Frans van Waarden, "More Market, Less Rules"?
- ³¹G. Majone "From the positive to the regulatory state" art. Cit f. 149.
- ³²Morton Keller "The pluralist State: American Economic Regulation in Comparative Perspective, (1900-1930)" in Thomas K. McCraw ed *Regulation in Perspective*, Cambridge, Harvard University Press, 1981, f. 56-94.
- ³³David Vogel, *National styles of Regulation, Environmental Policy in Great Britain and the United States*, Ithaca, Cornell University Press, 1986, f. 241
- ³⁴George J. Stigler "The Theory of Economics Regulation" *Bell journal of economics and management science*, 1971, f. 1-21.
- ³⁵Sam Peltzman "Toward a More General Theory of Regulation" *Journal of Law and Economics*, 19, f. 211-240, 1976.
- ³⁶Graham K. Wilson "Social Regulation and Explanation of Regulatory Failure" *Political Studies*, 32, f. 203-205, 1984.
- ³⁷Martha Derthick, Paul J. Quirk *The politics of Deregulation*, Washington, The Brookings Institution, 1995.
- ³⁸James Q. Wilson, "The politics of Regulation" in James Q. Wilson (ed) *The politics of regulation*, New York, Basic Books, 1980, f. 57-394.
- ³⁹Michael D. Reagan, *Regulation, The Politics of Policy*, Boston Little Broën, 1987, f. 64.
- ⁴⁰C. f William T. Gormley, "A test of the Revolving Door Hypothesis at the FCC" *American Journal of Political Science*, 23, 1979, f. 665-683.
- ⁴¹Paul J. Quirk, *Industry Influence in Federal Regulatory Agencies*, Princeton, Princeton University Press, 1981.
- ⁴²Për një qasje të sistemit britanik të rregullimit, cf. Mark Thatcher "Institutions regulations and change: New Regulatory Agencies in the British Utilities", *West European Policies*, 21 (1).
- ⁴³RPI korrespondon me Retail Price Index, index i çmimeve të detajit. Procedohet me një tavanizim të çmimeve me x për qind për vit në tërma realë. X korrespondon me parashikimin e rregullatorit për sa i përket lëvizjes së produktivitetit dhe kostove në një industri të dhënë. Faktori X është i fiksuar paraprakisht për një kohëzgjatje prej 4 ose 5 vjetësh.
- ⁴⁴Mathew Bishop, John Kay, Colin Mayer "Introduction" in Mattheë Bishop, John Kay, Colin Mayer (eds) *The regulatory Challenge*, Oxford, Oxford University Press, 1995.
- ⁴⁵Cento Veljanovski "The regulation Game" in Cento Veljanovski, ed, *Regulators and the Market. An Assesment of the Growth of regulation in the UK, Londres, The institution of Economic Affairs*, 1991, f. 3-28.
- ⁴⁶Abigail Melville "Power Strategy and Games: Economic Regulation of a
- ⁴⁷Privateized Utility" *Public Administration*, 72, 1994, f.385-408.
- David Vogel, *National Styles of Regulation...* op. cit.
- ⁴⁸Mark Thatcher "Institutions Regulation and Change..." art. cit. f. 128.
- Matthew Bishop, John Kay, Colin Mayer "Introduction", cit.
- ⁴⁹Jeremy J. Richardson "The politics and Practice of Privatization in Britain" in Vincent Èright (ed) *Privatization in Èestern Europe...* op. cit.
- ⁵⁰Cento Veljanovski "The regulation Game" cituar. f. 22.
- Stephen Wilks "The Amoral Corporation and British Utility Regulation" *Neë Political Economy*, (2) 1997, f. 279-298
- ⁵¹Për sa i përket debatit francez në këtë pikë, cf. Bruno Jobert, Pierre Muller, *L'Etat en action*, Paris, PUF, 1987.

⁵²Mbi nocionin e « referenietel » sektoral c.f. Pierre Muller, *Les Politiques Publiques*, Paris, PUF, 1994, f. 42- 49.

⁵³Francis McGowan, Paul Seabright, « Regulation in the European Community and its impact on the UK » in Matthew Bishop, John Kay, Colin Mayer, *The regulatory challenge*, op. cit, f. 227-253.

⁵⁴Cf. Susanne K. Schmidt " Commission Activism: Subsuming telecommunications and electricity under European Competition Law". *Journal of European Public Policy*. (5), 1998, f. 169-184.

⁵⁵Ian Beg, "Introduction" i numrit special *Regulation in the European Union*, *Journal of European Public Policy*, op. cit, f. 525-535.

⁵⁶Francis McGowan, Helen Wallace, " Toward European Regulatory State", *Journal of European Public Policy*, 1996, f. 560-576.

⁵⁷Për dallimin midis integrit negative dhe integrit pozitiv, c.f. Fritz W. Scharp, "Negative and positive integration in the Political Economy Welfare States", in Gary Marks (ed) *Governance in the European Union*.

⁵⁸Fritz. W. Scharp " Demokratische politik in der internationalisierten Ökonomie"

⁵⁹Colin Scott, " Changing Patterns of European Community Utilities Law and Policy". *An institutional Hypothesis*" in Jo Shae, Gillian More, Neë *Legal Dynamics of European Union*, Oxford, Clarendon Press, 1995, f. 193-215.

⁶⁰Fritz W. Scharp *Balancing Positive and negative integration: the Regulatory Options for Europe*, Working Paper, 97/8 MPLfG, Max Planck Institute for the Study of Societies, November 1997, f. 4.

ADMINISTRIMI I EKSTERNALITETEVE MIDIS SHTETIT DHE TREGUT.

NGA DR.FATMIR GURI¹

ABSTRAKT. *Eksternalitetet janë fenomene ekonomike të cilët janë trajtuar gjerësisht në gjysmën e dytë të shekullit të XXI. Me anashkalimin e tregut ato ngrinin jo vetëm çështjen e zgjidhjes së tyre por atë të institucioneve të cilat duhet të meren me këtë zhvillimin, duhet të jenë institucionet shtetërore apo tregu që duhet të luajnë rrolin e rregullatorit. Akoma dhe më gjerë cilat janë elementët e analizës që na ofrojnë të dy këto qëndrime të larguara nga njëri-tjetri. Problemet e eksternaliteteve mjedisore na ofrojnë gjatë njëzet viteve të fundit një fushë të gjerë reflektimi dhe analize intensive ekonomike.*

I.HYRJJE

Liria e tregjeve është një ndër tezat që kanë shoqëruar zhvillimin e mendimit ekonomik. Që në shekullin e XVII-të fiziokratët vunë në pikëpyetje rrolin e shtetit në zhvillimin e ekonomisë dhe pohuan se tregu është i aftë që të zhvillojë ekonominë pa patur nevojë për ndërhyrjen e shtetit (Denis, 2000). Kjo tezë e cila ka qenë qëndrore përgjatë zhvillimit të ekonomisë deri në ditët e sotme. Me forcimin e analizës ekonomike dhe unifikimin e mendimeve shkencore rreth fenomeneve ekonomike, egzistenca e domosdoshmërisë së institucioneve qeveritare nuk vihet më në dyshim, megjithëse, rëndësia e ndërhyrjes së qeverisë është akoma një debat i rëndësishëm në rrethet e analizës ekonomike.

Një ndër arsëyet për të cilat u pa se ishte e nevojshme ndërhyrja e shtetit ishte i lidhur me funksionet që institucionet shtetërore duhet të luajnë për rregullimin e eksternaliteteve si një element i rëndësishëm keq funksionimit të tregut (Mayeres, Prost, 98), (Henderson, 99), (Dur, Roelfsema, 2004). Eksternalitetet të cilat janë të pranishme në shumë fusha të aktivitetit ekonomik janë kosto apo përfitime të papaguara nga ai i cili i shkakton këto kosto apo përfitime. Nga vetë emri eksternalitetet janë funksione ekonomike të cilat kalojnë jashtë tregut dhe si të tilla nuk mund të rregullohen nga mekanizmat e tregut. Studimi i eksternaliteteve është një temë kryesore e shekullit të XXI-të me qëllim jo vetëm integrimin e këtyre kostove dhe përfitimeve në bilancin e firmave, por akoma më gjerë që nëpërmjet këtij fenomeni ekonomik të rihidhet në diskutim një koncept i rëndësishëm : ai i rolit të institucioneve në përgjithësi dhe të shtetit në mënyrë të veçantë në rregullimin e problemeve të cilët nuk mundën që të rregullohen në mënyrë automatike nga tregu.

Ritja dhe zhvillimi i shqetësimit mjedisor në rrethet ekonomike në fillim në kuadrin e mirë administrimit të burimeve natyrore (analiza e Klubit të Romës në mesin e viteve '50), por gjithashtu më vonë në kërkuesin për përmirësimin e e analizës që studion proceset mjedisore që nuk shohin më përballë dy aktorë individualë ekonomikë por një apo një grup aktorësh ekonomikë dhe shoqërinë si një e tërë, ka çuar në zhvillimin e analizës në eksternaliteteve, sepse siç shprehet David Pearce :

¹Autori është pedagog në Universitetin Bujqësor të Tiranës

« Nuk ka ekonomi mjedisore pa egzistencën e eksternaliteteve », pra janë këto të fundit të cilat qëndrojnë në bazën e një dege të ekonomisë për të cilën diskutohet kaq shumë në ditët e sotme.

Ky artikull ka si qëllim të paraqesë në mënyrë të shkurtër se cilat janë rrugët kryesore të rregullimit të eksternaliteteve, si edhe se cilat janë pikat e forta dhe të dobta të secilës prej kësaj mënyre veprimi, nga ana tjetër, në analizën tonë një element i rëndësishëm do të jetë edhe roli i inistitucioneve në përgjithësi në administrimin dhe rregullimin e eksternaliteteve, dhe në mënyrë të veçantë të rolit të shtetit. Artikulli është i organizuar në disa pjesë kryesore : Në pjesën e parë bëhet një prezantim i shkurtër të konceptit të eksternaliteteve, të karakteristikave të eksternaliteteve, të përbashkëtat dhe dallimet midis të mirave publike dhe eksternaliteteve, në pjesën e dytë shihen se cilat kanë qenë mënyrat kryesore të administrimin dhe rregullimin e eksternaliteteve në një ekonomi, dhe pjesa e fundit bëhet një analizë e pikave të forta dhe të dobta të secilës prej këtyre strategjive të veprimit duke kuptuar se cila është më e përshtatëshme në kushtet praktike dhe pse.

II.EKSTERNALITETET SI NJË FENOMEN EKONOMIK I CILI NUK MUNDET QË TË RREGULLOHET NGA TREGU.

Megjithëse rryma të ndryshme të ekonomisë nuk bien dakord rreth mënyrës se si duhet të administrohen eksternalitetet ato janë të të njëjtit mendim rreth asaj që këto të fundit paraqesin. Për ekonominë standarde, eksternalitetet janë kosto ose përfitime të papaguara të cilat nuk figurojnë në bilancin e firmës (Ju, Borm 2005). Për të qenë më praktik marim një shembull i cili përbën një ndër shembujt më të analizuar dhe klasik në hitorinë e analizës ekonomike. Supozojmë se në një lum janë të vendosur sipas rrjedhës së tij njëra pas tjetrës tre firma të ndryshme ndër të cilat e para është një firmë e prodhimit të çelikut, e dyta një firmë e cila prodhon birrë dhe e treta një kooperativë peshkimi. Firma e çelikut derdh në lum ujrat e përdorura në procesin e saj të prodhimit të cilat janë të ndotura, dhe janë këto ujra që do të përoren më poshtë në lum nga firma e prodhimit të birrës e cila nuk mundet më ti përdorë këto ujra sepse janë të ndotura duke përbërë kështu një eksternalitet negativ, nga ana tjetër firma e birrës derdh ujin me malto duke rritur kështu popullatën e peshqve dhe të ardhurat për kooperativën e peshkimit duke përbërë kështu një eksternalitet pozitiv.

Pra eksternalitetet janë fenomene të cilat janë pozitive dhe negative, që janë të matëshme sepse ne e dimë ose mund ta llogaritim dëmin që i shkakton firma e çelikut firmës së birrës (shumë kjo e barabartë me shpenzimet që duhet të kryhen për të filtruar ujin), kurse vlera e eksternalitetit pozitiv mundet që të llogariten nëpërmjet diferencës në zënieën e peshkut para apo pas lëshimit të ujit me malto në lum. Fakti që eksternalitetet janë të matëshme përbën një ndër elementët pozitivë të këtyre fenomeneve sepse ato mund të llogaritet efekti i tyre. Nga ana tjetër eksternalitetet nga shumë ekonomistë paraqiten si raste të veçanta të të mirave publike, por në ndryshim nga të mirat publike të cilat kanë si objekt final prodhimin e një të mire apo shërbimi i cili ruan karakteristika të veçanta të identifikuara qartë nga ekonomistët. Eksternalitetet në ndryshim nga të mirat publike nuk janë objektivi final i aktivitetit të një aktori ekonomik por rrjedhim i aktiviteti ekonomik të këtij të fundit (Pearce, Turner, 1991). Kështu pra në kushtet e mungesës së strategjive të rregullimit të eksternaliteteve, tregjet deformohen akoma dhe më shumë nga shpërndarja e padrejtë e kostove të disa aktorëve ekonomikë drejt aktorëve të tjerë.

III. STRATEGJITË E RREGULLIMIT TË EKSTERNALITETEVE, MES ROLIT TË SHTETIT DHE ATIJ TË TREGUT.

Strategjitë e rregullimit të eksternaliteteve kanë qenë objekt debatesh midis ekonomistësh të ndritur të shekullit të XXI-të. Ato nuk kishin të bënin vetëm dhe ekskluzivisht me rregullimin e këtij fenomeni i cili është aq i përhapur, por akoma më shumë për të kuptuar se cili është realisht roli i shtetit në rastet kur tregu në mënyrë automatike nuk arrin që të rregullojë këto probleme.

Teoria ekonomike njih tre rryma kryesore përsa i përket rregullimit të eksternaliteteve (Ju, Borm 2005) : Metoda e taksimit optimal e përpunuar në fillimin e viteve '20 të shekullit të shkruar nga ekonomisti anglez Pigou, i cili konceptualisht mendon se roli i shtetit është i domosdoshëm në rregullimin e eksternaliteteve dhe se ne mundemi që të arrijmë në nivele optimale të rregullimit të këtij fenomeni nëpërmjet aplikimit të një takse (Pigou, 1920), e cila do të mundet që të ulë funksionin e prodhimit të firmës që prodhon eksternalitete në nivel të tillës sa që niveli optimal i prodhimit të saj të barazohet me nivelin optimal të prodhimit të eksternalitetit. Metoda e taksimit optimal e cila bazohet në përcaktimin e qartë të interseksionit midis funksionit të të ardhurave marxhinale dhe të kostove marxhinale të eksternalitetit, nisat nga një supozim sipas të cilit autoriteti shtetëror i cili është edhe ai taksues, ka një informacion të plotë rreth këtyre dy funksioneve dhe arrin që në çfarëdo momenti të jetë i aftë që të axhustojë taksën nëse funksionet bazë ndryshojnë. Kjo mënyrë veprimi mbështetet në institucione të forta shtetërore të cilat duhet të kryejnë rolin e supervisorit të një tregu të caktuar, me qëllim rregullimin e eksternaliteteve nëpërmjet ndërhyrjes nga jashtë. Kjo mënyrë veprimi mbetet një referencë e përhapur dhe e përdorur në një sërë vendesh kryesisht në rregullimin e kostove mjedisore të cilat vijnë si pasojë e eksternaliteteve të cilat nuk mundën që të rregullohen nga tregu.

Por a mund të mendojmë ne se në një moment të caktuar, institucionet shtetërore të cilat janë ato që mendojnë dhe aplikojnë taksën, kanë një informacion të plotë rreth nivelit të eksternalitetit që shkakton një firmë e caktuar ndaj një firme tjetër apo akoma më shumë një firmë ndaj shoqërisë ? Për të qenë më kërkues në analizën tonë a mundemi ne të mendojmë se edhe nëse ky informacion egziston në një moment ai mundet që të jetë i vazhdueshëm, duke reflektuar në nivelin e taksës ndryshimet që ndodhin si në funksionet e të ardhurave marxhinale ashtu edhe në ato të kostove marxhinale ? Për të qenë koherent me teorinë ekonomike duhet të themi se jo. Tashmë është e konsoliduar rruga e cila mendon se aktorët ekonomikë veprojnë në kushtet e një informacioni të pjesshëm dhe se është shumë e vështirë që aktorët të njohin në mënyrë të plotë nivelin e informacionit që qarkullon në një marëveshje ekonomike.

Në këto kushte, roli i shtetit vihet në dyshim ndaj edhe autorët të cilët dyshonin në efikasitetin e institucioneve taksapaguese, u mbështetën në metodën e rregullimit të eksternaliteteve të propozuar nga Coase(1960) i cili mendon se në kushtet e mungesës së kostove të transaksionit dhe të përcaktimit të qartë të drejtave të pronësisë, tregu nuk ka nevojë për ndërhyrje nga jashtë, ai arrin që të rregullojë eksternalitetet në mënyrë automatike. Kjo metodë e cila ndërtohet në eksternalitete të cilat janë përcaktuara qartë në kohë dhe hapësirë dhe jo për eksternalitete funksioni i të cilave nuk është kaq pikësor (mundemi të krahasojmë një ndotje të grupuar nga një ndotje e cila është e përhapur), mbështetet në idenë se zgjidhja e efekteve negative të eksternaliteteve mund të arrihet nëpërmjet një marëveshje midis atyre që kryejnë eksternalitetet dhe atyre që i pësojnë këto të fundit, ku fakti se cili prej tyre i ka të drejtat e pronësisë dhe cila është diferenca midis nivelit të fitimit (apo kostos) që do të kishin, me shumën që do të paguanin, arrijnë të përcaktojnë shumën që do ti jepnin zotëruesit të të drejtës së pronësisë pala tjetër dhe do të stabilizonin prodhimin në nivelin optimal. Është e rëndësishme të theksohet se pavarësisht nëse të drejtat e pronësisë zotërohen nga ai që shkakton apo ai që pëson eksternalitetin, metoda tregon se ne mund të arrijmë në një marëveshje optimale. Artikulli i famshëm i cili shërbeu jo shumë si një rrugë praktike veprimi por si një mundësi alternative e metodës së taksimit optimal, nisat nga dy supozime të rëndësishme : Mungesën e kostove të transaksionit, dhe përcaktimin e qartë të të drejtave të pronësisë. Të dy këta elementë ngrenë shumë pikëpyetje në kuardin e një ekonomie pavarësisht nga mënyra e organizimit të saj.

Së pari në një ekonomi nuk mund të mendojmë se në një marëveshje, sado e thjeshtë qoftë ajo, kostot e transaksionit janë të barabarta me zero, ato mundet të jenë të ulta, por asnjëherë zero ndaj edhe për një korife të mendimit ekonomik veçanërisht në lëmin e kostove të transaksioneve, ky supozim ishte mëse i nevojshëm, dhe i leverdishëm. Nga ana tjetër megjithëse përcaktimi i të drejtave të pronësisë ka qenë gjatë gjysmës së dytë të shekullit të shkruar një ndër elementët kryesorë politikave ekonomike, përsëri është e pamundur që të themi se çdo pronësi është përcaktuar qartë

dhe pa ekuivoke. Sjellim një shëmbull të thjeshtë atë të pronësisë mbi ajrin. Megjithëse në pamje të parë pronësia mbi ajrin mundet që të duket një element i pamendueshëm madje edhe i rezikshëm, përsëri ajri (në konceptin e atmosferës) mbetet një ndër « viktimat » më kryesore të eksternaliteteve që kanë të bëjnë me ndotjen, por nga ana tjetër cili do të jetë përfitimi i atyre të cilët bëhen pronarë të ajrit, sepse një person kërkon të pronësojë diçka në momentin kur ai do të marrë nivelin më të lartë të ardhurave nga kjo pronë, thotë Smith, në Pasurinë e Kombeve.

Dy rrugët që ne analizuam më lart kanë të bëjnë me aplikimin e koncepteve të skajshme të segmentit të politikave të zgjidhjes së një problemi ekonomik. Metoda e taksimit e cila mbështetet në fuqinë vepruese të shtetit dhe të instrumentave që ky i fundit ka në dispozicion për të zgjidhur problemet ekonomike dhe metoda e dytë ka të bëjë me fuqinë e tregut për të rregulluar probelemt që dalin gjatë funksionimit të tij. Megjithëse duket se metoda e të drejtës së pronësisë, duket se nuk ka të bëjë në asnjë moment me institucionet shtetërore, përsëri duhet theksuar se janë institucionet e të drejtës ato të cilat përcaktojnë të drejtën e pronësisë në një vend dhe në një kohë të caktuar dhe se në bazë të kësaj të drejte ndërtohen edhe mardhëniet midis atyre që shkaktojnë dhe atyre që pësojnë një eksternalitet negativ.

Metoda e tretë është ajo e krijimit të një rruge të ndërmjetme midis këtyre dy qëndrimeve anësore, pra të mos mohojë rolin e shtetit si të rëndësishëm në rregullimin e problemin, por nga ana tjetër t'i japë të drejtën tregut që të rregullojë problemet e eksternaliteteve. Kjo rrugë e tretë e cila sheh si figurë të rëndësishme Arrow në fillimin e viteve 1970 të shekullit të shkuar, synon në ngritjen e një tregu përsa i përket eksternaliteteve. Tregtimi i eksternaliteteve mundëson që nëse një firmë prodhon duke ndotur një firmë tjetër atëhere, ne mund të arrijmë në nivele optimale prodhimi pas përcaktimit të të drejtave për të ndotur dhe kalimit të tyre nëpërmjet tregut (Ju, Borm 2005). Mënyra e funksionimit të këtij tregu i cili ka patur një sukses së kënaqshëm në SHBA, në rregullimin e ndotjes mjedisore mbështetet në nxjerrjen e nivelit të ndotjes në treg dhe në këmbimin e të drejtave për të ndotur midis prodhuesve, ku ata të cilët kanë kosto më të ulta marxhinale për një njësi ndotje më shumë janë të gatshëm për të tregtuar të drejtat e tyre të dotjes kundrejt uljes së nivelit të prodhimit.

Për herë të parë, ne shohim se kalojmë në mënyrë të plotë nga një metodë e cila bazohet tek ato që pësojnë eksternalitetet tek ato që shkaktojnë eksternalitetet duke përmirësuar kështu ndjeshëm nivelin e përshirjes së dëmit të eksternalitetit në pikën në të cilën ai prodhohet. Krijimi i këtij tregu, i cili ka shërbyer si një element për zgjidhjen e problemit të shpërndarjes së rentës në tokat me mundësi përdorimi alternative (të drejtat e transferueshme të ndërtimit (TDR)), apo në uljen e nivelit të prodhimit (kuotat e tregtueshme të prodhimit), ka patur një njohje mbarë botërore në aplikimin e tyre si një instrument i rëndësishëm në uljen e nivelit të emetimit të gazrave me efekt serë (GES). Në mënyrë të thjeshtë nëpërmjet autovlerësimit të dëmit nga ana e tregut ne arrijmë që ta bëjmë atë pjesë të kostove të procesit të prodhimit duke kryer funksionin e kundërt që kryejnë eksternalitetet, atë të internalizimit të kostove, pra të shuarjes së egzistencës së eksternaliteteve nëpërmjet tregut. Nuk është e nevojshme që ne të analizojmë në mënyrë të plotë modalitetet e funksionimit të këtij sistemi i cili përbën objektin e punës së shumë ekonomistëve aktualisht (Ju, Ruys, Borm, 2004), (Maskin 2003), (Varian 1994) etj. Por ajo që mbetet e rëndësishme qëndron në faktin se kjo metodë arrin që të kombinojë në mënyrë efikase forcën autorregulluese të tregut, me mbikqyrjen e institucioneve shtetërore për rregullimin e disfunkcioneve të këtij të fundit². Të treja këto strategji që ne paraqitëm më sipër paraqesin pikat e tyre të dobta dhe të forta. Në pjesën e tretë të artikullit ne do të meremi me analizën e tyre me qëllim pëcaktimin e metodës e cila mund të përputhet në mënyrë më të kënaqshme në terrenin aktual të ekonomisë.

²Mjafton të theksojmë se niveli i kostove të uljes së nivelit të prodhimit të GES, ulet deri me 78% për Japoninë nëse lejet e ndotjes do të kalojnë nëpërmjet një tregu lelesh në krahasim kur ato ishin fikse. Për SH.B.A. dhe Europën kjo ulje do të kapte përkatësisht nivelet 75 dhe 52% (Gesnerie 2002)

IV. TRE METODA, CILA DUHET MBËSHTETUR ?

Ti përgjigjesh kësaj pyetje është është e vështirë sepse ato janë frut i një analize dhe reflektimi të gjatë shkencor, ato vijnë si metoda studimore të konsoliduara dhe të mbështetura në aparate teorikë solidë, por megjithatë secila prej tyre praqet disa pika të dobëta të cilat ne do t'i listojmë në mënyrë të shkurtuar më poshtë. Mendojmë se kjo mënyrë veprimi na lejon që të dalim në përfundime më të drejta dhe më pranë realitetit.

1.Kritika të teorisë së Coase - Sigurisht që kjo teoremë është e një rëndësie të vecantë, derisa heq domososhmërinë e pjesëmarrjes së qeverisë në rregullimin e problemeve të ndotjes. Por ekonomistët kanë parë, se ka shumë probleme në lidhje me tërojnë e Coase, ku më poshtë në do të listojmë vetëm kritikën me të rëndësishme.

Gjendja e konkurrencës - Teorema e Coase është me vlera të veçanta në rastet kur gjendemi në kushtet e një konkurrence të plotë dhe perfekte. Deformimi i këtij kushti kryesor, çon në rrënimin e ngrehinës së ndëtuar nga Coase, kjo për vetë faktin se në kushtet e konkurrencë imperfekte, kurba e fitimit marxhinal nuk përbën më kurbën sipas së cilës duhet që të ndërtohet procesi i marrëveshjes.

Mungesa e marrëveshjes dhe egzistënca e transaksionit

Kritika e dytë e teoremes së Coase është pikërisht fakti, se në jetën e përditëshme është e vështirë për të gjetur raste në të cilat të gjejë një aplikim të gjerë marrëveshja. Është e vertetë se disa ndërmarrje të prodhimit të energjisë hyjnë në marrëveshje me komunitetet lokale me qëllim që këta të fundit të pranojnë në komunitetet e tyre centrale bërthamorë, ose mbetje bërthamore, duke i ofruar para, ose investime në infrastrukturën lokale, gjithashtu ka marrëveshje midis vendeve të cilët krijojnë ndotje dhe vendeve të cilët dëmtohen nga kjo ndotje. Por siç e dimë niveli i ndotjes është shumë më i gjerë se sa rastet e përmendura më sipër. Fakti, që ne nuk arrijmë të gjejmë një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh efektive, do të thotë se ka probleme në lidhje me to, pra që teoria e Coase nuk është e aplikueshme në jetën e përditëshme.

Argumenti i atyre të cilët besojnë në marrëveshjen midis aktorëve është, se vështirësia për të kryer marrëveshjen ka të bëjë me faktin e kostove të transaksioneve të nevojshme për të arritur dhe për të prurur aktorët në gjendje për të kryer marrëveshjen, për të kryer procesin e marrëveshjes etj. Nëse kostot e transaksionit janë kaq të larta në masën sa asnjë ndër aktorët nuk i mer përsipër ose akoma me keq sa që pas marrëveshjes përfitimi i secilës palë do të ulet në mënyrë të ndjeshme nga pagimi i tyre, atëherë asnjë nga palët nuk ndërmer procesin e marrëveshjes. Duket se gjithmonë kostot e transaksionit i paguan pala e cila nuk ka të drejtat e pronësisë. Kostot e transaksioneve janë kosto reale dhe ne nuk kemi asnjë arsye për ti trajtuar në mënyrë të ndryshme nga koston e tjera në ekonomi. Pra, nëse kostot janë shumë të larta, ato ulin nivelin e fitimit. Në këto raste nuk ka nevojë që të kryhet marrëveshja.

Këtu problemi bëhet i pakapërcyeshëm, si për ata të cilët mbështesin faktin se egziston një vullnet për të kryer marrëveshjen, si për ata të cilët mbështesin të kundërtën. Egzistenca e kostove të larta të transaksionit shpjegon faktin përse është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë. Kosto të larta transaksioni nuk çojnë domosdoshmërisht në ndotje optimale, nga ana tjetër ndërhyrja e qeverisë mund të jetë më e lirë dhe mund të vendosë me shpejt optimalitetin.

Le të jenë **T** = Kostot e transaksioneve, **B** = fitimi nga marrëveshja për palen e cila do të paguajë kostot, dhe **G** = koston e qeverisë për të ndërhyrë. Rastet e mundshme të kombinimit mund t'i përmbledhim në :

Nëse $T < B$, marrëveshja mund të kryhet ;

Nëse $T > B$, marrëveshja nuk do të kryhet, por do të duhen mjete të tjera rregulluese;

Nëse $T > G < B$, është me eficientë që të kryhen rregullimet nga ana qeveritare.

Megjithëse kostot e transaksionit i lenë një farë hapësire teorise se marrëveshjes, duhet të specifikojmë, se kjo teori nuk është më një teori e cila nuk ka asnjë ndervartësi me personin i cili gëzon të drejtat e pronësisë, kjo për vetë faktin se dikush duhe të paguaje koston e transaksionit.

Identifikimi i aktoreve në marrëveshje.

Edhe nëse kostot e transaksioneve nuk janë shumë të larta dhe se përfitimi do të jetë shumë me i lartë se kostot, kjo nuk do të thotë se domosdoshmërisht do të kryhet marrëveshja midis ndotësve dhe të dëmtuarve. Kjo për vetë faktin, se shumë nga ndotësit kanë një jetë të gjatë dhe se mund të dëmtojnë për vite, dhjetëvjeçare ose edhe për shekuj. Kështu njerëzit të cilët mund të dëmtohen nga këto ndotës mund të mos egzistojnë akoma gjë, që e bën shumë të vështirë vënien përballë njëra-tjetres së të dy palëve për të kryer negociatën. Mbetjet radioaktive dhe toksike, hollimi i shtresës së ozonit, ndotja e ajrit me dioksid karboni janë të gjitha ndotje, të cilat bëjnë pjesë në këtë kategori. Në rastin më të mirë i duhet brezave aktuale që të marrin përsipër për të negociuar për brezat e ardhshëm. Ky nuk është një funksion i lehtë dhe nga shumë terma rregullues, popullatat presin që qeveritë t'a kryjnë këtë rol.

Një tjetër problem është ai i identifikimit të ndotësve, të grupeve të dëmtuara përsa i përket atyre që quhen burime me akses të lirë (open acces resources). Burimet me akses të lirë nuk zotërohen nga individë të identifikueshëm, ato mund të zotërohen nga grupe. Në këto raste, është e vështirë për të përcaktuar se cili do të hyjë në marrëveshje dhe me të derisa asnjëri nga anëtarët nuk ka forcën për të ndaluar aksesin në burim të një personi tjetër.

Edhe në rastin e një ndotjeje normale, nuk mund të themi me siguri se cilët janë të dëmtuarit, për vetë faktin, se të dëmtuarit mund të mos jenë në dijeni për rrezikun që po i kanosen, ose mund të mos e dinë se preken edhe ata nga ai rrezik. Ndodh shpesh kështu me ndotësit e ujit dhe të ajrit. Kostot e informacionit për këto probleme duhet t'i shtohen kostove të marrëveshjeve për të cilat folëm më lart. Sigurisht, që një pjesë e elementëve që i përmendëm më lart mund dhe janë prezentë edhe në raste kur është qeveria ajo që meret me procesin e rregullimit.

Menyra e kercenimit

Një problem tjetër që del me mënyrën e marrëveshjes, është edhe mundësia e kërcënimit. Kjo mundësi mund të dalë atëhere kur të drejtat e pronësisë janë të ndotësit, i cili për të hequr dorë nga një pjesë e ndotjes paguhet nga i dëmtuari, duke parë këtë situatë atëhere edhe ndotës të tjerë do të kërkojnë dëmshpërblim, duke supozuar se kanë të drejta mbi burimin. Strategjia më e mirë në këto raste është, që të identifikohen qartë të gjithë elementët e pronësisë për të identifikuar zotëruarit e vërtetë të të drejtave. Të tilla probleme kanë dalë në pah në rastet kur janë përpunuar skema për të kompensuar ndotësit.

2. Taksimi si një metodë e kufizuar.

Taksat e ndotjes kanë shumë përparësi. Ato përdorin disa mekanizma të tregut nga ana e qeverive, për shërbime të cilat deri tani nuk kanë patur një çmim të caktuar. Në disa raste këto taksa ulin nivelin e përdorimit të tregut për vetë faktin, se ato rriten me rritjen e nivelit të rallësisë së elementit në fjalë. Këto taksa janë shumë të përshtatshme në rastet në të cilat funksionet e kostove të dëmit dhe ato të uljes së ndotjes janë të njohur. Deri tani në botën reale taksat e ndotjes janë një përjashtim dhe jo një rregull. Jo vetëm që nuk janë të përhapura por nga ana tjetër edhe formulimi i tyre tenton të anashkalojë kuadrin teorik, që në kemi paraqitur në këtë artikull. Përse ndodh kjo ? Pezzy (1988) ofron një grup sugjerimesh shumë interesante, të cilat shpjegojnë përse përdorimi i këtyre taksave është i ulët.

Pasiguria përse i përket drejtësisë së taksave Pigoviane

Gjithmonë industria ka për të kundërshtuar taksat e reja, problemi nuk qëndron këtu, por në faktin se taksat Pigoviane mund të shkojnë me tej se sa niveli Pareto optimal i taksës dhe nëse industrinë mund të pranojnë rolin e një ndotësi standart, por jo të një ndotësi të zgjeruar.

Mungesa e informacionit përse i përket funksionit të dëmit

Taksa Pigoviane kërkon që të njohim së paku një pjesë të funksionit MEC, i cili është interpretimi marxhinal i kostove totale të eksternalitetit ose funksioni i dëmit. Gjykimi i shumë ekonomistëve dhe i shumë specialistëve që meren me këto probleme përputhen në faktin se përbën një formë jo fort e saktë edhe nga fakti se është shumë e vështirë për të vlerësuar në praktikë funksionin e dëmit. Nga ana tjetër, edhe nëse arrijmë të sigurojmë disa vlerësime, nuk është e vështirë që një grup tjetër specialistësh mund të bien dakort për një grup tjetër dëmsh, duke e bërë kështu të vështirë identifikimin e saktë të bazës legale, mbi të cilën do të vendoset taksa ose detyrimi.

Pra, duket se ideja për të llogaritur një taksë Pigoviane optimale nuk është realiste. Gjithashtu dëmi mund të shtrihet në nivele të ndjeshmërisë së tij duke e bërë të pamundur vlerësimin e tij.

3. Lejet e tregtueshme të ndotjes

Ndër pikat kryesore të lejeve të tregtueshme ne mund të përmendim :

Tregtia e lejeve një mundësi për grupet e presionit - Një ndër karakteristikat e tjera të rëndësishme qëndron në faktin se këto tregje janë të hapura, pra ka një grup të gjerë aktorësh të cilët mund të operojnë në këto tregje. Grupet e presionit mund të përbëjnë një prej aktorëve. Grupet të cilat nuk duan rritjen e nivelit të ndotjes, qoftë në vendin në fjalë qoftë në një zonë të caktuar, mund të hyjnë në tregje me qëllim blerjen e këtyre lejeve dhe mos përdorimin e tyre. Kështu me uljen e nivelit të ndotjes se mundësuar nga lejet, do të kemi si në rastin e pare rritjen e çmimit të ekuilibrit, pra të lejes, i cili përket me interes nga ana e firmave, të cilat kanë kosto ulje ndotjeje të ulët, që të japin në treg një pjesë të lejeve të tyre dhe të instalojnë pajisje për uljen e ndotjes. Problemi në këtë rast qëndron në faktin, se nëse qeveria është e bindur se niveli i lejeve të cilat egzitonin me parë në treg është ai optimal, atëherë ajo do të rihedhe në treg leje të reja, të cilat do ta bëjnë strategjinë e përmendur më lart të pavlefshme.

Inflacioni dhe kostot e rregullimit

Një tjetër karakteristike, e cila i bën lejet më të preferueshme se sa taksat, është pikërisht fakti, se kur zbatohet strategjia e lejeve nuk është e nevojshme që ne të njohim se cilat janë kurbat e kostove siç ishte rasti i taksave. Siç e kemi parë, vështirësia për të mirë vlerësuar të gjithë faktorët që çonin në gjetjen e një takse optimale ishte e lartë. Në rastin e lejeve ne nuk i hasim me këto probleme për vetë faktin, se në këtë rast kemi të bëjmë me një situatë të thjeshtë kërkesë dhe oferte, kështu që është e nevojshme të përcaktohen standartet dhe mënyra e dhënies së lejeve dhe tregu arrin të rregullojë problemin. Nga ana tjetër taksat kanë nevojë për rregullime të vazhdueshme dhe të herëpashershme që kanë të bëjnë me nivelin e inflacionit i cili edhe në vende me një ekonomi të zhvilluar mund ta bëjë taksën në një periudhë dhjetë vjeçare të pavlefshme dhe qesharake. Në sistemin e lejeve kjo meritë parasyh që në momentin e diskutimit në bazë të kërkesës dhe ofertës.

Dimensioni hapsinor

Gjatë gjithë diskutimit tonë ne kemi marrë parasysh se kemi një numër të vogël prodhuesish ndotjeje dhe gjithashtu një numër të vogël pikash recepsioni. Në të vertetë, në praktikë ndodh shumë më ndryshe. Duke qenë se si prodhuesit ashtu edhe pikat e recepsionit janë të shumta edhe nga ana tjetër është sasia e asimilimit për çdo pike recepsioni është shumë e ndryshme, atëherë duhet që taksat të reflektonin të gjithë këtë diversitet. Nga ana tjetër, mund të lindin probleme të cilat kanë të bëjnë me efektin e sinergjisë, që ka të bëjë me bashkëpunimin e firmave ndotëse për të prodhuar

së bashku një nivel ndotjeje, i cili është më i ulët se shumica e ndotjeve që do të prodhonin veç e veç. Kjo formë paraqet vështirësi, veçanërisht në pjesën administrative dhe të llogaritjes së taksës.

Ndër problemet kryesore për sa i përket lejeve qëndron fakti se është e vështirë llogaritja e nivelit të prodhimit të ndotjes, dhe megjithëse aktualisht janë provuar disa mënyra përsëri mbetet një sistem i cili duhet përmirësuar, nga ana tjetër, ndërtimi i një tregu kërkon një investim institucional të rëndësishëm i cili duhet të jetë i aftë që të sigurojë qëndrueshmërinë e tregut. Megjithë këto probleme që hasim me lejet e tregtueshme ato mbeten një instrument i fuqishëm për përdorim.

V. PËRFUNDIME

Administrimi i eksternaliteteve në ekonominë e tregut mbetet një element i rëndësishëm analize. Ai nga njëra anë tenton optimalizimin e veprimtarisë së aktorëve ekonomikë dhe nga ana tjetër shëndoshjen ekonomike të shoqërisë. Është e rëndësishme se analiza që ne zhvilluam në këtë artikull ka si qëllim të analizojë metodat e aplikuara aktualisht për ekstranlitetet në kushtet e problemeve mjedisore duke paraqitur pikat pozitive dhe negative të secilës prej tyre. Në mënyrë më të përgjithshme kjo analizë është më efikase nëse zhvillohet në termat një ekonomie e cila ndjen në zhvillimin e saj përkrahjen e institucioneve shtetërore, apo të një ekonomie të lidhur fort me tregun. Përgjigja nuk gjendet as në rastin e parë dhe as në rastin e dytë. Administrimi i eksternaliteteve në përgjithësi dhe në rastin e ndotjes në mënyrë të veçantë, optimalizohet në përdorimin e instrumentave të cilët nga njëra anë arrijnë që të përdorin forcën vetërregulluese të tregut por nga ana tjetër gjenden nën hulumtimin e institucioneve shtetërore si garantuese të mirëqënies të të gjithë aktorëve ekonomikë. Në këto kushte metoda e lejeve të tregtueshme duket se është më e përshatëshme për tu aplikuar në administrimin e eksternaliteteve. Dhe për t'ju përgjigjur pyetjes që qëndron si titull i këtij artikulli se cila është rruga për administrimin më efikas të eksternaliteteve, shteti apo tregu përgjigjja pa qenë oportuniste do të ishte asnjëra prej tyre por pak nga të dyja.

BIBLIOGRAFI

Arrow, K. (1970), *The Organization of Economic Activity: Issues Pertinent to the Choice of Market versus Non-market Allocation*, In: Haveman, R.H. and J. Margolis (Eds.), *Public Expenditures and Policy Analysis*, Chicago: Markham, pp. 59-73.

Coase, R. H. (1960), *The Problem of Social Cost*, *Journal of Law and Economics*, 3, 1-44.

Pearce, D., Turner, K. (1990). *Economics of natural resources and the environment*. Pearson Education Limited England,

Pigou, A.C. (1920), *The Economics of Welfare*, London: Macmillan.

Maskin, E. (2003), *Bargaining, Coalitions, and Externalities*, *Presidential Address to the Econometric Society, Econometric Society European Meeting*, Stockholm, Sweden

Varian, H.R. (1994), *A Solution to the Problem of Externalities When Agents are Well-informed*, *American Economic Review*, 84, 1278-1293

INTEGRIMI EUROPIAN DHE ROLI I BANKËS SË SHQIPËRISË

INA KRAJA¹

NIUTON MULLETI²

ABSTRAKT. *“Integrimi evropian”, “Procesi i Stabilizim-Asociimit”, “negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit”:* këto janë vetëm disa nga termat me të cilat qytetarët shqiptarë përballen çdo ditë, jo vetëm në median e shkruar dhe në atë vizive, por edhe në fjalorin e politikanëve dhe pse jo, edhe në bisedat e përditshme. Qëllimi i këtij artikulli të shkurtër është që të japë një informacion të përgjithshëm dhe sa më të kuptueshëm për lexuesin, në lidhje me rolin e Bankës së Shqipërisë, si një institucion mjaft i rëndësishëm monetar dhe financiar në Republikën e Shqipërisë, i cili ka detyrimet e veta në kuadër të procesit të integrimit evropian në përgjithësi, dhe në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në veçanti.

HAPI I PARË DREJT NJË BALLKANI PERËNDIMOR EVROPIAN: PROCESI I STABILIZIM-ASOCIIMIT.

Vitet '90 shënuan një periudhë të konflikteve të dhunshme etnike dhe të një paqëndrueshmërie të theksuar politike pothuajse në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Në këto kushte, Komisioni Evropian ra dakord në muajin maj të vitit 1999, për parimet kryesore që do të udhëhiqnin një strategji më ambicioze të Bashkimit Evropian (BE) në marrëdhëniet e kësaj organizate me vendet e rajonit.

Këto parime konsistojnë në:

- mendimin e Komisionit Evropian se motivimi kryesor për kryerjen e reformave në këto vende – duke përfshirë vendosjen e sundimit të ligjit, të institucioneve të qëndrueshme demokratike dhe të një ekonomie të lirë dhe të hapur tregu – do ta përbënte ofrimi i një perspektive të besueshme për anëtarësim të vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian sapo që të përmbusheshin kushtet e vendosura nga kjo organizatë. Kjo perspektivë e qartë për anëtarësim në të ardhmen e vendeve të Ballkanit Perëndimor, u ofrua për herë të parë në samitin e Feiras në qershor 2000 dhe u rikonfirmua më me shumë forcë në samitin e Selanikut, të mbajtur në qershor 2003.
- nevojën për vendosjen e marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet vendeve të rajonit, gjë që do të krijonte mundësi për më shumë qëndrueshmëri politike dhe ekonomike në Ballkanin Perëndimor.
- nevojën për një përjasje më fleksibël, e cila do të lejonte çdo vend që të ecte në rrugën e tij drejt Bashkimit Evropian në mënyrë të pavarur, edhe pse do të ekzistonte një grup i kushteve ekonomike dhe politike, që do të zbatoheshin për të gjitha këto vende. Në të njëjtën kohë, programet e asistencës financiare dhe teknike do të duhet të hartoheshin në bazë të nevojave specifike të secilit vend.

¹ Autorja është Drejtoreshë e Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimi Evropian dhe Komunikimi, Banka e Shqipërisë

² Autori është punonjës i Bankës së Shqipërisë

Të gjitha këto parime të vendosura nga Komisioni Evropian u konkretizuan në Samitin e Zagrebit të datës 24 nëntor 2000, ku u paraqitën edhe elementet përbërëse të Procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA). Në këmbim të perspektivës së qartë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, bazuar në Traktatin e Mastrihtit dhe kriteret e Kopengahenit si dhe në përgjigje të asistencës të ofruar nga Bashkimi Evropian, vendet e rajonit u angazhuan që të përmbushnin kushtet e vendosura nga kjo organizatë dhe të përdornin Procesin e Stabilizim-Asociimit e në veçanti Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit (MSA), në mënyrë që të përgatiteshin për një anëtarësim të ardhshëm në Bashkimin Evropian.

Procesi i Stabilizim-Asociimit konsiston në këto elemente të mëposhtme:

- a) Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit:** Këto marrëveshje përbëjnë si thelbin e PSA-së, ashtu edhe një hap mjaft të rëndësishëm drejt realizimit të plotë të këtij procesi. Nënshkrimi i MSA-ve përfaqëson angazhimin dhe vullnetin e palëve nënshkruese për të përfunduar brenda një periudhe kalimtare një asociim formal me BE-në. MSA-të ofrojnë mekanizmat formalë dhe pikat e referimit, që e lejojnë BE-në të punojë me secilin vend në mënyrë që t'i sjellë ato më afër standardeve të BE-së.

MSA-të përqendrohen në respektimin e parimeve themelore demokratike si dhe të elementeve bazë të tregut unik të BE-së. Përmes krijimit të një zone të tregtisë së lirë me BE-në, shoqëruar edhe me fushat (rregullat e konkurrencës dhe të ndihmës shtetërore, pronësia intelektuale etj.) dhe përfitimet (për shembull, e drejta e vendosjes në vendet e BE-së) e lidhura me këtë treg, ky proces do të lejojë ekonominë e gjithë rajonit që të fillojë të integrohen gradualisht me atë të BE-së. Për ato fusha ku marrëveshjet nuk vendosin detyrime specifike në lidhje me *acquis communautaire* (legjislacioni komunitar) të BE-së, ekzistojnë dispozita që kanë të bëjnë me bashkëpunimin e detajuar me BE-në, me synim kryesor dhënien e ndihmës këtyre vendeve për t'u afruar me standardet e BE-së.

MSA-të janë të përgatitura sipas rrethanave specifike të secilit vend. Sidoqoftë, siç u tha më sipër, synimi i çdo MSA-je është arritja e një asociimi zyrtar ndërmjet çdo vendi të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, dhe ky asociim do të realizohet përmes zbatimit të një sërë detyrimesh të cilat janë të njëjta për secilin vend.

Vetë mekanizmat e krijuar nga këto marrëveshje, duke filluar nga nënkomitetet e specialistëve dhe teknikienëve e deri tek organet e nivelit politik, siç është Këshilli i Stabilizim-Asociimit, do të lejojnë që BE t'i kushtojë rëndësi reformave sipas përparësive që ato paraqesin si dhe t'i formësojë ato sipas modeleve të BE-së, të zgjidhë problemet e mundshme dhe të mbikëqyrë zbatimin e tyre nga vendet nënshkruese. Zbatimi i plotë i MSA-ve është një parakusht për vlerësimin e mundësisë që një vend ka për t'u anëtarësuar në BE.

- b) Asistenca e BE-së:** Programi i BE-së CARDS (Asistenca Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim) i ka shtuar asistencës për vendet e PSA-së një përbërës që synon lehtësimin e rrugës së tyre drejt BE-së. Kjo asistencë përdoret kryesisht për të mbështetur financiarisht dhe teknikisht kryerjen e reformave dhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale që parashikohen në MSA.

- c) Dimensioni rajonal:** PSA nuk është thjesht një proces dypalësh ndërmjet BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, por në të njëjtën kohë, ai i jep një rëndësi të veçantë bashkëpunimit rajonal. MSA-të përmbajnë dispozita të posaçme, që parashikojnë një angazhim të qartë të secilit vend për të bashkëpunuar nga afër me vendet e tjera të përfshira në PSA. Në të njëjtën kohë, edhe CARDS ka një përbërës të rëndësishëm rajonal.

Më konkretisht, dimensionin rajonal i PSA-së parashikon që vendet e rajonit të firmosin me njëra-tjetrën konventa të bashkëpunimit rajonal si dhe të krijojnë një rrjet të marrëveshjeve dypalëshe

të tregtisë së lirë (si pjesë e konventave të mësipërme). Kjo do të thotë që nuk do të ekzistojnë më pengesa për lëvizjen e lirë të mallrave ndërmjet vendeve të rajonit ashtu si edhe me BE-në. Edhe integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor me rrjetet evropiane të infrastrukturës (transporti, energjia, administrimi i kufijve) përbëjnë një tjetër element të rëndësishëm të dimensionit rajonal të PSA-së.

SHQIPËRIA DHE PROCESI I STABILIZIM-ASOCIIMIT.

Marrëdhëniet e para kontraktuale midis Shqipërisë dhe BE-së u vendosën në vitin 1992 nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit. Menjëherë pas adoptimit të PSA-së, në vitin 2001, Komisioni Evropian vendosi që të procedonte me negociatat për nënshkrimin e MSA-së me Shqipërisë, ndërsa direktivat për negociatat me vendin tonë u miratuan nga BE, në tetor 2002. Këto negociata u hapën më 31 janar 2003 dhe deri më tani janë zhvilluar 6 raunde zyrtare dhe 9 raunde teknike, ku edhe janë negociuar dhe mbyllur pjesa më e madhe e neneve të marrëveshjes.

Në të njëjtën kohë, në vitin 2004, ashtu si edhe për të gjitha vendet e rajonit, Komisioni Evropian paraqiti Dokumentin e Partneritetit Evropian për Shqipërinë. Ky dokument përcaktonte konkretisht fushat në të cilat duhet të kryheshin reforma, shoqëruar kjo edhe me afatet përkatëse. Në përgjigje të këtij dokumenti, Qeveria Shqiptare miratoi në shtator 2004 Planin e Veprimit për Zbatimin e Përparësive të Partneritetit Evropian. Ky Plan i Veprimit përmbante në formë tabelore të gjitha masat që institucionet shqiptare (përshtirë edhe Bankën e Shqipërisë) do të duhet të ndërmerrenin në kuadër të detyrimeve që rridhnin nga Dokumenti i Partneritetit Evropian. Sidoqoftë, megjithë miratimin e këtij Plani të Veprimit, bazuar edhe në rekomandimet e Komisionit Evropian dhe në përvojën e vendeve që kanë kaluar më parë përmes një procesi të ngjashëm, Qeveria Shqiptare vazhdoi punën për hartimin dhe adoptimin e Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Vendas me atë të BE-së dhe zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga MSA, i cili do të plotësonte dhe do të përmirësonte angazhimet e ndërmarra në Planin e Veprimit.

Ky Plan Kombëtar i Përafrimit të Legjislacionit (PKPL), i cili u miratua në maj të vitit 2005, ka si pikësynim kryesor sigurimin e përshtatjes dhe përafrimit të legjislacionit vendas me atë komunitar si dhe zbatimin rigoroz të tij. Në të njëjtën kohë, ky Plan ofron një kalendar të qartë, me afate të përcaktuara (në periudhë afatshkurtër, afatmesëm ose afatgjatë), mbi të cilin çdo institucion përgjegjës do të mbështesë punën e tij, në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian.

BANKA E SHQIPËRISË DHE MARRËVESHJA E STABILIZIM-ASOCIIMIT.

Që nga fillimi i negociatave për nënshkrimin e MSA-së në janar 2003, Banka e Shqipërisë ka qenë e përfqësuar në grupin negociator shqiptar, duke marrë pjesë në të gjitha raundet zyrtare dhe teknike të negociatave, të cilat janë zhvilluar deri tani. Banka e Shqipërisë ka qenë sidomos e angazhuar në negociimin e periudhave tranzitore të disa neneve të marrëveshjes, prej të cilëve dy janë të një rëndësie të veçantë: nenet 57 dhe 61.³

Neni 57, i cili mbulon fushën e ofrimit të shërbimeve, parashikon që palët nënshkruese do të marrin masat e nevojshme që të lejojnë progresivisht ofrimin e shërbimeve nga kompani ose shtetas të BE-së ose të Shqipërisë në vendet përkatëse. Në të njëjtën kohë, ky nen parashikon që duke filluar nga viti i tretë pas hyrjes në fuqi të MSA-së, Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të marrë masat e nevojshme për të zbatuar progresivisht detyrimet e ndërmarra si më sipër.

³ Duke qenë se MSA nuk është nënshkruar ende, duhet patur parasysh që dispozitat e këtyre neneve që do të diskutohen më poshtë përfaqësojnë versionin më të fundit dhe jo domosdoshmërisht atë përfundimtar.

Për sa i përket ofrimit të shërbimeve bankare në Shqipëri nga operatorët komunitarë, fushë kjo ku sipas këtij neni Banka e Shqipërisë është drejtpërdrejt përgjegjëse, duhet theksuar që mbështetur në legjislacionin ekzistues vendas, nuk ka asnjë pengesë, kufizim apo diskriminim në lidhje me ofrimin e këtyre shërbimeve në territorin e Shqipërisë. Për këtë arsye, zbatimi i këtij neni nuk pritet të paraqesë ndonjë problem të madh për Bankën e Shqipërisë.

Neni 61, i cili mbulon liberalizimin e llogarisë kapitale dhe financiare të bilancit të pagesave mbart një rëndësi mjaft të madhe.

Bazuar në këtë nen:

- duke filluar nga hyrja në fuqi e MSA-së, palët do të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me investimet direkte të bëra nga kompani, që janë themeluar në përputhje me ligjet e vendit pritës së bashku me likuidimin apo riatdhësimin e këtyre investimeve si dhe të çdo fitimi që rrjedh nga këto investime.
- duke filluar nga hyrja në fuqi e MSA-së, palët do të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me kreditë e lidhura me transaksionet tregtare apo ofrimin e shërbimeve, si dhe të huave dhe kredive financiare me maturitet më të madh se një vit.
- duke filluar nga fillimi i periudhës së dytë kalimtare (pesë vjet pas hyrjes në fuqi të MSA-së), palët do të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me investimet e portofolit si dhe të huave dhe kredive financiare me maturitet më të vogël se një vit.
- për sa i përket blerjes së pasurive të paluajtshme nga shtetas të BE-së, Shqipëria është e detyruar që brenda një periudhe dhjetëvjeçare që nga hyrja në fuqi e MSA-së të sigurojë progresivisht blerjen e tokës bujqësore, të kullotave, të tokës bregdetare dhe pyjeve nga shtetasit e huaj, sipas të njëjtave kushte dhe procedura që zbatohen edhe për shtetasit shqiptarë.

Legjislacioni shqiptar në fushën e lëvizjeve të kapitalit përfaqësohet nga rregullorja “Për veprimtarinë valutore”, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në korrik 2003. Sipas kësaj rregulloreje, flukset hyrëse të kapitalit në Shqipëri janë tërësisht të liberalizuara, ndërsa për sa i përket daljes së kapitalit, ky proces nuk kërkon më autorizim nga Banka e Shqipërisë, por ky transferim kryhet nga subjekte të licencuara nga Banka e Shqipërisë, pra banka dhe jobanka, pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar. Me qëllim liberalizimin total të këtij procesi dhe përputhjen e plotë me *acquis-in* e BE-së, si dhe të faktit që transaksionet e llogarisë kapitale nuk janë në varësi të drejtpërdrejtë vetëm të Bankës së Shqipërisë, por ekzistojnë edhe institucione të tjera që kanë detyrimet e tyre si lidhur me shitblerjen e tokës, veprimet e lëvizjes fizike të kapitalit, investimet direkte etj., është gjykuar i nevojshëm nga Banka e Shqipërisë hartimi i ligjit “Për regjimin e këmbimeve valutore”, i cili do të pasqyrojë *acquis-in* e BE-së në këtë fushë.

Hartimi dhe miratimi i këtij ligji kaq të rëndësishëm sigurisht që është përfshirë në Planin Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit (PKPL), së bashku edhe me një sërë ligjesh (si për shembull, ligji “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”) dhe aktesh normative (kryesisht në fushën e mbikëqyrjes bankare dhe të sistemit të pagesave), të cilat do të duhet të amendohen nga Banka e Shqipërisë dhe të përshtaten me *acquis-in*, brenda afateve të përcaktuara në këtë Plan.

RRUGA DREJT BE-SË: ÇFARË NA PRET NË TË ARDHMEN?

Siç e thamë edhe më lart, me nënshkrimin e MSA-së ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së, midis palëve do të jetë krijuar një asociim formal, i cili sigurisht që do të përbëjë një rritje në nivelin e marrëdhënieve dypalëshe. Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, fokusi do të jetë mbi zbatimin e saj në praktikë. Banka e Shqipërisë, ashtu si edhe institucionet e tjera përgjegjëse, detyrimet e saj për zbatimin e dispozitave përkatëse do t'i kryejë bazuar në Planin Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit.

Në të njëjtën kohë, duhet përmendur një zhvillim i ri që ka të bëjë me përgatitjen e Instrumentit për Para-Anëtarësim (Instrument for Pre-Accession) nga ana e Komisionit Evropian. Pika më e rëndësishme dhe domethënëse e këtij instrumenti është konsiderimi i Shqipërisë (së bashku me Bosnjë-Hercegovinën, Maqedoninë dhe Serbinë-Malin e Zi) si një “kandidat potencial për anëtarësim”, një status ky që konfirmon dhe përforcon perspektivën e qartë për anëtarësim, që iu ofrua vendeve të rajonit tonë në Samitin e Feiras dhe sidomos në atë të Selanikut, në vitin 2003.

Duke u bazuar edhe në përvojën e deritanishme të vendeve të rajonit (Bullgari, Rumani dhe Kroaci), të cilat ose janë anetaresuar tashme, ose pritet të anëtarësohen së shpejti në BE, mund të parashikojmë edhe serinë e ngjarjeve që do të pasojnë hyrjen në fuqi të MSA-së. Vijimi i hapave të mëtejshëm të procesit të integritetit do të jetë i tillë: aplikimi për statusin e vendit kandidat për anëtarësim, pranimi i këtij statusi nga ana e BE-së, fillimi i negociatave për anëtarësim, negociimi dhe mbyllja e të 31 kapitujve të acquis-it, mbyllja zyrtare e negociatave për anëtarësim, nënshkrimi i traktatit të anëtarësimit të vendit në BE, ratifikimi i këtij traktati nga të gjitha vendet e BE-së dhe së fundmi, anëtarësimi i mundshëm në BE. Kohëzgjatja e këtij procesi varet, në masën më të madhe, nga ritmi i kryerjes së reformave prej vendit që aspiron për anëtarësim, por në të njëjtën kohë, edhe vendimi i vendeve anëtare të BE-së se me çfarë shpejtësie do të mundësojnë pranimin e vendeve të reja anëtare në gjirin e organizatës, është një faktor me ndikim të konsiderueshëm. Sidoqoftë, ajo çfarë mund të themi si përfundim është fakti që procesi i integritetit evropian kërkon një angazhim mjaft të madh nga vendi aspirues për anëtarësim, i cili jo vetëm që duhet të ketë dëshirë dhe të tregojë vullnet për anëtarësim në BE, por në të njëjtën kohë duhet të zotërojë aftësi të mjaftueshme institucionale, financiare dhe profesionale për të realizuar reformat rrënjësore të nevojshme për një anëtarësim me të drejta të plota në BE. Në këtë kuadër, edhe Banka e Shqipërisë me siguri që do të jetë e angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit të saj institucional, operacional dhe ligjor, gjë që do të mundësonte një përafrim dhe përputhshmëri me sa më pak probleme të Bankës së Shqipërisë me standardet, me modelet dhe me praktikatat më të mira të Bashkimit Evropian, në përgjithësi dhe të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, në veçanti.

ZHVILLIMI I EKONOMISË NË FOKUSIN E NJË PRESIDENTI

ZHVILLIMI I ZAMBIAS NËPËRMJET RRRITJES SË MENAXHIMIT DHE DIJES

NGA LEVY PATRICK MWANAWASA¹

Kam dëgjuar shpesh këto kohët e fundit diskutime të cilat tentojnë të prekin tema „Ne duhet të mbajmë gjallë luftën kundër kapitalizmit dhe globalizimit. ..“ Luftë kunder kujt dhe si? Në ditët e sotme ne nuk duhet të diskutojmë për „luftëra“, por për „strategji“ – një trajtim më proaktiv në vend të të qenit kundërshtues.

Janë të shumtë ata intelektualë që besojnë se kjo në të vërtetë kjo është situata me të cilën përballemi sot.(deri diku kolonializëm). Ata janë mosbesues dhe deri në në fyes ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare si Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, ku sipas tyre besohet që janë pikërisht ata “agjentët e kolonializmit”. Dhe meqë ata janë “agjentët”, rrjedhimisht duhet të jenë edhe kolonistët e rinj real. Sipas optikës së tyre, SHBA është i dyshuari kryesor dhe i vetëm për këtë pozicion keqdashës (ndoshta sepse kurrë nuk ka marrë pjesë në epokën e shkuar të kolonializimit.) Më vjen keq –të pohoj se nuk ka ndonjë të interesuar për të na kolonizuar dhe shanset që kjo mund të ndodhë janë pothuajse zero pasi nuk ka kohë këtë rradhë.

Sigurisht që paranoja jonë është e kuptueshme. Afrikanët kanë qenë viktimë të formave më të rënda të abuzimit njerëzor në të kaluarën, përfshirë këtu edhe tregtinë e skllavërve Por, kjo epokë e terrorizmit njerëzor u vijua me epokën e kolonializimit kur popujt afrikanë u kacavirrën ndërmjet pak vendeve Evropiane dhe më pas u përndoqën. Këto eksperiencia brutale na kanë lënë thellësisht të gjymtuar, psikologjikisht dhe intelektualisht të çorientuar, pavarësisht përfitimeve të pakundërshtueshme.

Formatuar sipas detajeve të ngatërruara të së shkuarës, tashmë ne i trembemi gjithshkaje madje edhe hijes. Kemi frikë çdo gjë të vogël dhe e shohim atë si një shenjë që po “pushtohemi” përsëri. Ende nuk mund të besojmë që kësaj rradhe “ata” na kanë lënë vetëm. Prandaj fillojmë të shohim komplete të padukshëm kudo që duken si strategji të reja të kolonizimit dhe skllavërimit tonë përsëri. Dhe e quajmë këtë „neokolonializëm“.

E vërteta është se e gjithë kjo është imagjinare. Në këto momente ne na nevojitet të thyejmë paranojën tonë dhe të ndërjegjësohemi që kësaj here problemet janë krijimtaria jonë. Nuk ka ndonjë që të na bëjë ne forcërisht “skllavër” të njerëzve të tjerë. Këtë herë ne kemi skllavëruar veten tonë. Ne kemi kolonizuar vetveten. Nuk është Amerika dhe FMN. Jemi ne.

Epokat e skllavërimit dhe kolonializmit evropian i kanë qenë periudha të vështira, por nga ana tjetër ishte e lehtë të konstatoheshin dhe prandaj më të lehta për t’u ndaluar. Sot afrikanët janë të skllavëruar dhe kolonizuar nga vetvetja dhe kjo është shumë e vështirë të konstatohet dhe madje më e vështirë për t’u ndaluar. “Njerëzit e Afrikës ende vështrojnë jashtë për të parë kush janë kolonizatorët e tyre të rinj dhe tregtarët e rinj të skllavërve. Ne kemi harruar të shohim se këtë

¹Levy Patrick Mwanawasa, është President aktual i Republikës së Zambias, i zgjedhur për herë të dytë në këtë post. Nisur nga komentet dhe diskutimet që kanë përfshirë rradhët e ekspertëve dhe politikës në Zambia në lidhje me reformat dhe zhvillimin ekonomik të vendit, në artikullin e mëposhtëm ai paraqet një këndvështrim ndryshe të analizës dhe rrugëve për zhvillim duke e vënë theksin në rritjen e menaxhimit dhe dijes si rrugët kryesore për zhvillimin e Zambias.

herë ata jemi vetë ne, askush tjetër. Ne jemi bërë skllavër të gabimeve tona - të kolonizuar nga injoranca jonë.”

SHBA dhe vendet europiane nuk janë më të interesuar në Afrikë – të paktën jo aq shumë sa ne mendojmë. Ata nuk janë më të interesuar për të na kolonizuar ose skllavëruar. Ne kemi ekzagjeruar rëndësinë dhe vlerën tonë këtë rradhë. Dhe kjo për shkak të injorancës. Kemi mbetur të mbërthyer pas së shkuarës.

Injoranca jonë vjen nga fakti që ne ende i besojmë teksteve tona. Tashmë të gjithë tekstet e Ekonomisë janë të dalë jashtë përdorimit dhe nuk duhet t'i marrim më shumë seriozisht. Fusha e Ekonomisë vazhdon të bëjë disa supozime që nuk janë më të vlefshme dhe kjo e bën të gjithë këtë fushë përgjithësisht të pavend për problemet aktuale të Botës. Dhe ende “klasa intelektuale” afrikane merr vendndime mbështetur në këto supozime false.

Le të marrim një shembull: Ekspertët tanë të ekonomisë ende vazhdojnë të besojnë dhe trumpetojnë se “toka” dhe “puna” janë faktorët kryesorë të prodhimit. Ky supozim është mëse i vërtetë po t'i referohemi si epokës së skllavërisë ashtu edhe të kolonizimit ku ekonomitë drejtoheshin nga këta faktorë. Kjo ishte edhe arsyeja pse tregtarët e huaj të skllavëve vinin në Afrikë të gjenin krahun e lirë të punës. Në epokën koloniale ata vinin për “token e lirë” dhe ata bënë veten dhe vendet e tyre të pasur me ne.

Por, tani gjërat kanë ndryshuar. Njeriu më i pasur në botë zor se ka në pronësi ndonjë tokë, dhe sigurisht ka vetëm pak “punëtorë”. Koorporata Microsoft (Microsoft Corporation) drejton botën e biznesit duke menaxhuar proceset operacionale me angazhimin spektakolar për ndryshim dhe novacion. Faktori kryesor i prodhimit është tani menaxhimi i përparuar dhe jo toka ose puna.

Ne ende mendojmë se bota është pas nesh dhe që duan ta kolonizojnë atë për shkak të siperfaqeve të saj të pasura të tokës bujqësore. E vërteta është se bota e zhvilluar nuk po përballet më me problemin tradicional të nën-prodhimit në fushën e bujqësisë; problemi i tyre kryesor është tani mbi-prodhimi. Tashmë ata prodhojnë tepër. Ata nuk po kërkojnë të pushtojnë toka afrikane për prodhimin e tyre. Toka nuk është më një burim i rrallë dhe as faktor kufizues në prodhim. Me rritjen e teknologjive të reja, kërkohet më pak tokë dhe jo më shumë. Kjo do të thotë se Zambia me gjithë sipërfaqen e pafund të tokës së virgjër, nuk është vendi “më i dëshiruar” nga “neokolonialistët”. “Toka jonë e pafund dhe pjellore nuk është me sekretin e mbajtjes së botës. Pjelloria tashmë mund të krijohet në laborator.

Edhe puna nuk është më faktori kryesor i prodhimit. Edhe pse është ende i rëndësishëm, vlera e tij është duke u zvogëluar në mënyrë fenomenale këto vite. Ai po e humb vlerën e tij ndaj një faktori tjetër të ri: dija. Pak dekada më parë një person duke punuar në një fabrikë merrte shumë më tepër para se dikush që bënte një pune studimore. Ishte koha kur logjikisht ishte më mirë të punoje menjëherë pas shkolle se sa të ndiqje më tej studimet. Kompanitë ishin relativisht të vogla dhe të kufizuara për vende të rehatshme dhe tregje. Kompanitë moderne sot janë bërë më të mëdha në qëllim dhe shumë më konkurruese dhe ia detyrojnë mbijetesën e tyre aftësisë së tyre për përvetësimin, përpunimin dhe integrimin e informacionit –tani më shumë vlerësohet ajo që ju dini se sa ajo që keni në pronësi. Teoria aktuale ekonomike ka harruar implikimet e komplikuar të kësaj tendence. Ekonomia Moderne (në kuptimin klasik si shkencë) ka dështuar në llogaritjen e ndikimit të globalizimit dhe taksimit të tij për nivelet e reja të dijes së specializuar dhe karakterit menaxhues si faktorë të diferencuar në prodhim dhe rendiment

Intelektualët afrikane ende thonë: “kontinenti ynë është potencialisht kontinenti më i pasur në të gjithë botën”. Dhe kur i pyesni pse, ata ende thonë “ne kemi shumë tokë, shumë minerale të pazbuluara, dhe shumë forcë pune të lirë të papërdorur”.

Pse atëherë njerëzit tanmë janë ende të varfër me gjithë këto burime? Kjo për shkak të neokolonializmit, sipas profesoreve tanë të Ekonomisë. Për shkak të komplotimit duke përfshirë Bankën Botërore, FMN dhe SHBA. Dhe çdo vit prodhojmë një armatë studentësh të shkencës paranojake humanitare dhe sociale me mungesë të rrezikshme në arsimim që zënë vende të rëndësishme në pozicione vendimmarrjeje përfshirë edhe Presidencën. Injoranca e tyre i shitet pjesës tjetër të popullit të shkolluar nëpërmjet artikujve të tyre të gazetave, fjalimeve dhe diskutimeve të organizuara. Dhe pastaj ne çuditemi pse mbesim të varfër, me këtë dietë ditore të ideve jashtëpërdorimit nga media jonë dhe institucionet arsimore.

Pse është Afrika e varfër pavarësisht posedimit të këtyre burimeve të mëdha? Përgjigja është se pasuria reale nuk konsiston më në vetë burimet natyrore. Pasuria e vërtetë tani është në menaxhimin dhe dijen, dhe ne fatkeqësisht nuk jemi të pasur mjaft në keto “burime” për shkak të filozofive tonë të prapambetura dhe politikave që rrjedhin prej tyre.

Intelektualët afrikanë ende ankohen për privatizimin duke besuar se kjo është një nga armët që SHBA dhe miqtë e tyre përdorin për të na „rikolonizuar“. Ne vazhdojmë të ankohemi se ata po blejnë bizneset tona dhe ne po mbesim pa gjë. Qeveria jonë madje ka propozuar për marrjen e “disa masa që do të sigurojnë që shumë prej këtyre kompanive të mbesin në duart e zambianëve vendas” (edhe nëse ata nuk kanë kapital dhe dije të mjaftueshme).

Me plotë bindje mund të them se kjo është injorancë përsëri. Burimi më i rëndësishëm që mund të gjendet në një vend është menaxhimi i përparuar, jo toka, jo ari. Një qeveri që çlirohet nga menaxherët e vërtetë dhe me eksperiencë si shkëmbim për hegjemoninë e përkohshme politike, është thjesht idiote.

Kompanitë që po privatizojnë në Zambia realisht nuk kanë asnjë vlerë në vetvete, pavarësisht se c’thonë specialistët tanë në Agjencinë e Privatizimit të Zambias. Vlera e tyre reale nuk qëndron në atë çka ato prodhojnë, por si e prodhojnë. Me rritjen e globalizimit, kompanitë nuk kanë zgjedhje tjetër veçse të bëhen ekstremisht konkurruese. Dhe ajo që e bën një kompani konkurruese është faktori menaxhues. T’ia shesësh një kompani dikujt që nuk ka aftësi menaxhuese të zhvilluara është ta dënosh kompaninë me vdekje të menjëhershme. Kompania është më mirë të lulezojë në “duar të huaja” se sa të vdesë në “duart vendase”. Në këtë aspekt, nuk ka vend për të qenë sentimental ose politik.

Ne kemi nevojë të pranojmë që nuk kemi aq shumë dhe me aq përvojë menaxherë në Afrikë. Kultura jonë tradicionale e pronësisë kolektive nuk na ka ndihmuar të prodhojmë menaxherë të mëdhenj. Dhe politikat ekonomike që ne kemi ndjekur pas pavarësisë vetëm e kanë përkeqësuar situatën. Duke nacionalizuar kompanitë private të asaj kohe ne krijuam një situatë ku kishte pak motivim për zhvillimin menaxherial. Edhe një menaxher i suksesshëm dështon kur nuk ka kuptim real mbi pronësinë – dhe kjo nuk vjen duke dënuar “grabitësit e burimeve kombëtare”, kjo vjen nga krijimi i pronësisë reale – privatizimi- dhe një përforcim strikt i të drejtave private të pronës.

Ne Zambia, minierat e bakrit prodhuan disa menaxherë të suksesshëm edhe pse minierat ishin në duart e shtetit. Por fakti ishte se minierat nuk ishin plotësisht në duart e shtetit. Koorporata Anglo Amerikane ende pati një farë pronësie mbi minierat dhe kjo bëri që ato të mirëmbanin një kulturë të mirë menaxhimi në miniera me qëllim që të mbronin pjesën e tyre të fitimit. Ishte krijuar një sistem strikt kontabiliteti që monitorohej nga afër prej pronarëve Anglo-Amerikanë. Ajo ishte koha kur minierat e bakrit ishin të vetmet kompani në Zambia ku mund të gjendeshin njerëz që të raportonin për punën në kohë dhe të mos largoheshin nga puna para kohe. Ata ishin të menaxhuar shumë profesionalisht dhe investuan shumë para për zhvillimin e aftësive menaxheriale të punëtorëve zambianë.

Por kultura e përgjithshme që ne zhvilluam përmes nacionalizimit me shumicë të kompanive private ishte një nga menaxhimet e këqia ose nuk ishte fare menaxhim. Nuk është për t'u çuditur që shumica e njerëzve që përfundojnë në udhëheqjen politike sot janë menaxherë të këqinj, duke ardhur nga periudha ku menaxhimi i keq ishte i institucionalizuar si rezultat i politikave socialiste ekstreme të qeverisë në atë kohë.

Çka na nevojitet tani është të ndalim së menduari se ne kemi "potencial të madh" vetëm sepse kemi shumë tokë, minerale dhe shumë kafshë në parqet turistike. Këto janë asgje. Faktori i kufizuar është menaxhimi.

Afrika është ende në të kaluarën e vjetër. Ne ende mendojmë se gjërat më të rëndësishme janë të kesh minerale dhe tokë dhe ne mendojmë se do të zhvillohemi nëse përzemë të huajt nga minierat e smeraldeve dhe i japim plehra kimike falas fermerëve tanë të vegjël dhe të tjera si këto.

Mendoj se kjo është plotësisht gabim. Gjëja e parë që na nevojitet është të shpërbëjmë Ministrinë e Bujqësisë dhe Ministrinë e Minierave dhe çdo gjë tjetër që vetëm pengon zhvillimin e ekonomisë sonë. Për sa kohë mbajmë këto ministri, do të lejojmë këta njerëz të mendojnë për vendin dhe sa më shumë ata të mendojnë, më shumë do të na shkatërrojnë, sepse mendimet e tyre janë bazuar në supozime dhe ide të gabuara dhe jofunksionale. Dhe duke i bërë gjërat më keq ne duhet t'i paguajmë atyre miliarda para tonat për ta bërë këtë (të menduarin) çdo muaj dhe madje akoma më shumë ta implementojnë atë. Të ndryshosh mendjet e udhëheqesve tanë nga paradigma e Ekonomisë materialiste konvencionale drejt paradigmes metafizike të të menduarit ekonomik me qendër menaxhimin do të jetë shumë e vështirë, nëse jo e pamundur. Ajo është aq e vështirë sa edhe t'i bindësh që ata mund të kursejnë kohë dhe para duke i bërë mitingjet e tyre të pafund përmes internetit (ose intranet-eve) në vend që t'i bëjnë fizikisht. Ka disa gjëra që nuk janë të lehta për t'u komunikuar me secilin, veçanërisht pasi ata kanë menduar një mënyrë të caktuar për një kohë tepër të gjatë.

Përgatiti: Enkelejda Myftari

ÇMIMET NOBËL NE EKONOMI – ORIGJINA DHE LAUREATËT

Ideja e parë për të patur një « Çmim Nobël » në ekonomi vjen nga Per Asbrink, Guvernator i Bankës Suedeze, e cila është dhe Banka Qëndrore më e vjetër e botës. Në kuadër të 300 vjetorit të bankës, Asbrink krijoi një fondacion kërkimor të quajtur « Fondacioni i Jubileut të Bankës së Suedisë » dhe i propozoi këshilltarit të tij ekonomik Assar Lindbeck si dhe ekonomistëve të shquar Erik Lundberg dhe Gunnar Myrdal që të reflektonin për mundësinë e krijimit të një titulli të veçantë të « çmimit Nobël » në ekonomi. Institucionalisht, ideja u shtrua për herë të parë për diskutim në një takim të përbashkët të Bankës së Suedisë, Fondacionit Nobël dhe Akademisë Mbretërore të Shkencave të Suedisë. Shumë anëtarë të Akademisë Mbretërore, duke patur parasysh procedurat dhe përmbajtjen e dhënies së këtij çmimi në shkencat ekzakte si fizika dhe kimia, shfaqën rezerva për aspektin rigoroz shkencor të shkencës së ekonomisë. Por, Lundberg dhe Myrdal arritën të jepnin argumentet e nevojshme përballë skepticizmit të Akademisë Mbretërore duke arritur që votimi në favor të akordimit të këtij titulli të bëhej në unanimitet.

Në maj të vitit 1968, Banka e Suedisë, Fondacioni Nobël dhe Akademia Mbretërore ranë zyrtarisht dakort për rregullat dhe kriteret e atribuimit të « çmimit Nobël » në ekonomi. Këto rregulla u kodifikuan nga qeveria suedeze në janar të vitit 1969. Komiteti i parë i vlerësimit të kandidaturave përbëhej nga : Bertil Ohlin (President i Komitetit, Shkolla Ekonomike e Stokholmit); Erik Lundberg (Shkolla Ekonomike e Stokholmit); Ingvar Svennilson (Universiteti i Stokholmit) ; Herman Wold (Universiteti i Upsalase, Universiteti i Goteborgut) ; Assar Lindbeck (Universiteti i Stokholmit). Çmimi « Nobël » në Ekonomi është i vetmi çmim që jepet nga Fondacioni Nobël pa qenë pjesë e specifikuar e testamentit të Alfred Nobel. Por, ai i nënshtrohet të gjitha rregullave të çmimeve të tjera Nobël. Ashtu si për çmimet në fushën e fizikës, kimisë, mjeksisë, etj., ai jepet në datën 10 dhjetor të çdo viti nga mbreti i Suedisë në përgjigje të zgjedhjes së bërë nga Akademia Mbretërore e Shkencave të Suedisë. Duke filluar nga viti 2006, pjesa monetare e këtij çmimi është 10 million korona suedeze ose afërsisht 1 milion euro.

Çmimi Nobël në ekonomi është bërë shpesh objekt debatesh e diskutimesh të shumta, pjesa dërrmuese e të cilave konvergojnë në mendimin dhe pretendimin se Alfred Nobel nuk kishte menduar kurrë të jepte një çmim për këtë disiplinë, si dhe në pretendimet se ekonomia nuk mund të cilësohet dhe vlerësohet si një disiplinë shkencore e mirfilltë. Frederich Hayek, përfaqësues i shkollës liberale austriake të ekonomisë dhe laureat i çmimit Nobël në ekonomi në vitin 1974, shprehej se “po ta kishin kërkuar mendimin e tij mbi këtë çmim, ai nuk do ta kishte inkurajuar këtë iniciativë”. Ndërkohë, Gunnar Myrdal, gjithashtu lauret i këtij çmimi ka deklaruar se “arsyeja pse ky çmim nuk duhet të jepet është pikërisht fakti se ai iu akordua një reaksionari si Hayek-u”. Zgjedhja e laureatëve kritikohet gjithashtu dhe për faktin se ajo favorizon shpesh ekonomistët e cilësuar si “ortodoks” që pothujase të gjithë i përkasin “Shkollës së Çikagos” dhe janë amerikanë. Ky lloj qëndrimi konstatohet vetëm në rastin e çmimit në ekonomi, sepse në rastet e çmimeve Nobël në psikologji apo mjeksi, ku në listën e fituesve dominojnë amerikanët, nuk konstatohet një ndjeshmëri e tillë si në rastin e ekonomistëve. Një tjetër qëndrim kritik në këtë fushë është dhe dyshimi në se ka me të vërtetë çdo vit ekonomistë aq të shquar që mund të meritojnë çmimin Nobël, apo thjesht për hir të çmimit duhet gjetur pa tjetër një ekonomist i shquar. Në përgjigje të këtij shqetësimi, duke filluar nga viti 1995, Akademia Mbretërore e Suedisë e zgjeroi spektrin e dhënies së këtij çmimi, në rradhë të parë duke modifikuar strukturën e Komitetit Vlerësues (futjen e dy jo ekonomistëve në jurinë prej 5 deri 8 anëtarësh) dhe në rradhë të dytë, duke pranuar kandidatura të shkencave politike, psikologjisë e sociologjisë, të cilat gjykohen se kanë një impakt të dukshëm mbi ekonominë. Kështu, në listën e të laureuarve të viteve të fundit janë dhe figura të shquara si Daniel Kahneman, Robert J. Aumann dhe Thomas C. Schelling të cilët nuk janë ekonomistë.

Disa statistika mbi shpërndarjen e çmimit Nobël në Ekonomi

Shpërndarja e çmimeve në funksion të nacionalitetit:

SHBA 41 (67%); Angli 7 (11%); Norvegji 3 (5%); Suedi 2 (3%); Kanada 1 (2%); Gjermani 1 (2%); Indi 1 (2%); Francë 1 (2%); BRSS 1 (2%); Hollandë 1 (2%); Izrael 1 (2%); Santa Lucia 1 (2%);

Numri i të laureuarve:

çmim individual - 39 herë; çmim i ndarë për 2 fitues njëkohësisht – 14 herë; çmim i ndarë për 3 fitues njëkohësisht – 4 herë; totali i ekonomistëve të laureuar – 61.

Universitetet dhe Institutet ku kanë zhvilluar kërkimet dhe aktivitetin të laureuarit: Universiteti i Çikagos – 9 të laureuar; Universiteti Berkeley – 4; Universiteti Cambridge – 4; Universiteti Harvard – 4; Universiteti Columbia – 3; MIT, Massachusetts Institute of Technology - 3; Universiteti Stanford – 3; Universiteti i Oslo-s – 2; Universiteti Princeton – 2; Universiteti Yale – 2; Universiteti i Bon-it – 1; Universiteti Carnegie Mellon (Norvegji) – 1; Universiteti i New York-ut – 1; Shkolla e Larte Kombetare e Inxhinerise ne Paris – 1; Universiteti i Fribourg-en Brisgau (Zvicër) – 1; Instituti Kombëtar i Ekonomisë dhe Menaxhimit, Moskë – 1; Shkolla Ekonomike e Hollandës – 1; Universiteti i Oxford-it – 1; Universiteti i Pensilvanisë – 1; Universiteti i Stokholmit – 1; Shkolla Ekonomike e Stokholmit – 1; Universiteti Washington në Saint Louis – 1.

Emri Mbiemri	Universiteti	Fusha dhe teoria kryesore
Vitet 60-të - 1969		
Ragnar Anton Kittil Frisch - Norvegji	Universiteti i Oslos	Makroekonomia
Jan Tinbergen - ë		Frisch futi konceptin e të dhenave globale në sistemin e Ëalrassit
		Tinbergen-i punoi për problemet e planifikimit.
Vitet 70-të		
Paul Samuelson SHBA (1970)	Massachusetts Institute of Technology	Ekuilibri pergjithshëm dhe pjesor
		Për punimet e tij mbi teorinë keneiziane të ciklit, multiplikatorit, etj.
Simon Kuznets SHBA (1971)	Harvard	Rritja ekonomike dhe Historia Ekonomike
		Përpunimi i modeleve ekonometrike dhe konceptimi i kontabilitetit nacional.
John Hick Britania e Madhe	Oxford,	Teoria e ekuilibrit të përgjithshëm
Kenneth Arrow SHBA (1972)	Harvard	Ekonomia e Mirëqënies
Wassily Leontief (1973)	Harvard	Analiza input-output
		Puninet per tabelen e lidhjeve industriale.

Friedrich Von Hayek Britania e Madhe	Albert-Ludwigs (Fribourg-en-Brisgau)	Makroekonomia dhe Ekonomia Institucionale Friedrich Von Hayek u shfaq si kundërshtar i teorisë së Keynes-it Gunnar Myrdal – Shkolla Institucionaliste
Gunnar Myrdal Suedi (1974)	New York	
Leonid Kantorovich URSS	Moscou	Teoria e alokimit optimal të burimeve
Tjalling Koopmans SHBA (1975)	Yale	
Milton Friedman SHBA (1976)	Shkolla e Chikagos	Makroekonomi Punimet për teorinë monetare. (Figura më e spikatur e Monetarizmit)
Bertil Ohlin Suedi (1977)	Stockholm	Ekonomia Ndërkombëtare
James Meade Britania e Madhe	Cambridge	Teoria e Marrëdhënieve Ndërkombëtare
Herbert Simon SHBA (1978)	Carnegie- Mellon	Procesi i marrjes së vendimeve në organizatat ekonomike
Theodore Schultz SHBA (1979)	Chicago	Ekonomia e Zhvillimit
Arthur Lewis Sainte-Lucie	Princeton	Punime mbi zhvillimin ekonomik

Vitet 80-të

		Makroekonomi
Lawrence Klein SHBA (1980)	Pennsylvania- Philadelphie	Ndërtimi i modeleve ekonometrike të konjunkturës dhe aplikimi i tyre në politikat ekonomike
James Tobin SHBA (1981)	Yale	Makroekonomi Analiza e tregjeve financiare
George Stigler SHBA (1982)	Chicago	Organizimi Industrial Teoritë mbi ekonominë e tregut
Gérard Debreu SHBA (1983)	Berkeley	Teoria e ekuilibrit të përgjithshëm dhe pjesor Futja e metodave të reja në teorinë ekonomike
Richard Stone Britania e Madhe (1984)	Cambridge	Kontabiliteti Nacional Analiza e sistemeve të kontabilitetit nacional
Franco Modigliani SHBA (1985)	Massachusetts Institute of Technology	Makroekonomi Kursimet e brendshme dhe tregjet financiare. « Hipoteza e ciklit jetësor ». Pavarësia e pasivit në raport me vlerën e ndërmarrjes

James Buchanan Jr SHBA (1986)	Qendra e Studimeve “Public choice” (Faifax)	Financat Publike
Robert Solow SHBA (1987)	Massachusetts Institute of Technology	Teoria e Rritjes Ekonomike (modeli Solow)
Maurice Allais France (1988)	Shkolla e Lartë Kombetare e Inxhinerisë, Paris	Teoria e ekuilibrit të përgjithshëm dhe pjesor
Trygve Haavelmo Norvegji (1989)	Oslo	Ekonometri

Vitet 90-të

Harry Markowitz SHBA 1990	Universiteti i New York-ut	Teoria ekonomike dhe financiare ; Financimi i Ndërmarrjeve
Merton Miller SHBA	Chicago	
William Sharpe SHBA	Stanford	
Ronald Coase Britania e Madhe (1991)	Chicago	Teoria e Institucioneve
Gary Becker SHBA (1992)	Chicago	Mikroekonomi; Sociologji ekonomike.
Robert Fogel SHBA (1993)	Chicago	Historia Ekonomike
Douglass North SHBA	Washington (Saint Louis)	
Reinhard Selten Gjermani (1994)	Berkeley	Teoria e Lojës
John Forbes Nash SHBA	Princeton	
John Harsanyi SHBA	Bonn	
Robert Lucas Jr SHBA (1995)	Chicago	Makroekonomi
James Mirrlees Skoci (1996)	Cambridge,	Ekonomia e Informacionit
William Vickrey SHBA	Columbia (New York)	
Robert Merton SHBA (1997)	Harvard	Matematika Financiare Moderne
Myron Scholes SHBA	Stanford	

Amartya Sen Indi (1998)	Trinity College Cambridge	Ekonomia e Mirëqënies
Robert Mundell Kanada (1999)	Columbia (New York)	Makroekonomi

Vitet 2000

James Heckman SHBA (2000)	Chicago	Ekonometri
Daniel McFadden SHBA	Berkeley	
George Akerlof SHBA (2001)	Berkeley	Ekonomia e Informacionit; Tregjet dhe Asimetria e Informacionit
Michael Spence SHBA	Stanford	
Joseph E. Stiglitz SHBA	Columbia (New York)	
Daniel Kahneman SHBA (2002)	Princeton	Ekonomia Eksperimentale; Neuroekonomia
Vernon L. Smith SHBA	Virginie	
Robert F. Engle SHBA (2003)	Universiteti i New York-ut	Përmiresimi i teorisë dhe metodave të Parashikimeve Ekonomike
Clive W. J. Granger Britania e Madhe	Universiteti i Californise San Diego	
Finn E. Kydland Norvegji	Carnegie Mellon	Makroekonomia dinamike – koherenca kohore e politikave ekonomike dhe forcat influcuese të ciklit të biznesit
Edward Prescott SHBA (2004)	Universiteti i Arizona-s	
Robert J. Aumann Izrael	Universiteti i Jeruzalemit	Teoria e lojës – analiza e konflikteve dhe kooperimi
Thomas Schelling SHBA (2005)	Universiteti i Maryland-it	
Edmund S. Phelps SHBA (2006)	Columbia University	Makroekonomi Politikat makroekonomike
Leonid Hurwicz SHBA	Universiteti i Minnesota-s	Teoria e lojës – teoria e mekanizmave nxitës të tregut
Eric Maskin SHBA	Princeton	
Roger Myerson SHBA (2007)	Universiteti i Chicago-s	

PROFIL: AMARTYA SEN

EKONOMISTI I MIREQENIES



Amartya Kumar Sen, ka lindur në Santiniketan, Indi në 3 nëntor 1933. Ai njihet si një nga ekonomistët dhe filozofët më të shquar indian, fitues i Çmimit Nobël në Ekonomi në vitin 1998 “për kontributin e tij në ekonominë e mirëqënies”, për punën e tij mbi krizat, teorinë e zhvillimit njerëzor, ekonominë e mirëqënies, mekanizmat themelor të luftës kundër varfërisë dhe liberalizimin politik

Prej vitit 1998 deri në vitin 2004 ka qenë Drejtuesi i Kollegjit Trinity në Universitetin e Kembrixhit duke u bërë akademik i parë aziatik që drejton një kolegji të Oxbridge. Amartya Sen ishte i interesuar në debatin mbi globalizimin. Ai ka dhënë leksione për ekspertët e Bankës Botërore si dhe është President Nderi i Oxfam.

Ndërmjet shumë kontributeve të tij në zhvillimin e ekonomisë, Sen ka punuar edhe mbi pabarazinë gjinore. Aktualisht është profesor i Universitetit Lamont në Universitetin e Harvardit. Librat e Amartya Sen janë përkthyer në shumë gjuhë të botës. Ai është administrues i Ekonomistëve për Paqe dhe Siguri.

EDUKIMI DHE KARRIERA

Sen ka lindur në Santiniketan, në Bengal Perëndimor, qyteti universitar i krijuar nga Rabindranath Tagore, një tjetër indian fitues i Çmimit Nobël. Shtëpia e tij e lindjes ishte në Wari, Dhaka, që në ditët e sotme njihet si Bangladeshi. Rabindranath Tagore tregonte se ishte ai që i ka vënë emrin Amartya Sen, emri i tij (“Amartya” do të thotë “i pavdekshëm”).

Sen ndoqi studimet e larta në St Gregory’s School në Dhaka në 1941, që në ditët e sotme njihet si Bangladesh. Familja e tij migroi në Indi në 1947 ku Sen studioi në sistemin shkollor të Univeristetit të Visva –Bharati dhe Kolegjin në Kolkata përpara se ai të zhvendosej në Kolegjin Trinity në Kembrixh ku fitoi Klasën e Parë Bachelor në 1956 dhe Ph.D. në 1959. Gjithashtu gjatë qëndrimit të tij 4 vjeçar në Kolegjin Trinity ai u përfshi edhe në studimin e çështjeve filozofike.

Ai ka dhënë ekonomi në Universitetin Kalkutës, Universitetin Jadavpur, Delhi, Oksford (ku fillimisht ishte Profesor i Ekonomiksit në Kolegjin Nuffield dhe më pas Profesor i Ekonomise Politike), Shkollën Londineze të Ekonomisë, Universitetin e Harvardit dhe gjatë viteve 1998-2004 ka qenë Drejtues i Kollegjit Trinity të Kembrixh. Në janar të 2004 Sen rikthehet në Harvard. Gjithashtu ai është kontribues i Trustit Eva Colorni të ish Universitetit Londinez Guildhall.

Në maj të 2007, emërohet Kryetar i Nalanda Mentor Group për të drejtuar zbatimin e Projektit të Universitetit të Nalandës, i cili synon të ringjallë vatrën e dikurshme të mësimi në Nalanda, Bihar në Indi përmes një universiteti ndërkombëtar.

Veprat kryesore

Dokumentet themelore të Sen në fund të viteve '60 dhe fillimit të viteve '70 kanë ndihmuar në zhvillimin e teorisë së zgjedhjes sociale, që doli në dritë për herë të parë në punën e ekonomistit amerikan Kenneth Arrow, i cili gjatë punës së tij në vitet '50 në Koorporatën RAND hodhi teorinë se të gjitha rregullat e votimit, qofshin shumica në votim, 2/3 e shumicës apo status quo në mënyrë të paevitueshme janë në konflikt me disa nga normat bazë të demokracisë. Kontributi i Sen në literaturë ishte të tregonte në cilat kushte Teoria e Pamundësisë së Arrow me të vërtetë mund të pranohej ashtu sikurse dhe të zhvillonte dhe përmirësonte teorinë e zgjedhjes sociale, kjo falë edhe interesit të tij për historinë e mendimit ekonomik dhe filozofinë.

Në vitin 1981 Sen publikon “Varfëria dhe Krizat: Një Ese mbi Përfitimin dhe Deprivimin”, një libër i cili tregon se krizat ndodhin jo vetëm për shkak të mungesës së ushqimit, por gjithashtu nga pabarazitë të provokuara nga mekanizmat e shpërndarje së ushqimit. Interesi i Sen në trajtimin e temës së krizave rridhte nga eksperiencia personale. Në moshën 9-vjeçare, ai ka qenë dëshimtar i krizës së urisë që përfshiu Bengalín në vitin 1943, ku më shumë se 3 milionë njerëz vdiqën.

Më vonë Sen arrin në konkluzionin se e gjithë kjo humbje jetësh ishte e panevojshme. Ai besonte se në atë kohë India kishte rezerva të mjaftueshme ushqimi, por pikërisht shpërndarja e ushqimit vështirësohej pasi grupe të veçanta të popullsisë – në këtë rast fshatarët- kishin humbur vendet e tyre të punës dhe rrjedhimisht dhe mundësinë për të blerë ushqim.

Në librin e tij “Varfëria dhe Kriza: Një Ese mbi Përfitimin dhe Deprivimin” (1981) Sen zbuloi se në disa nga rastet e krizave, rezervat ushqimore nuk ishin reduktuar. Në Benegal p.sh., prodhimi ushqimor edhe pse më i ulët se një vit më parë, ishte më i lartë se në vitet e mëparshme kur vendi nuk ishte përfshirë në krizë. Në këtë mënyrë, Sen e vuri theksin në një numër faktorësh social dhe ekonomik të tillë si: ulja e pagave, papunësia, rritja e çmimeve të mallrave dhe sistemi i varfër i shpërndarjes së ushqimit. Këta faktorë çuan më pas në krizë grupe të caktuara të shoqërisë. Përqasja e tij mbi mundësitë fokusohet mbi lirinë pozitive, zotësinë e një personi për të qënë ose për të bërë diçka më tepër, se përqasja mbi lirinë negative, nocione të cilat janë të njohura në ekonomi dhe thjesht fokusohen mbi mos-ndërrhyrjen. Në krizën e Bengalit, liria negative e fshatarëve për të blerë ushqime nuk ishte prekur. Sidoqoftë ata vuajtën nga uria sepse nuk ishin të lirë konkretisht për të bërë diçka, ata nuk kishin mundësi të ushqeheshin, por as nuk kishin mundësi për t’iu shmangur kësaj gjendjeje vdekjeprurëse.

Përveç punës së tij të rëndësishme të studimit të arsyeve të krizave, Sen e përqëndroi punën e tij edhe në fushën e zhvillimit ekonomik, duke patur një ndikim të konsiderueshëm në formulimin e Raportit të Zhvillimit Njerëzor, të publikuar nga PNUD. Ky publikim vjetor, i cili liston vendet mbi bazën e treguesve të ndryshëm ekonomik dhe social njihet për kontributin shumë të madh të Sen ndërmjet teoricienëve të tjerë të zgjedhjes sociale në fushën e sistemit të masave ekonomike të varfërisë dhe pabarazisë.

Kontributi revolucionar i Sen në treguesit e zhvillimit ekonomik dhe social ishte në krijimin e konceptit të “mundësisë” trajtuar në artikullin e tij “Equality of What”. Ai argumenton se qeveritë duhet të tregojnë kujdes në mundësitë konkrete të shtetasve të tyre. Zhvillimi është një aset për të drejtat e njeriut për aq kohë sa saktësia dhe përcaktimi i termave mbetet dyshues (“e drejta” është diçka që duhet të jepet apo diçka që thjesht nuk mund të merret?) P.sh. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qytetarët gëzojnë të drejtën e votës. Për Sen ky koncept është vërtet bosh. Përpara se qytetarët të kenë të drejtën për të votuar, ata duhet të kenë “funksionimin” apo mënyrat e funksionimit. Këto “funksionime” mund të klasifikohen duke nisur nga mundësia për arsimim deri në kritere specifike si transportim për në votim. Vetëm atëherë kur barriera të tilla të jenë hequr mund të themi se qytetarët kanë shprehur me vërtetësi zgjedhjen e tyre personale. Është detyrë e shoqërisë të përcaktojë një listë të mundësive minimale të garantuara po nga vetë shoqëria. Një

shembull i “përqasjes së mundësive” në praktikë, (shiko Martha Nussbaum, *Gratë dhe Zhvillimi Njerëzor*)

Ai shkroi një artikull kundërshtues në New York Review of Books, të titulluar “ Më shumë se 100 milionë gra kanë humbur” duke analizuar ndikimin e pabarazisë së të drejtave në nivelin e vdekshmërisë ndërmjet burrave dhe grave në vendet në zhvillim, veçanërisht në Azi. Studime të tjera , si tilla si ai i Emily Oster e kanë argumentuar këtë si një mbivlerësim. Sen është diferencuar ndërmjet ekonomistëve të shekullit të XX për këmbnguljen e tij mbi diskutimin ndryshe të çështjeve nga shumica e ekonomistëve. Ai shprehu një nga kritikën kryesore mbi modelin ekonomik ku cilësonte interesin personal si faktorin primar motivues të aktivitetit njerëzor. Ndërsa linja e tij e mendimit mbetet periferike, nuk ka dyshim se puna e tij ndihmoi në ri-prioritetizimin e një sektori të rëndësishëm të ekonomistëve të zhvillimit, si dhe të vetë politikave të Kombeve të Bashkuara.

Ekonomia e mirëqënies ka për qëllim të vlerësojë politikën ekonomike në kushtet e efekteve të tyre në mirëqënien e komunitetit. Sen i cili ia dedikoi karrierën e tij kësaj çështjeje është quajtur simbol “i përgjegjësishë profesionale”. Monografia e tij “Zgjedhja kolektive dhe Mirëqënia Sociale”, trajton probleme të tilla si të drejtat e njeriut (përfshirë këtu edhe formulimin e paradoksit të lirisë), drejtësia dhe barazia, të drejtat e shumicës dhe mundësia e informimit në varësi të kushteve individuale, inspiruan kërkesat të kthejnë vëmendjen e tyre mbi sigurimin e mirëqënies dhe shërbimeve bazë.

Sen ishte i pari që krijoi metodat e matjes së varfërisë, të cilat mundësuan marrjen e informacioneve të nevojshme për përmirësimin e kushteve ekonomike për të varfrit Ai ka kontribuar në krijimin e Indikatorit të Zhvillimit Human (IDH) që mat varfërinë në funksion të shëndetit, të nivelit të edukimit dhe të nivelit të jetesës. Për më tepër, puna e tij teorike mbi pabarazitë ka lejuar të shpjegohet pse ka më pak gra se burra në Indi dhe në Kinë, ndërkohë që është e kundërta në Perëndim ose në vende të varfra, por ku gratë kanë të njëjtin akses në shërbime shëndetësore, nivele vdekshmërie më të ulta në të gjitha moshat, jetëgjatësi më të madhe dhe përfaqësojnë një pakicë të popullsisë. Sen ka hedhur idenë se ky raport rezulton nga një trajtim më i mirë mjekësor dhe mundësi për të lindur fëmijë meshkuj, etj

Qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare të cilat trajtonin krizat e urisë u influencuan nga puna e Sen. Pikëpamjet e tij inkurajuan politikbërësit të tregonin kujdes jo vetëm në drejtim të lehtësimit të krizave por gjithashtu të gjenin rrugët për të zëvendësuar nivelin e ulët të të ardhurave të të varfërve si p.sh. nëpërmjet projekteve të punëve publike dhe mbajtjes së çmimeve të qëndrueshme për ushqim. Një mbrojtës i flaktë i lirisë politike, Sen besonte se krizat nuk ndodhnin në demokracitë funksionuese kjo sepse liderët e tyre janë më të përgjegjshëm për kërkesat e qytetarëve.

Në mënyrë që të arrihet rritja ekonomike, ai argumentonte, se reformat sociale të tilla si përmirësimi në edukim dhe shëndetin publik duhet t'i paraprijnë reformave ekonomike.

ÇMIME

- Në 1999 merr Çmimin Nobël në ekonomi për punën e tij “në ekonominë e mirëqënies”.
- Në 1999 merr çmimin Bharat Ratna, çmimin më të lartë civil në Indi
- Në 1999 shpallet Qytetar Nderi i Bangladeshit ka Kryeministri Sheikh Hasina në mirënjohje të arritjeve të tij në fitimin e Çmimit Nobel.
- Në 2000 Instituti i Zhvillimit Global dhe Mjedisit i akordon Çmimin Leontief Prize për kontributin e tij të pakufi në teorinë ekonomike
- Në 2000, i akordohet në SHBA Medalja Eisenhower për Lidërsip

- Në vitin 2000 i akordohet në Mbretërinë e Bashkuar titulli Shoqruer i Nderit
- Në 2002 Unioni Ndërkombëtar i Shkencave Humane dhe Etikës i akordon Çmimin Humanisti Ndërkombëtar
- Në vitin 2003, i akordohet “Life Time Achievement Award” nga Dhoma e Tregtisë së Indisë.
- I akordohet “Life Time Achievement Award” Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Ekonominë dhe Çështjet Sociale për Azinë dhe Pacifikun në Bangkok (UNESCAP)

Përgatiti: Enkelejda Myftari

BIBLIOGRAFI

Amartya Sen ka botuar një numër të konsiderueshëm librash dhe artikujsh. Më poshtë janë listuar një pjesë e këtyre botimeve:

- *India. Historia, kultura dhe identiteti, 2007*
- *Identiteti dhe violenca, 2007*
- *Arsyetimi dhe liria në ekonomi, 2005*
- *Demokracia, të tjerat: përse liria nuk është një qëllim në Perëndim, 2005*
- *Ekonomia si shkencë morale, 2004*
- *Një model i ri ekonomik, 2000*
- *Të rikthejmë vëmendjen mbi pabarazinë, 2000*
- *Liria, Arsyetimi dhe Zgjedhja Sociale: Leksione dhe ese të tjera, 2000*
- *Arsyeja përpara Identitetit, 1999*
- *Zhvillimi si Liri, 1999*
- *Etika dhe ekonomia, 1993*
- *Mbi etikën dhe ekonominë, 1987,*

BOTIME TË TJERA:

- *Zgjedhja e Teknikave, 1960;*
- *Zgjedhja Kolektive dhe mirëqënia sociale, 1970;*
- *Mbi pabarazinë ekonomike, 1973;*
- *Varfëria dhe krizat: Një Es mbi përfitimin dhe deprivimin, 1981*
- *Dëshira dhe aksioni publik, shkruar së bashku me Jean Dreze, 1989;*
- *India: Zhvillimi ekonomik dhe mundësitë sociale, me Jean Dreze, 1995;*
- *Zgjedhja, Mirëqënia dhe sistemi i masave, 1982,*
- *Më shumë se 100 milionë gra kanë humbur, 1990,*
- *Cilësia e jetës, me Martha Nussbaum, 1993*

RECENCË “TRANZICIONI DHE LIRIA EKONOMIKE NË SHQIPËRI”

PROF. DR. ANASTAS ANGJELI

“...Tranzicioni nga komunizmi në ekonominë e tregut përfaqëson një nga eksperimentet më të rëndësishme të të gjitha kohrave...”

- Joseph Eugene STIGLITZ -



Në fund të viteve ‘90, gati 17 vjet më parë, teoricienët, analistët dhe ekonomistë të ndryshëm theksonin se nuk kishte teori që të udhëhiqte procesin praktik të tranzicionit, të tilla ishin dhe mbeteshin teoria e kapitalizimit dhe e socializmit. Përvoja e fituar në këto vite tranzicioni në vendin tonë (por edhe në vendet e tjera të Europës Jug-Lindore në tranzicion) me gjithë të përbashkëtat dhe veçantitë, ende nuk mund të na çojë në një përfundim për të pasur një guidë të plotë standarte për transformimin e ekonomisë së komanduar në ekonomi të tregut të lirë. Realizimi i reformave transformuese dhe instalimi e konsolidimi i ekonomisë së tregut në vendin tonë është i lidhur dhe mban vulën e mendimit dhe të punës të të gjitha qeverive dhe politikanëve, por në veçanti të një numri të madh ekonomistësh, financierësh dhe bankierësh, qofshin këta politikanë, drejtues shteti, ministra, akademikë, profesorë, administratorë, nëpunës civilë të administratës publike, menaxherë, biznesmenë e sipërmarrës, anëtarë të shoqërisë civile apo punonjës të mediave, përfaqësues të institucioneve ekonomike e financiare ndërkombëtare dhe të qeverive të vendeve të ndryshme etj.

Në vetvete, qëllimi i librit të Prof. Angjelit, nuk është të përshkruajë me imtësi dhe në mënyrë të plotë tranzicionin ekonomik të vendit e as të japë hollësi për të gjitha transformimet shumëplanëshe të kryera deri tash në vendin tonë. Kësisoj, përshkrimi i fazave dhe momenteve kryesore të tranzicionit, transformimit të marrëdhënieve të pronësisë, të reformave strukturore, të liberalizimit të çmimeve dhe tregtisë, të ngritjes së sistemit financiar (bankar e jobankar), të sistemit tatimor, zhvillimit të sistemit monetar dhe veçanërisht të zhvillimit të sektorit privat të ekonomisë, janë bërë në funksion dhe në shërbim të pjesëve të tjera të librit (pjesës së dytë e të tretë që përbëjnë edhe pjesën kryesore të tij), atë të kuptimit, matjes dhe analizës së faktorëve që ndikojnë në lirinë ekonomike në Shqipëri.

I ndarë në katër pjesë libri nis me paraqitjen e hapave të tranzicionit ekonomik, momentet kryesore, duke u mbështetur kryesisht në politikat dhe situatën e stabilitetit makroekonomik të vendit. Dhe vazhdon më pas me dhënien e përkufizimeve dhe koncepteve bazë mbi lirinë ekonomike, rëndësinë dhe mënyrat e matjes së saj. Në pjesën e tretë, i kushtohet rëndësi analizës së të dhënave mbi lirinë ekonomike dhe faktorët me ndikim në të. Libri nuk synon një trajtim shterues të problemeve në këtë fushë, por thjesht të hidhet një hap i parë drejt kalimit nga fjalët tek numrat, që do të thotë që gjendja e sotme e të folurit në përgjithësi mbi lirinë ekonomike të vendit tonë, në gjykimin e bazuar në vlerësime sasiore (përmes treguesve, kriterëve dhe vlerësimeve). Në përmbyllje të tij janë renditur në mënyrë kronologjike, publikime, artikuj, ese, mendime, analiza, sugjerime, rreth problemeve që lidhen me çështjet e trajtuara në tre pjesët e para, kryesisht me situatën dhe problemet që ndikojnë në lirinë ekonomike në Shqipëri, kryesisht gjatë periudhës 2005-2007.

Në një këndvështrim më të gjerë, libri të jep një pasqyrë të qartë të realitetit të sotëm ekonomik të Shqipërisë krahasuar me atë të regjimit (sistemit) të kaluar komunist.

Bazuar në të, mund të thuhet se tranzicioni ekonomik në Shqipëri ka përfunduar. Kjo sepse, ekonomia socialiste që bazohej në pronën shoqërore dhe në ekonominë që drejtohej në mënyrë të planifikuar dhe të centralizuar është zhdukur tërësisht dhe ajo është zëvendësuar, plotësisht, me një ekonomi të re, ekonominë e tregut, në themel të së cilës qëndron prona private, mbrojtja dhe zhvillimi i saj. Për më tepër sot ekonomia shqiptare, drejtohet e zhvillohet (nga pikëpamja institucionale, ligjore dhe e veprimtarisë konkrete) sipas rregullave të ekonomisë së tregut.

Por, nga ana tjetër në libër analizohet tranzicioni ekonomik i Shqipërisë nga këndvështrimi se sa dhe si ekonomia shqiptare është zhvilluar, çfarë nivelesh dhe standardesh ajo ka arritur (në raport me vendet e tjera të rajonit dhe ato evropiane), sa dhe si ajo është në gjendje të plotësojë nevojat e zhvillimit të vendit (ekonomike e sociale, zhvillim, mirëqenie dhe reduktim të varfërisë), sa dhe si ajo është në gjendje të përballoj proceset integruese e të globalizimit (standarde) cilësi, teknologji, konkurrencë, investime, liri, etj.). Duke gjykuar nga ky këndvështrim, tranzicioni ekonomik shqiptar, jo vetëm që nuk ka përfunduar por, ka ende rrugë të gjatë për të bërë.

Tashmë Shqipëria është një vend që ka fituar liri ekonomike të konsiderueshme. Problemi shtrohet që lirinë ekonomike të fituar të mos e ndrydhim dhe të mos e humbasim. Kjo do të thotë se përmasat e lirisë ekonomike të arritur duhen zhvilluar më tej, duhen zgjeruar më tej, përmes vazhdimit të reformave të tregut në ekonominë shqiptare, larg pengesave të të gjitha llojeve, që shpesh janë rrjedhojë i ndryshimeve politike dhe qeverisëse në vend.

Shtypi u realizua në shtypshkronjën
“KRISTALINA-KH”
Rr. “Lord Bajron”
Tel.: ++ 355 4 356928;
Cel.: 068 20 38373, Cel.: 069 20 38373
Tiranë / Albania